



Republika e Kosovës
Repubilka Kosova-Republic of Kosova
Qeveria-Vlada-Governmet
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
DEPARTAMENTI PËR POLITIKA SOCIALE DHE I FAMILJES

MIRËQENIA SOCIALE 2021

PRISHTINË, 2022

Përgatiti	Ylfete Ramosaj-Abazi, Zyrtare e lartë për statistika Divizioni për Planifikim dhe Përfshirje Sociale DPSF/MFPT ylfete.ramosaj@rks-gov.net
Përgjegjës	Mentor Morina, Drejtor Departamenti për Politika Sociale dhe i Familjes / MFPT mentor.morina@rks-gov.net
Adresa	Departamenti për Politika Sociale dhe i Familjes / MFPT Rr. UÇK-së Nr.1 10000 Prishtinë, Kosovë
Botues	Departamenti për Politika Sociale dhe i Familjes / MFPT ©: Departamenti për Politika Sociale dhe i Familjes / MFPT Riprodhimi nuk është i lejuar pa autorizim. Për përdorimin e të dhënave duhet theksuar burimi

Lista e shkurtesave:

MFPT	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
MPMS	Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale
DPSF	Departamenti për Politika Sociale dhe të Familjes
DPPS	Divizioni për Planifikim dhe Përfishirje Sociale
DPS	Divizioni i Politikave Sociale
DSHS	Divizioni i Shërbimeve Sociale
DAKPM	Divizioni për Aftësinë e Kufizuar dhe Personat e Moshuar
DNS	Divizioni i Ndhmës Sociale
KPSHSF	Këshilli i Përgjithshëm për Shërbime Sociale dhe Familjare
NJMI	Njësia për Monitorim dhe Inspektim
PVPQ	Plani Vjetor i Punës së Qeverisë
QPS	Qendra për Punë Sociale
SOS	Fshati i Fëmijëve
QKUK	Qendra Klinike Universitare e Kosovës
SDSF	Shpresa dhe Shtëpia e Fëmijëve
ISSH	Instituti Special në Shtime
SHMPF	Shtëpia e Personave të Moshuar pa Përkujdesje Familjare
SHFSH	Shtëpia e Fëmijëve Shtime
SHBK	Shtëpitë me baze në Komunitet
QMGF	Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve
QMVPTQNJ	Qendra për Mbrojtjen e Viktimave dhe Parandalimin e Trafikimit me Qenje Njerëzore
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
ARC	Agjencia e Regjistrimit Civil
ZP	Zyret e Punësimit
NJKM	Njësia e Kontrollit dhe e Mbikëqyrjes
DFDIL	Departamenti i Familjeve të Dëshmorëve dhe Invalidëve të Luftës
SNS	Skema e Ndhmës Sociale
DPP	Departamenti i Punës dhe Punësimit
TI	Teknologjia e Informativë
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
DSHMS	Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
BpB	Banka për Biznes
KEDS	Kompania Kosovare për Distribuim me Energji Elektrike
KESO	Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike
OJQ	Organizatë Jo Qeveritare
FFAKP	Familjet më Fëmijë me Aftësi të Kufizuara të Përhershme
KM	Komisioni Mjekësor
PV	Personat e Verbër
PPT	Personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik
PK	Policia e Kosovës
PV	Plani i Veprimit
KRU	Kompanitë Rajonale të Ujësjellësit në Kosovë

Lista e figurave:

Figura 1	Rastet e reja të fëmijëve të braktisur, janar-dhjetor 2021	22
Figura 2	Fëmijët e braktisur sipas gjinisë, 2021	23
Figura 3	Fëmijët e braktisur që barten në vitin 2021, sipas vendit ku janë të vendosur	23
Figura 4	Numri i fëmijëve të vendosur në strehim familjar brenda familjes sipas muajve, 2021	26
Figura 5	Shuma e mjeteve të procesuara për pagesën e strehimit familjar te farefisi, 2021	27
Figura 6	Rastet e reja dhe rastet e bartura të fëmijëve në strehim familjar jashtë familjes, 2021	28
Figura 7	Fëmijët në strehim familjar jashtë familjes dhe familjet strehuese, 2021	29
Figura 8	Shuma e mjeteve të procesuar për pagesën e strehimit familjar jashtë familjes, 2021	30
Figura 9	Kërkesat e apovuara për adoptim vendor dhe ndwrkombwtar, 2021	31
Figura 10	Kërkesat e vlerësuara për strehim familjar dhe familje strehuese, 2021	32
Figura 11	Fëmijët dhe të rinjtë e vendosur në SOS Fshatrat Kosovë, gjatë vitit 2021	33
Figura 12	Fëmijët e vendosur në OJQ “Shpresa dhe Shtëpitë e Fëmijëve-Kosovë”, 2021/2020	35
Figura 13	Fëmijët e vendosur në strehimoren “Caritas Umbria Kosovë”-Klinë, 2021/2020	36
Figura 14	Totali i viktimat e dhunës në familje sipa gjinisë, 2021	40
Figura 15	Viktimat e dhunës sipas gjinisë, 2021	40
Figura 16	Viktimat e dhunës në familje sipas moshës, gjinisë dhe vendit të prejardhjes 2021/2020	41
Figura 17	Viktimat e dhunës në familje, sipas moshës, 2021	41
Figura 18	Viktimat e dhunës në familje sipas gjinisë, 2021	42
Figura 19	Viktimat e dhunës në familje sipas vendit të prejardhjes, 2021	42
Figura 20	Viktimat e trafikimit me qenie njerëzore të Strehuara në Strehimoren në Lipjan, 2021	44
Figura 21	Viktimat e supozuara të trafikimit të strehuara në QMVPT-Prishtinë	45
Figura 22	Rastet e martesave para moshës madhore, 2021	46
Figura 23	Numri i kërkesave të reja për vendosje në SHPMPP dhe ISSH, 2021/2020	51
Figura 24	Numri i kërkesave për strehim institucional/rezidencial, 2021	51
Figura 25	Numri i fëmijëve përfitues të Skemës së FFAKP-së, 2021	54
Figura 26	Shuma e mjeteve të procesuara për pagesën e Skemës së FFAKP-së, sipas muajve	55
Figura 27	Numri i fëmijëve, përfitues të Skemës së FFAKP-së, të përfshirë në procesin mësimor	56
Figura 28	Numri i kërkesave të reja të vlerësuara nga Komisioni Mjekësor, shkalla e I-rë, 2021	57
Figura 29	Numri i ankesave të vlerësuar nga Komisioni Mjekësor, shkalla e II-të, 2021	57
Figura 30	Familjet në Skemën e Ndhmës Sociale sipas muajve, 2021/2020	66
Figura 31	Anëtarët e familjes në Skemën e Ndhmës Sociale sipas muajve, 2021/2020	66
Figura 32	Pagesat e ndihmës sociale sipas muajve, 2021/2020	67
Figura 33	Numri i familjeve në SNS sipas komunave (dhjetor 2021)	69
Figura 34	Numri i anëtarëve të familjes në SNS sipas komunave (dhjetor 2021)	69
Figura 35	Shuma e mjeteve të procesuara për ndihmë sociale sipas komunave (dhjetor 2021)	69
Figura 36	Bartësit e lëndës sipas gjinisë, dhjetor 2021	71
Figura 37	Anëtarët e familjes sipas gjinisë, dhjetor 2021	71
Figura 38	Familjet në SNS sipas numrit të anëtarëve të familjes, dhjetor 2021/2020	72
Figura 39	Përqindja e familjeve në SNS sipas kategorive, dhjetor 2019	73
Figura 40	Familjet në SNS sipas etnitetit, dhjetor 2021	75

Figura 41	Anëtarët e familjes në SNS sipas etnitetit, dhjetor 2021	75
Figura 42	Shuma e mjeteve të procesuara sipas komuniteteve, dhjetor 2021	76
Figura 43	Numri i anëtarëve të familjes sipas kategorive dhe gjinisë, dhjetor 2021	77
Figura 44	Anëtarët e familjes në SNS me përqindje sipas grup-moshave, dhjetor 2021	77
Figura 45	Numri i ankesave të shqyrtuara nga Komisioni i Ankesave i Shkallës II, 2021	82
Figura 46	Numri i ankesave të shqyrtuara nga Komisioni Mjekësor i Shkallës II, 2021	82
Figura 47	Kontestet administrative të proceduara në Gjykatën Themelore, 2020	83
Figura 48	Numri i kërkesave për ndihmë të njëhershme, 2021/2020	85
Figura 49	Kërkesat për pëlqim/autorizim sipas QPS-ve, 2021	86
Figura 50	Shuma e mjeteve të procesuara, të shpërndara dhe të kthyerja janar-dhjetor 2021	87
Figura 51	Përqindja e familjeve të subvencionuara sipas Skemave, 2021	88
Figura 52	Familjet e papërzgjedhshme për ndihmë sociale pas krahasimit me ATK, 2021	90
Figura 53	Numri i përfituesve të skemës së FDIL-së sipas kategorive, dhjetor 2021	101
Figura 54	Numri i kërkesave të OJQ-ve për licencim të shqyrtuara gjatë vitit 2021	106
Figura 55	OJQ-të e licencuara sipas nivelit ku i ofrojnë ku ofrojnë shërbime, 2021	106
Figura 56	Përqindja e kërkesave të aprovuara dhe të refuzuara, 2021	115
Figura 57	Kërkesat e shqyrtuara në nivelin profesional 2021/2020	116
Figura 58	Përqindja e kërkesave të aprovuara dhe refuzuara gjatë vitit 2021	117
Figura 59	Kërkesat e shqyrtuara në nivelin bazik, të mesëm dhe të lartë, 2021/2020	117
Figura 60	Përqindja e ankesave të aprovuara dhe refuzuara gjatë vitit 2021	118
Figura 61	Ankesat e shqyrtuara gjatë viteve 2021/2020	119

Lista e tabelave:

Tabela 1	Rastet e reja të fëmijëve të braktisur sipas QPS-ve, 2021	22
Tabela 2	Numri i fëmijëve në strehim familjar brenda familjes sipas muajve, 2021	26
Tabela 3	Fëmijët në strehim familjar jashtë familjes dhe familjet strehuese, 2021	29
Tabela 4	Kërkesat për adoptim sipas QPS-ve, të ndara sipas gjinisë, nacionalitetit 2021	31
Tabela 5	Fëmijët e vendosur në OJQ “Shpresa dhe Shtëpitë e Fëmijëve-Kosovë”, vitit 2021	34
Tabela 6	Fëmijët në konflikt me ligjin 2021	36
Tabela 7	Viktimat e dhunës në familje sipas strehimores ku janë strehuar, 2021	40
Tabela 8	Viktimat e trafikimit me qenie njerëzore të strehuara në Strehimoren e Viktimave të Trafikimit në Lipjan dhe në “QMVPT”-në Prishtinë, 2021	44
Tabela 9	Rezidentët e vendosur në tri institucionet e nivelit qendror, sipas gjinisë edhe etnitetit, dhjetor 2021	52
Tabela 10	Personat e Moshuar pa Përkujdesje Familjare të vendosur në SHBK, sipas gjinisë dhe etnitetit, dhjetor 2021	53
Tabela 11	Personat e me Aftësi të Kufizuar të vendosur në SHBK sipas gjinisë dhe etnitetit, dhjetor 2021	53
Tabela 12	Numri i fëmijëve përfitues të Skemës së FFAKP-së, 2021	54
Tabela 13	Numri i fëmijëve, përfitues të Skemës së FFAKP-së, të përfshirë në procesin mësimor	56
Tabela 14	Numri i familjeve dhe anëtarëve të familjes në SNS, 2021	64
Tabela 15	Numri i familjeve, anëtarëve të familjes dhe shuma e mjeteve sipas komunave (dhjetor 2021)	67
Tabela 16	Numri i bartësve të lëndës dhe i anëtarëve të familjes sipas gjinisë (janar 2021)	69
Tabela 17	Familjet në SNS, sipas numrit të anëtarëve të familjes, dhjetor 2021	73
Tabela 18	Bartësit e ndihmës sociale sipas kategorive dhe strukturës gjinore, dhjetor 2021	74
Tabela 19	Bartësit e ndihmës sociale sipas statusit, dhjetor 2021	75
Tabela 20	Familjet në SNS sipas etnitetit, dhjetor 2021	76
Tabela 21	Anëtarët e familjeve në SNS, sipas kategorive dhe strukturës gjinore	78
Tabela 22	Numri dhe përqindja e anëtarëve të familjes në SNS sipas grup-moshave, dhjetor 2021	78
Tabela 23	Familjet në SNS sipas numrit të anëtarëve, pikëve dhe shumës mujore	80
Tabela 24	Rritja e ndihmës sociale nga viti 2003, shuma dhe mesatarja e NS-së për anëtarë të familjes	81
Tabela 25	Numri i ankesave, vlerësimeve në shkallën II dhe kontestet administrative, 2021	83
Tabela 26	Ndihmat e njëhershme/emergjente dhe buxheti i shpenzuar, 2021	87
Tabela 27	Procedimi, kthimi i mjeteve dhe provizioni bankar, sipas muajve 2021	89
Tabela 28	Subvencionimi i energjisë elektrike për vitin 2021	90
Tabela 29	Pagesa e familjeve në asistencë sociale sipas Masës 3.2	95
Tabela 30	Shtesat për fëmijë sipas muajve, 2021	97
Tabela 31	Kërkesat e shqyrtuara në nivelin profesional, 2021	118
Tabela 32	Kërkesat e shqyrtuara në nivelin bazik, të mesëm dhe të lartë, 2021	119
Tabela 33	Ankesat e shqyrtuara gjatë vitit 2021	121

Lista e kutiave:

Kutia 1	Nocioni “familje” dhe “bashkësi familjare” sipas Ligjit të Skemës së Ndihmës Sociale	62
Kutia 2	Ku bëhet aplikimi për ndihmë sociale?	63

PËRMBAJTJA


ORGANOGRAMI I DPSF-së.....	10
PARATHËNIA.....	11
HYRJA.....	12
1. KUADRI LIGJOR.....	13
1.1. Aktet ligjore që rregullojnë fushën e shërbimeve sociale dhe familjare.....	13
1.1.1. Aktet nën ligjore që rregullojnë fushën e shërbimeve sociale dhe familjare.....	13
1.2. Aktet ligjore që rregullojnë Skemën e Ndhmës Sociale.....	14
1.2.1. Aktet nën ligjore që rregullojnë Skemën e Ndhmës Sociale.....	14
1.3. Marrëveshjet e bashkëpunimt/mirëkuptimit.....	15
1.4. Standardet minimale dhe specifikimi I shërbimeve sociale dhe familjare.....	15
2. DEPARTAMENTI PËR POLITIKA SOCIALE DHE FAMILJARE.....	17
2.1. Detyrat dhe përgjegjësitë.....	17
2.2. Struktura Organizative e Departamentit (niveli qendror dhe lokal).....	18
2.2.1. Institucionet në nivel qendror.....	18
2.2.2. Institucionet në nivel lokal.....	19
2.2.3. Trupat punuese.....	19
3. DIVIZIONI I SHËRBIMEVE SOCIALE	20
3.1. Detyrat dhe përgjegjësitë.....	20
3.2. Ofrimi i shërbimeve sociale.....	20
3.3. Fëmijët pa kujdes prindëror dhe format e mbrojtjes sociale.....	21
3.3.1. Fëmijët e braktisur.....	21
3.3.2. Kujdestaria	24
3.3.3. Bashkimi familjar.....	24
3.3.4. Strehimi familjar.....	25
3.3.5. Adoptimi.....	30
3.3.6. Fëmijët e prindërve të penguar në kryrjen e të drejtës prindërore dhe të keqtrajtuar.....	32
3.3.7. Fëmijët e abuzuar dhe të keqtrajtuar në strehim rezidencial.....	33
3.4. Fëmijët në konflikt me ligjin.....	36
3.5. Riatdhesimi i fëmijëve të pashoqëruar.....	37
3.6. Fëmijët në punë të rënda.....	37
3.7. Dhuna në familje.....	38
3.7.1. Mbështetja financiare për OJQ-të që trajtojnë/strehojnë viktimat e dhunës në familje	39
3.7.2. Viktimat e dhunës në familje ta evidentuara dhe të trajtuara nga QPS-të.....	39

3.7.3.	Viktimat e dhunës në familje të strehuara në Strehimore.....	40
3.7.4.	Viktimat e dhunës në familje, sipas moshës, gjinisë dhe vendit të prejardhjes.....	41
3.8.	Trafikimi me qenie njerëzore.....	43
3.8.1.	Strehimi dhe trajtimi I viktimave të trafikimit me qenie njerëzore.....	43
3.8.2.	Mbështetja financiare e OJQ-ve që trajtojnë viktimat e trafikimit	45
3.9.	Mbrojtja e viktimave të krimeve seksuale-fëmijë.....	45
3.10.	Të miturit që hyjnë në martesë të parakohëshme.....	46
3.11.	Ngecje e marrëdhënieve familjare.....	47
3.12.	Këshilla martesore.....	47
3.13.	Të moshuarit në nevojë për shërbime sociale.....	47
3.14.	Komisioni për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në shkallën e II-të.....	47
3.15.	Komisioni Ministror për Shqyrtimin e Ligjshmërisë dhe Përshtatshmërisë së Akteve të Komunave të Kosovës.....	47
4.	DIVIZIONI PËR AFTËSINË E KUFIZUAR DHE PERSONAT E MOSHUAR.....	48
4.1.	Detyrat dhe përgjegjësitë.....	48
4.2.	Institucionet rezidenciale.....	48
4.3.	Aktivitetet e realizuara gjatë vitit 2021.....	49
4.4.	Numri i kërkesave të shqyrtuara për strehim institucional/rezidencial.....	50
4.4.1.	Rezidentet e vedosur në institucionet e nivelit qendror dhe lokal sipas gjinisë dhe etnitetit.....	52
4.5.	Skema për Përkrahje Materiale për Familjet me Fëmijë me Aftësi të Kufizuara të Përhershme.....	53
4.5.1.	Numri i fëmijëve në Skemën e FFAKP-së.....	53
4.5.2.	Përfshirja e fëmijëve në Skemën e FFAKP-së në procesin mësimor.....	55
4.5.3.	Puna e Komisioneve Mjekësore, shkalla e I-rë dhe e II-të.....	56
5.	DIVIZIONI I NDIHMËS SOCIALE.....	58
5.1.	Detyrat dhe përgjegjësitë.....	58
5.2.	Struktura organizative e Skemës së Ndhmës Sociale.....	59
5.3.	Delegimi i Skemës së Ndhmës Sociale në nivelin komunal.....	59
5.4.	Përgjegjësitë e nivelit qendror për Skemën e Ndhmës Sociale.....	59
5.5.	Përgjegjësitë e nivelit lokal për Skemën e Ndhmës Sociale.....	60
5.5.1.	Administrimi i SNS-së në nivelin komunal.....	60
5.6.	Kriteret për përfitimin e ndihmës sociale.....	61
5.7.	Numri i familjeve dhe i anëtarëve të familjes në SNS.....	63
5.7.1.	Familjet dhe anëtarët e familjes në SNS sipas komunave/QPS-ve.....	66
5.7.2.	Bartësit e lëndës dhe anëtarët e familjes sipas gjinisë	69
5.7.3.	Familjet në SNS sipas numrit të anëtarëve të familjes.....	70
5.7.4.	Bartësit e ndihmës sociale sipas kategorive	72
5.7.5.	Statusi i bartësve të ndihmës sociale.....	72
5.7.6.	Familjet në Skemën e Ndhmës Sociale sipas etnitetit.....	73
5.7.7.	Anëtarët e familjes në SNS sipas kategorisë dhe gjinisë.....	75

5.7.8. Anëtarët e familjes në SNS sipas grup-moshave.....	76
5.8. Shuma mujore e ndihmës sociale.....	77
5.8.1. Mesatarja ditore dhe mujore e ndihmës sociale sipas anëtarëve të familjes.....	78
5.9. Komisioni Mjekësor i shkallës së I-rë.....	78
5.10. Procesi dhe procedurat e ankimit për ndihmë sociale.....	79
5.10.1. Komisioni i Ankesave i shkallës së II-të.....	79
5.10.2. Komisioni Mjekësor i shkallës së II-të	81
5.10.3. Kontestet Administrative.....	82
5.11. Ndihmat e Njëhershme/Emenergjente.....	82
5.12. Pëlqimet për autorizim për tërheqjen e ndihmës sociale.....	85
5.13. Procedimi, shpërndarja, kthimi i mjeteve dhe provizioni bankar	86
5.14. Subvencionimi i energjisë elektrike	87
5.15. Baza e të Dhënave (TI) për Skemën e Ndihmës Sociale.....	88
5.16. Krahasimi i të dhënave me Administratën Tatimore të Kosovës.....	88
5.17. Njësia e Kontrollit dhe Mbikqyrjes për Skemën e Ndihmës Sociale.....	89
5.18. MASA 3 e Pakos së Ringjalljes Ekonomike	90
5.18.1. Mbështetje për Familjet që kanë humbur kryefamiljarin (Masa 3.1).....	90
5.18.2. Mbështetja për Pensionistët dhe Familjet me Asistencë Sociale (Masa 3.2).....	90
5.18.3. Pagesat për Lehonat e Papuna (Masa 3.5).....	91
5.18.4. Shtesat për Fëmijë (Masa 3.5).....	91
5.18.5. Mbështetja nga donatorwt.....	92
6. DIVIZIONI PËR PLANIFIKIM DHE PËRFSHIRJE SOCIALE.....	94
6.1. Detyrat dhe përgjegjësitë.....	94
6.2. Planifikimi dhe shpenzimi i buxhetit për vitin 2021.....	94
6.3. Aktivitetet e realizuara gjatë vitit 2021.....	95
6.4. Përfshirja sociale.....	96
6.4.1. Skema e Ndihmës Sociale.....	97
6.4.2. Pensionet Bazike të Moshës.....	97
6.4.3. Pensionet Kontributpagues të Moshës.....	97
6.4.4. Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuara.....	98
6.4.5. Pensionet Familjare.....	98
6.4.6. Pensionet Invalidore të Punës.....	98
6.4.7. Pensionet Paraplegjike dhe Tetraplegjike.....	99
6.4.8. Pensionet e Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK).....	99
6.4.9. Pensionet e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK).....	99
6.4.10. Skema e Familjeve të Dëshmorëve, invalidëve të Luftës dhe Viktimave Civile.....	99
6.4.11. Pensionet për Veteranët e Luftës.....	100
6.4.12. Pensionet e Minatorëve të Trepçës.....	100
6.4.13. Pensionet për Personat e Verbër.....	101
6.4.14. Skema për Përkrahje Materiale Familjeve të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara të Përhershme 1-18 vjeç.....	101

6.4.15. Pensionet për Kompensimin e Arsimit për vitet 90/91 deri në vitin shkollor 98/99.....	101
6.4.16. Strehimi Familjar	101
6.4.17. Pagesat për Lehonat e Papuna (Masa 3.5).....	101
6.4.18. Shtesat për Fëmijë (Masa 3.5).....	102
6.4.19. Mbështetje për Familjet që kanë humbur kryefamiljarin (COVID-19).....	102
6.4.20. Shërbimet Profesionale dhe Këshilluese.....	102
6.5. Përrjashtimi social.....	103
6.6. Licencimi i Organizatave Jo Qeveritare.....	104
6.7. Njësia për Monitorim dhe Inspektim.....	105
7. DIVIZIONI I POLITIKAVE SOCIALE.....	107
7.1. Detyrat dhe përgjegjësitë.....	107
7.2. Përgatitja e hulumtimeve për publikim.....	107
8. DIVIZIONI PËR MBËSHTETJE ADMINISTRATIVE TË KPSHSF-së.....	109
8.1. Detyrat dhe përgjegjësitë.....	109
9. KËSHILLI I PËRGJITHSHËM PËR SHËRBIME SOCIALE DHE FAMILJARE.....	110
9.1. Detyrat dhe përgjegjësitë.....	110
9.2. Përbërja e Këshillit.....	111
9.3. Aktivitetet e realizuara.....	111
9.4. Komisionet e Përhershme të KPSHSF-së.....	113
9.5. Komisioni për Licencimin e ofruesve të shërbimeve sociale dhe familjare, niveli profesional..	114
9.6. Komisioni për Licencimin e ofruesve të shërbimeve sociale dhe familjare, niveli bazik, i mesëm dhe i lartë.....	115
9.7. Komisioni i Ankesave.....	117
9.8. Bashkëpunimi me partner vendor dhe ndërkombëtar.....	118
TË DHËNA ME RËNDËSI.....	119

ORGANOGRAMI I DPSF-së



PARATHËNIA

Viti 2021, ka vazhduar të jetë shumë sfidues jo vetëm për vendin dhe shoqërinë tonë por për mbarë botën, për shkak të gjendjes së krijuar nga pandemia Covid-19, e cila ndikoi negativisht në shëndetin e njerëzve dhe e rëndoi edhe më shumë gjendjen socio-ekonomike të qytetarëve. Masat që u ndërmorën nga Qeveria e Republikës së Kosovës, me qëllim të parandalimit të përhapjes së pandemisë, reflektuan edhe në institucionin tonë duke na përballur me sfida shumë serioze në menaxhimin dhe kryerjen e aktiviteteve të planifikuara dhe të aktiviteteve që dolën si pasojë e gjendjes së krijuar nga COVID-19. Mirëpo, falë angazhimit të të gjithëve, sfidat u tejkaluan dhe puna vazhdoi duke iu përshtatur gjendjes së krijuar.

Bazuar në Planin Vjetor të Punës, Departamenti për Politika Sociale dhe të Familjes (DPSF), publikon Raportin Vjetor të Punës për vitin 2021, të quajtur “Mirëqenia Sociale 2021”. Publikimi i raportit “Mirëqenia Sociale 2021”, është përmbledhje e aktiviteteve nga fusha e shërbimeve sociale dhe e ndihmës sociale, të realizuara gjatë vitit 2021.

Në këtë publikim gjenden informacione të rëndësishme lidhur me mbrojtjen e fëmijëve, viktimat e dhunës në familje, viktimat e trafikimit me qenie njerëzore, personat e moshuar pa përkujdesje familjare, personat e rritur me aftësi të kufizuara mendore/ngecje në zhvillim mendor, për fëmijët me aftësi të kufizuara të përhershme, individë dhe familje përfitues të ndihmës sociale, përfituesit e Masës 3 të Pakos së Ringjalljes Ekonomike, procesin e licencimit të Organizatave Joqeveritare, licencimin individual të ofruesve të shërbimeve sociale dhe familjare, etj.

Shpresojmë që të dhënat e prezantuara në këtë publikim të mund të përdoren dhe t’u shërbejnë të gjithë aktorëve individualë dhe institucionalë që kanë të bëjnë me fushën e mbrojtjes sociale. Në fund, falënderojmë të gjitha institucionet në nivelin qendror dhe lokal për punën e kryer në rrethana shumë sfiduese dhe për bashkëpunimin profesional me DPSF-në gjatë vitit 2021 dhe stafin e DPSF-së që ndihmuan në përgatitjen e këtij raporti, duke ofruar të dhënat sipas fushës që mbulojnë.

Mentor Morina



Drejtor i DPSF-së

HYRJA

Departamenti për Politika Sociale dhe të Familjes (DPSF), funksionon në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve¹. Misioni i tij është *angazhimi në zhvillimin e legjislacionit të ri, vendosjen e standardeve të duhura për shërbimet dhe mbrojtjen sociale, mbështetjen e gjerë dhe të qëndrueshme financiare për individë dhe grupe në nevojë sociale, pa dallim moshe, gjinie etnie, religjioni, gjuhe, etj.*, duke përfshirë kriteret legjitime dhe transparente. DPSF-ja, gjithashtu, siguron që politikat për mirëqenie sociale të prezantohen në bazë të të dhënave mbi varfërinë në Kosovë dhe që politikat buxhetore për rritjen e mirëqenies sociale të jenë në përputhje me mundësitë buxhetore.

Raporti “Mirëqenia Sociale 2021”, është paraqitje e aktiviteteve të realizuara gjatë vitit 2021, vit i cili sikurse edhe për institucionet e tjera, ashtu edhe për DPSF-në ka vazhduar të jetë shumë sfidues, si pasojë e gjendjes së krijuar nga COVID-19. Mirëpo edhe përkundër sfidave të mëdha, falë angazhimit të të gjithëve u arrit që të realizohen shumica e aktiviteteve të parapara në Planin Vjetor të Punës së DPSF/MFPT për vitin 2021, si dhe aktivitete të tjera që dolën nga përballja me emergjencën me përmasa globale të krijuar nga pandemia.

Pasqyrimi i aktiviteteve është bërë sipas divizioneve që veprojnë në kuadër të tij, duke filluar nga: Divizioni i Shërbimeve Sociale (DSHS), Divizioni për Aftësinë e Kufizuar dhe Personat e Moshuar (DAKPM), Divizioni i Ndhmës Sociale (DNS), Divizioni për Planifikim dhe Përfshirje Sociale (DPPS), Divizioni i Politikave Sociale (DPS), Divizioni për Mbështetje Administrative i KPSHSF-së, Këshilli i Përgjithshëm për Shërbime Sociale dhe Familjare (KPSHSF).

Për hartimin e Raportit “Mirëqenia Sociale 2021” janë shfrytëzuar raportet vjetore të divizioneve, të dhënat e Bazës së Shërbimeve Sociale, e veçanërisht janë shfrytëzuar të dhënat e Bazës së Skemës së Ndhmës Sociale, me qëllim që të dhënat e paraqitura të jenë gjithëpërfshirëse, të sakta dhe të qarta.

Për kontributin e dhënë në hartimin e Raportit “Mirëqenia Sociale 2021”, falënderojmë në mënyrë të veçantë, z. Mentor Morina, Drejtor i DPSF-së, udhëheqësit e divizioneve, Menaxherin e Bazës së Shërbimeve Sociale, Menaxherin e Bazës së Skemës së Ndhmës Sociale, zyrtarët përgjegjës të fushave përkatëse, QPS-të, Institutin Special në Shtime, Shtëpinë e Personave të Moshuar pa Përkujdesje Familjare në Prishtinë, etj., sepse pa bashkëpunimin e tyre edhe finalizimi i këtij Raporti do të ishte i pamundur.

¹ Nga muaji shkurt 2021, DPSF-ja është pjesë e MFPT-së, me herët ka funksionuar në kuadër të MPMS-së.

1. KUADRI LIGJOR

1.1. Aktet ligjore që rregullojnë fushën e shërbimeve sociale dhe familjare

1. Ligji Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare;
2. Ligji Nr. 04/L-081 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare;
3. Ligji Nr. 2004/32 për Familjen i Kosovës;
4. Kodi Nr. 03/L-193 i Drejtësisë për të Mitur;
5. Ligji Nr. 03/L-182 për Mbrojtje nga Dhuna në Familje;
6. Ligji Nr. 04/L-218 për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit me Njerëz dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit;
7. Ligji Nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

1.1.1. Aktet nënligjore që rregullojnë fushën e shërbimeve sociale dhe familjare

1. Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2010 për Procedurat për Delegimin e Përgjegjësive në Nivel Lokal për Shërbime Sociale në Kosovë;
2. Rregullore për Punën e Panelit për Vendosjen e Fëmijëve pa Kujdes Prindëror në Strehim Familjar dhe Adoptim (Birësim);
3. Udhëzimi Administrativ Nr.12/2012 për Përbërjen dhe Funkcionimin e Panelit për Vendosjen e Fëmijëve pa Kujdes Prindëror në Strehim Familjar dhe Adoptim;
4. Udhëzimi Administrativ (MPMS) për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 12/2012 për Përkrahjen dhe Funkcionimin e Panelit për Vendosjen e Fëmijëve pa Kujdes Prindëror në Strehimin Familjar dhe Adoptim;
5. Udhëzimi Administrativ (MPMS) Nr.09/2014 për Rregullimin e Procedurave të Adoptimit për Fëmijët pa Përkujdesje Prindërore;
6. Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2016 për Rregullimin e Strehimit Familjar në Kosovë;
7. Udhëzimi Administrativ (MPMS) Nr.08/2017 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Udhëzimit Administrativ Nr.02/2016 për Rregullimin e Strehimit Familjar në Kosovë;
8. Udhëzimi Administrativ Nr.10/2014 për Punën dhe Kriteret për Vendosjen e Rezidentëve në Shtëpinë e Personave të Moshuar pa Përkujdesje Familjare dhe në Shtëpitë me Bazë në Komunitet;
9. Udhëzimi Administrativ Nr.116/2014 për Punën dhe Vendosjen e Rezidentëve, Personave me Aftësi të Zvogëluar Mendore - Ngecje në Zhvillimin Mendor në Institutin Special në Shtime, dhe në Shtëpitë me Bazë në Komunitet;
10. Udhëzimi Administrativ (MPMS) Nr.03/2009 për Rregullimin dhe Përcaktimin e Procedurave të Aplikimit për Realizimin e të Drejtës në Ndhimë Materiale për Familjet me Fëmijë me Aftësi të Kufizuara të Përhershme;

11. Udhëzimi Administrativ Nr. 07/2010 Për Plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr.03/2009 për Rregullimin dhe Përcaktimin e Procedurave të Aplikimit për Realizimin e të Drejtës në Ndhimë Materiale për Familjet me Fëmijë me Aftësi të Kufizuara të Përhershme;
12. Udhëzimi Administrativ (MPMS) Nr.06/2014 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr.07/2010 për Rregullimin dhe Përcaktimin e Procedurave të Aplikimit për Realizimin e të Drejtës në Ndhimë Materiale për Familjet me Fëmijë me Aftësi të Kufizuara të Përhershme;
13. Udhëzimi Administrativ Nr.14/2013 për Monitorimin dhe Inspektimin e Subjekteve Juridike/Organizatave që Ofrojnë Shërbime Sociale dhe Familjare;
14. Rregullore e Punës Nr.999 të Njësisë për Monitorim /Inspektim të Shërbimeve Sociale dhe Familjare;
15. Udhëzim Administrativ (MPMS) Nr.08/2013 për Trajtimin e Fëmijëve Kryerës të Veprave Penale pa Përgjegjësi Penale dhe Atyre me Sjellje Asociale;
16. Rregullorja Nr. 352/2014 e Punës së Këshillit të Përgjithshëm për Shërbime Sociale dhe Familjare;
17. Udhëzimi Administrativ Nr. 10/2012 për Organizimin, Fushëveprimin dhe Funksonimin e Këshillit të Përgjithshëm të Shërbimeve Sociale dhe Familjare;
18. Udhëzimi Administrativ (MPMS) Nr. 06/2017 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Udhëzimit Administrativ Nr.10/2010 për Organizimin, Fushëveprimin dhe Funksonimin e Këshillit për Shërbime Sociale dhe Familjare;
19. Udhëzimi Administrativ (MPMS) Nr. 20/2015 për Financimin e Aktiviteteve të Këshillit për Shërbimet Sociale dhe Familjare (KPSHSF) dhe kompensimet e Anëtarëve të tij;
20. Rregullore Nr. 01/2016 për Funksonin e Punës në Strehimore për Mbrojtjen dhe Rehabilitimin e Viktimave me Qenie Njerëzore në Nivel të Mesëm dhe të Lartë të Rrezikshmërisë;
21. Udhëzimi Administrativ (MPMS) Nr. 01/2020 për Licencimin e Ofruesve të Shërbimeve Sociale dhe Familjare të Nivelit Bazik, të Mesëm dhe të Lartë;
22. Udhëzimi Administrativ (MPMS) Nr. 02/2020 për Licencimin e Organizatave Jo Qeveritare dhe Subjekteve Juridike Private që Ofrojnë Shërbime Sociale dhe Familjare;
23. Udhëzimi Administrativ (MMPS) Nr. 03/2020 Për Licencimin E Ofruesve Të Shërbime Sociale Dhe Familjare Në Nivel Profesional.

1.2. Aktet ligjore që rregullojnë Skemën e Ndhimës Sociale

1. Ligji Nr. 2003/15 për Skemën e Ndhimës Sociale në Kosovë;
2. Ligji Nr. 04/L-096 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 2003/15 për Skemën e Ndhimës Sociale në Kosovë.

1.2.1. Aktet nënligjore që rregullojnë fushën e Skemës së Ndhimës Sociale

1. Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2010 për Procedurat për Delegimin e Përgjegjësive për Skemën e Ndhimave Sociale në Nivelin Komunal;
2. Udhëzimi Administrativ Nr. 04/2013 për Procedurat e Paraqitjes së Kërkesave për Ndhimë Sociale;
3. Udhëzimi Administrativ Nr.16/2013 për Përcaktimin e Kushteve dhe Kriteve për Realizimin e Ndhimave Sociale për të Huajt në Republikën e Kosovës;
4. Udhëzimi Administrativ Nr. 08/2010 për Procedurat Administrative të Kthimit të Pagesave nga Shfrytëzuesit e Skemës së Ndhimës Sociale të Fituara pa Bazë Ligjore;

5. Udhëzimi Administrativ Nr. 03/2017 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr.08/2010 për Procedurat Administrative të Kthimit të Pagesave nga Shfrytëzuesit e Skemës së Ndhmës Sociale të Fituara pa Bazë Ligjore;
6. Udhëzimi Administrativ Nr. 11/2013, për Procedurat e Punës së Komisionit Mjekësor për Aplikuesit për Ndhmë Sociale në Kategorinë e Parë;
7. Udhëzimi Administrativ Nr. 12/2013 për Përcaktimin e Procedurave për Pagesat e Ndhmave të Njëhershme;
8. Udhëzimi Administrativ Nr. 03/2013 për Procedurat e Regjistrimit, Certifikimit dhe Kërkimit Aktiv të Punësimit për të Papunësuarit që Aplikojnë për Skemën e Ndhmës Sociale;
9. Udhëzimi Administrativ Nr. 06/2013 për Përlllogaritjen e të Mirave Materiale dhe jo Materiale si dhe të Hyrave të Llogaritshme dhe jo të Llogaritshme;
10. Udhëzimi Administrativ Nr. 15/2012 për Përlllogaritjen e Shumës Mujore të Ndhmës Sociale;
11. Udhëzimi Administrativ (MPMS) Nr. 04/2017 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr.15/2012 për Përlllogaritjen e Shumës Mujore të Ndhmës Sociale.

1.3. Marrëveshjet e Bashkëpunimit/Mirëkuptimit

1. Marrëveshje Mirëkuptimi për bartjen e kompetencave të shërbimeve sociale dhe delegimin e përgjegjësi të ndihmave sociale në nivel komunal (2009 për QPS-të dhe 2016 për Shtëpitë në Komunitet);
2. Marrëveshje Mirëkuptimi me MPB-së për menaxhimin dhe zbatimin e Programit të Riintegritimit të personave të riadhesuar;
3. Marrëveshje Bashkëpunimi me PK.SH.A- BPB për shpërndarjen e ndihmave sociale (2019-2021);
4. Marrëveshje Bashkëpunimi me SOS Fshatrat e Fëmijëve;
5. Marrëveshje Bashkëpunimi me Fondacionin “Terre des Hommes”
6. Marrëveshje Bashkëpunimi me Organizatën për Fëmijët pa Kujdes Prindëror – OFAP;
7. Marrëveshje Bashkëpunimi me ATK;
8. Marrëveshje Bashkëpunimi me KEDS;
9. Marrëveshje Bashkëpunimi me ARBK.
10. Marrëveshje Bashkëpunimi me FSSH;
11. Marrëveshje Bashkëpunimi me MPB/ARC;
12. Marrëveshje Bashkëpunimi me BpB/PKSH.A/NLB;
13. Marrëveshje Bashkëpunimi me APPK.

1.4. Standardet minimale dhe specifikimi i shërbimeve sociale dhe familjare

1. Dhuna në familje/fëmijët dhe të rriturit;
2. Fëmijët në forma të rënda të punës;
3. Adoptimi i fëmijëve pa përkujdesje prindërore;
4. Besimi i fëmijëve në familjet e prindërve të shkurorëzuar dhe të ndarë;
5. Përkujdesja institucionale për personat e moshuar;
6. Kujdestaria;
7. Ribashkimi familjar;

8. Fëmijët me sjellje asociale/fëmijët kryerës të veprave penale pa përgjegjësi penale;
9. Fëmijët e keqtrajtuar/të lënë pas dore;
10. Fëmijët me aftësi të kufizuara;
11. Shërbimi për fëmijët në konflikt me ligjin me përgjegjësi penale;
12. Shërbimi për viktimat e trafikimit me njerëz;
13. Shërbimi për fëmijët përdorues të substancave psiko-aktive;
14. Shërbimi për fëmijët e strehuar në familje me lidhje farefisnore;
15. Shërbimi për fëmijët në strehim familjar dhe familjet strehuese;
16. Standardet minimale të cilësisë së shërbimeve sociale për fëmijët viktime të krimeve seksuale;
17. Standardet minimale të cilësisë së shërbimeve sociale për të miturit që hyjnë në martesë;
18. Standardet minimale të cilësisë së shërbimeve sociale në shtëpi për personat e moshuar;
19. Standardet minimale të cilësisë së shërbimeve sociale në shtëpi për personat me aftësi të kufizuara;
20. Korniza e Shërbimeve dhe Korniza e Standardeve minimale të cilësisë për persona të moshuar në Shtëpi të Komunitetit;
21. Standardet minimale të cilësisë së shërbimeve sociale në shtëpi rezidenciale për persona me aftësi të kufizuara intelektuale (fëmijë dhe të rritur);
22. Korniza e shërbimeve dhe standardet minimale të cilësisë së shërbimeve sociale për fëmijë me aftësi të kufizuara në Qendrat e Kujdesit Ditor.

2. DEPARTAMENTI PËR POLITIKA SOCIALE DHE I FAMILJES

2.1. Detyrat dhe përgjegjësitë

Departamenti për Politika Sociale dhe i Familjes (DPSF), vepron në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve. Detyrat dhe përgjegjësitë e DPSF-së, janë të përcaktuara në Ligjin Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare dhe me Ligjin Nr. 04/L-081 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare.

Bazuar në legjislacionin e cekur më lartë, përgjegjësitë e DPSF-së janë:

- ✓ *Bashkëpunon me komunat, rrethet akademike, ministritë e tjera dhe me palët e interesuara për ruajtjen e nivelit dhe përparimin e shërbimeve sociale dhe familjare;*
- ✓ *Ofron propozime, sugjerime dhe këshilla për Ministrinë dhe Qeverinë e Republikës së Kosovës në lidhje me zhvillimin e politikave që kanë të bëjnë me shërbimet sociale dhe familjare;*
- ✓ *Përgatit udhëzime administrative, urdhëresa dhe udhëzime në lidhje me ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare;*
- ✓ *Nxjerr udhëzime në lidhje me standardet e nivelit të shërbimeve që duhet të plotësohen nga ofruesit e shërbimeve sociale dhe familjare;*
- ✓ *Licencon OJQ-të të cilat ofrojnë shërbime sociale dhe familjare;*
- ✓ *Zhvillon inspektime të shërbimeve sociale dhe familjare;*
- ✓ *Shqyrton raportet vjetore të drejtorive përkatëse komunale dhe miraton planet vjetore të punës së tyre;*
- ✓ *Miraton themelimin e objekteve rezidenciale për përkujdesje nga ana e ofruesve të shërbimeve sociale dhe familjare;*
- ✓ *Merr përgjegjësinë e menaxhimit të drejtpërdrejtë të shërbimeve sociale dhe familjare në rastet kur komuna dështon në vazhdimësi dhe në mënyrë serioze, që të plotësojë standardet e pranueshme për kryerjen e shërbimeve;*

- ✓ *Jep udhëzime në lidhje me parashtrimin e kërkesave për urdhër kujdestarie para gjykatave, të cilat kanë të bëjnë me fëmijët dhe të rriturit e rrezikuar;*
- ✓ *Në raste të veçanta, bën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të rasteve të shërbimeve sociale dhe familjare;*
- ✓ *Themelon dhe koordinon panelin për vendosjen e fëmijëve në strehim familjar, ose zhvillimin e procedurës së ankesave në lidhje me shërbimet sociale dhe familjare;*
- ✓ *Bën hulumtime në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare, nxit ngritjen profesionale të kuadrit nëpërmjet trajnimit dhe ofrimit të këshillimit për profesionistët;*
- ✓ *Publikon doracakë përkatës, raporte për rezultatet e kërkimeve dhe materiale promovuese.*
- ✓ *Inspekton komisionimin e shërbimeve sociale dhe familjare në institucionet e përcaktuara me ligj, si dhe në organizatat joqeveritare dhe në sektorin privat. Në lidhje me këto aktivitete përpilon një raport vjetor me shkrim.*

Udhëheqësi i DPSF-së, raporton tek Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë.

2.2. Struktura Organizative e Departamentit (niveli qendror dhe niveli lokal)

Në kuadër të DPSF-së veprojnë gjashtë (6) Divizione, të cilat janë:

1. Divizioni i Shërbimeve Sociale;
2. Divizioni për Aftësinë e Kufizuar dhe Personat e Moshuar;
3. Divizioni i Ndihmës Sociale;
4. Divizioni për Planifikim dhe Përfshirje Sociale;
5. Divizioni i Politikave Sociale, dhe
6. Divizioni për Mbështetje Administrative i KPSHSF-së.

Në DPSF janë të punësuar rreth dyzetë (40) zyrtarë, të cilët janë të shpërndarë nëpër Divizionet e cekura më lartë.

2.2.1. Institucionet në nivel qendror

Departamenti është përgjegjës për administrimin dhe menaxhimin edhe të tri (3) institucioneve të karakterit nacional, të cilat ofrojnë shërbime njëzetë e katër orë (24 orë) për personat e moshuar pa përkujdesje familjare, fëmijët e braktisur dhe me aftësi të kufizuara dhe personat e rritur, po ashtu me aftësi të kufizuara mendore-ngecje në zhvillimin mendor. Këto institucione janë:

1. Instituti Special në Shtime;
2. Shtëpia e Personave të Moshuar në Prishtinë;
3. Shtëpia e Komunitetit për Fëmijë në Shtime;

Në këto institucione janë të punësuar rreth 140 punëtorë.

2.2.2. Institucionet në nivel lokal

DPSF-ja, po ashtu, është përgjegjëse të monitorojë, koordinojë dhe të ketë një bashkëpunim të ngushtë me institucionet e nivelit lokal, të cilat ofrojnë shërbime sociale dhe familjare për familje/individë në nevojë sociale, ndihmë sociale dhe shërbime të kujdesit për personat e moshuar dhe personat me aftësi të kufizuara (fëmijë dhe të rritur) në komunitet.

Institucionet, të cilat janë nën përgjegjësi të komunave, si rezultat i procesit të decentralizimit të shërbimeve sociale kanë kaluar me kompetenca në nivelin e përgjegjësive komunale, QPS-të në vitin 2009 dhe Shtëpitë me Bazë në Komunitet në vitin 2016, ndërsa Ministria kujdeset për sigurimin dhe krijimin e qëndrueshëm të financimit të tyre. Institucionet të cilat zbatojnë legjislacionin, politikat, standardet e DPSF/MFPT dhe ofrojnë shërbimet për qytetarët, në nivel lokal janë:

- Qendrat për Punë Sociale (40 QPS në 38 komuna, përfshirë edhe dy njësitë në Prishtinë);
- Shtëpitë me Bazë në Komunitet për Personat me Aftësi të Kufizuara Mendore-Ngecje në Zhvillim Mendor (8 shtëpi në këto Komuna: Prizren, Kamenicë, Ferizaj, Deçan, Shtime, Vushtrri, Graçanicë dhe Lipjan);
- Shtëpitë me Bazë në Komunitetit për Personat e Moshuar pa Përkujdesje Familjare (4 shtëpi në këto Komuna: Skenderaj, Istog-Gurakoc, Novobërdë, Graçanicë).

2.2.3. Trupat punues

Trupat punues që veprojnë në kuadër të DPSF-së janë:

- Këshilli i Përgjithshëm për Shërbime Sociale dhe Familjare;
- Paneli për Vendosjen e Fëmijëve në Strehim dhe Adoptim;
- Komiteti Nacional për Eliminimin e Punëve të Rënda;
- Njësia për Inspektimin/Monitorimin e Shërbimeve Sociale;
- Njësia e Kontrollit dhe e Mbikëqyrjes për Skemën e Ndihmës Sociale.

3. DIVIZIONI I SHËRBIMEVE SOCIALE

3.1. Detyrat dhe përgjegjësitë

Divizioni i Shërbimeve Sociale (DSHS), vepron në kuadër të Departamentit për Politika Sociale dhe i Familjes në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT). Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit të Shërbimeve Sociale, janë:

- ✓ *Sigurimi i funksionimit të shërbimeve sociale dhe familjare;*
- ✓ *Propozimi, hartimi dhe monitorimi i zbatimit të standardeve dhe procedurave për shërbime sociale, në harmoni me standardet e BE-së;*
- ✓ *Propozimi, hartimi dhe sigurimi i zbatimit të legjislacionit për shërbime sociale në harmoni me standardet e BE-së;*
- ✓ *Koordinimi i aktiviteteve me institucionet relevante;*
- ✓ *Monitorimi i punës së shërbimeve sociale në Qendrat për Punë Sociale;*
- ✓ *Bashkëpunimi me organizatat joqeveritare në fushën e shërbimeve sociale;*
- ✓ *Propozimi dhe hartimi i programe për ngritjen e aftësive profesionale të zyrtarëve të shërbimeve sociale.*

Udhëheqësi i Divizionit për Shërbime Sociale, raporton tek Udhëheqësi i Departamentit për Politika Sociale dhe të Familjes.

3.2. Ofrimi i shërbimeve sociale

Shërbimet sociale ofrohen kryesisht në nivel lokal. Aktorët kryesorë të sistemit të ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare në nivel lokal, janë: Drejtoritë për Shëndetësi dhe Mirëqenies Sociale (DSHMS), Qendrat për Punë Sociale (QPS), Institucionet Rezidenciale si dhe Rrjeti i OJQ-ve të zhvilluara për të mbështetur grupet e cenushme. Gjithsej funksionojnë 40 QPS, të shpërndara nëpër 38 komuna të Republikës së Kosovës, të cilat sigurojnë mbulimin gjeografik të tërë vendit.

Bazuar në Bazën e të dhënave të shërbimeve sociale dhe familjare, gjatë vitit 2021, Qendrat për Punë Sociale kanë trajtuar me shërbime të nevojshme sociale dhe familjare 9.177 individë/familje në nevojë sociale. Nga ky total, 2.752 apo 30% janë raste të mbyllura, ndërsa 6.425 apo 70% janë raste aktive dhe do të vazhdojnë të trajtohen me shërbime të nevojshme dhe gjatë vitit 2022.

Numri i individëve/familjeve në gjendje të nevojës sociale dhe familjare, që kanë pranuar shërbime sociale gjatë vitit 2021, sipas kategorive dhe bazuar në politikat sociale të mbrojtjes dhe në legjislacionin në fuqi është paraqitur më poshtë:

3.3. Fëmijët pa kujdes prindëror dhe format e mbrojtjes sociale

Fëmijë pa kujdes prindëror, konsiderohet fëmija prindërit e të cilit nuk janë gjallë, prindërit e të cilit janë të panjohur ose janë zhdukur dhe fëmija prindërit e të cilit për çfarëdo arsye, në mënyrë të përkohshme ose të përhershme nuk i kryejnë detyrat e tyre prindërore ose kujdesin prindëror.²

Mandatin për t'iu ofruar mbrojtje dhe shërbime sociale fëmijëve pa kujdes prindëror e ka Organi i Kujdestarisë, i cili është organ komunal profesional kompetent për çështje sociale, përgjegjës për mbrojtjen e interesave të fëmijëve dhe të rriturve, i përbërë nga një grup ekspertësh që vepron në kuadër të Qendrës për Punë Sociale.³ Fëmija pa kujdesin prindëror gëzon mbrojtje të posaçme shoqërore. Format themelore të mbrojtjes juridike dhe familjare të fëmijëve pa kujdesin prindëror, në kuptim të Ligjit për Familjen janë: *kujdestaria, strehimi familjar, strehimi rezidencial dhe adoptimi*.⁴

Te kategoria e fëmijëve pa kujdes prindëror hyjnë *fëmijët e braktisur, potencial për braktisje dhe fëmijët pa përkujdesje prindërore për arsye të tjera, siç janë fëmijët e prindërve të penguar në kryerjen e të drejtës prindërore, fëmijët e abuzuar dhe të keqtrajtuar, etj.*

3.3.1. Fëmijët e braktisur

Bazuar në të dhënat e raportuara nga ana e Qendrave për Punë Sociale, gjatë vitit 2021 janë raportuar pesëmbëdhjetë (15) raste të reja të fëmijëve të braktisur, të cilët janë paraqitur në tabelën dhe figurën më poshtë:

² Shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2410>; neni 156, pika 1 dhe 2, Ligji Nr. 02/L-17 Ligji për Familjen i Kosovës;


³ Shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2808>; neni 1, pika 7 e Ligji Nr. 04/L-081 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare;

⁴ Shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2410>; Neni 157, pika 1 dhe 2 Ligji Nr. 02/L-17 Ligji për Familjen i Kosovës;

Tabela 1: Rastet e reja të fëmijëve të braktisur sipas QPS-ve, 2021


QPS	Muajt												Gjinia		Totali
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Djem	Vajza	
Ferizaj	1													1	1
Fushë Kosovë						1							1		1
Gjilan							1					1	1	1	2
Drenas												1	1		1
Malishevë		1								1			2		2
Partesh					1								1		1
Pejë											1		1		1
Prishtinë		1			1				1				1	2	3
Prizren								1						1	1
Suharekë					1								1		1
Vushtrri		1											1		1
Totali	1	3	0	0	3	1	1	1	1	1	1	2	10	5	15

Në vitin 2021, numri i fëmijëve të braktisur ka rënë për trembëdhjetë (13) fëmijë më pak, apo minus 46% në krahasim me vitin paraprak.


Figura 1: Rastet e reja të fëmijëve të braktisur, janar-dhjetor 2021

Bazuar në tabelën dhe në figurën më poshtë, del që në QPS-në e Prishtinës është evidentuar numri më i madh i fëmijëve të braktisur, katër (4) fëmijë, pastaj në QPS-në e Gjilanit dy (2) fëmijë e kështu me radhë.

Ndërsa sa i përket strukturës gjinore del që dhjetë (10) fëmijë të braktisur apo 60% janë djem ndërsa pesë (5) fëmijë apo 40% janë vajza. Shih figurën 2:

Figura 2: Fëmijët e braktisur sipas gjinisë, 2021

Muaji dhjetor 2021, është mbyllur me tridhjetë e një (31) fëmijë të cilët barten në vitin 2022. Fëmijët e braktisur që do të barten në vitin 2022 janë të vendosur si në figurën 3:

Figura 3: Fëmijët e braktisur që barten në vitin 2021, sipas vendit ku janë të vendosur

Nga figura 3, konstatohet se numri më i madh i fëmijëve të braktisur që barten në vitin 2022, janë të vendosur në strehim familjar jashtë familjes biologjike, njëzetë e shtatë (27) fëmijë apo 87%, në Klinikën Neonatologjike/QKUK dy (2) fëmijë apo 7%, në SOS Familje/SOS Fshatrat e Fëmijëve një (1) fëmijë apo 3% dhe në Shtëpinë e Fëmijës në Shtime nga një (1) fëmijë apo nga 3%.

Nga numri i përgjithshëm i fëmijëve të braktisur, të cilët janë në sistem të mbrojtjes sociale, tetë (8) prej tyre janë të evidentuar si fëmijë me nevoja të veçanta.

3.3.2. Kujdestaria

Kujdestaria është formë themelore e mbrojtjes sociale, e cila aplikohet dhe realizohet për çdo fëmijë pa përkujdesje prindërore.

Fëmijët e mitur vendosen në kujdestari dhe gëzojnë mbrojtje të veçantë nga institucionet publike:

- a. kur prindërit e tyre e kanë të pamundur të ushtrojnë përkujdesjen prindërore,
- b. për shkak se të dy prindërit kanë vdekur ose nuk njihen, janë shpallur të zhdukur, u është hequr kujdesi prindëror ose kanë humbur aftësinë për të vepruar,
- c. apo për çdo shkak tjetër i cili me vendim të gjykatës jep arsye për vendosje në të mirë të mirëqenies së fëmijës.⁵

Kujdestarë ligjorë zakonisht caktohen persona në lidhje familjare, të cilët legjitimohen me Vendim të Qendrës për Punë Sociale dhe monitorohen nga QPS-të. Kujdestari Ligjor mund të caktohet edhe nga Organi i Kujdestarisë i QPS-së. Mandati i Kujdestarit Ligjor është i përcaktuar në legjislacionin e aplikueshëm, ku roli i tij është që të përfaqësojë fëmijën e të mbrojë të drejtat dhe interesat e tij deri në zgjidhjen e statusit ligjor përfundimtar për fëmijën që është nën përkujdesje.

Çdo fëmijë i evidentuar si fëmijë i braktisur dhe pa përkujdesje prindërore gjatë periudhës janar-dhjetor 2021, ka përfituar nga kjo formë e mbrojtjes sociale. Pra, gjatë vitit 2021, në kujdestari kanë qenë të vendosur 685 fëmijë pa përkujdesje prindërore.

3.3.3. Bashkimi familjar

Me qëllim të mbrojtjes së interesave në të mirë të fëmijëve të braktisur dhe pa përkujdesje prindërore (të braktisur, të keqtrajtuar, të prindërve të penguar në ushtrimin e detyrës prindërore apo rasteve të tjera kur cenohet interesi dhe mirëqenia e fëmijës/ve, etj.), Qendrat për Punë Sociale edhe gjatë këtij viti i kanë dhënë prioritet krijimit të kushteve për kthimin e fëmijëve në familjet biologjike, apo bashkimit familjar. Në kuadër të këtij angazhimi, gjatë vitit 2021, QPS-të kanë realizuar nëntë (9) raste të bashkimit familjar të fëmijëve të braktisur me familjet e tyre biologjike, prej tyre shtatë (7) fëmijë të lindur gjatë vitit 2021 dhe dy (2) fëmijë të bartur nga viti paraprak.

⁵ Shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2410>;

3.3.4. Strehimi Familjar

Është formë alternative e mbrojtjes sociale për fëmijët pa kujdes prindëror, të keqtrajtuar dhe të lënë pas dore. Kjo formë e mbrojtjes nënkupton vendosjen e përkohshme të fëmijës në familje tjetër atëherë kur qëndrimi i fëmijës në familjen biologjike është i pamundur.⁶ Bazuar në legjislacionin në fuqi, strehimi familjar realizohet në dy forma: *Strehimi familjar brenda familjes biologjike dhe Strehimi familjar jashtë familjes biologjike*.

Niveli qendror (Ministria) vazhdon t'i mbështesë financiarisht të dyja format e strehimit familjar, me pagesa të rregullta mujore, të cilat janë të rregulluara me vendim të nxjerrë nga Ministri.

Strehimi familjar brenda familjes biologjike - nënkupton strehimin e fëmijës në familje me lidhje fisnore.⁷

Familje strehuese nga fafisi, konsiderohen të afërmit e fëmijës që në mënyrë vullnetare kanë pranuar mbikëqyrjen dhe strehimin e fëmijës/ve pa kujdes prindëror, prindërit e të cilëve përkohësisht apo në mënyrë të përhershme nuk janë në gjendje që të ushtrjnë detyrat e tyre prindërore. Kjo formë e mbrojtjes sociale, iu ofrohet fëmijëve të braktisur e pa kujdes prindëror (fëmijëve të lënë pas dore, të keqtrajtuar, të prindërve të penguar në ushtrimin e detyrës prindërore, apo rasteve të tjera kur cenohet interesi dhe mirëqenia e fëmijës/ve).

Strehimi familjar brenda familjes biologjike është i rregulluar me aktet ligjore e nënligjore. Puna profesionale në këtë proces është legjitimuar nga QPS-të kompetente me vendim, kontratë e mbikëqyrje profesionale. Pagesa e rregullt mujore për një fëmijë të vendosur në strehim familjar brenda familjes biologjike, është 100 euro. Pagesat realizohen përmes llogarive bankare dhe bëhen në emër të kujdestarëve strehues.

Edhe gjatë vitit 2021, për shkak të gjendjes së krijuar nga COVID-19, si pjesë e Pakos Emergjente, me vendim të nxjerrë nga Qeveria e Republikës së Kosovës, të gjithë fëmijëve të vendosur në strehim familjar brenda familjes biologjike, iu është paguar shtesa prej 30 euro për tre muaj radhazi (janar, shkurt dhe mars 2021), ndërsa për muajin nëntor 2021 të gjithë fëmijëve në strehim familjar iu është paguar shtesa prej 100 euro si pjesë e Pakos së Ringjalljes Ekonomike.

Gjatë vitit 2021, numri i fëmijëve në strehim familjar brenda familjes ka ndryshuar nga muaji në muaj. Numri më i madh i fëmijëve përfitues vërehet të ketë qenë në muajin janar 2021. Këtë muaj kanë përfituar 455 fëmijë. Ndërsa numrin më të vogël e kemi në muajin nëntor, në këtë muaj kanë përfituar 126 fëmijë.


Numri mesatar i fëmijëve të vendosur në strehim familjar brenda familjes gjatë vitit 2021 është rreth 439 fëmijë për çdo muaj. Shih tabelën dhe figurën më poshtë:

⁶ Neni 3, pika 1.9 e Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr. 02/2016 për Rregullimin e Strehimi Familjar në Kosovë

⁷ Po aty, Neni 3, pika 1.11.


Tabela 2: Numri i fëmijëve në strehim familjar brenda familjes sipas muajve, 2021

Muaji	Numri i familjeve strehuese	Numri i fëmijëve	Shuma e mjeteve
Janar	329	455	59,150.00
Shkurt	325	452	58,760.00
Mars	322	444	57,850.00
Prill	322	442	44,200.00
Maj	320	442	44,200.00
Qershor	318	437	43,700.00
Korrik	317	435	43,900.00
Gusht	316	435	43,500.00
Shtator	318	436	43,600.00
Tetor	312	428	42,800.00
Nëntor	312	426	85,200.00
Dhjetor	319	436	43,600.00
Totali			610,460.00

Figura 4: Numri i fëmijëve të vendosur në strehim familjar brenda familjes sipas muajve, 2021

Gjatë vitit 2021, në strehim familjar brenda familjes janë vendosur shtatëdhjetë (70) fëmijë, raste të reja, ndërsa janë larguar nga strehimi familjar pesëdhjetë (50) fëmijë, kryesisht fëmijë që e kanë arritur moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare.

Muaji dhjetor 2021 është mbyllur me 436 fëmijë, 25 fëmijë më pak apo minus 5% në krahasim me të dhënat e muajit të njëjtë të vitit paraprak, të cilët barten në vitin 2022 dhe do të vazhdojnë të jenë aktiv dhe të paguhen sipas legjislacionit në fuqi deri sa ta arrijnë moshën 18 vjeç.

Figura 5: Shuma e mjeteve të procesuara për pagesën e strehimit familjar të farefisit, 2021

Bazuar në figurën e mësipërme, konstatohet se shuma më e lartë e mjeteve (pa llogaritur shtesën prej 30 euro të muajve janar, shkurt dhe mars e qershor dhe shtesën prej 100 euro të muajit nëntor 2021), është procesuar në muajin janar 2021, këtë muaj janë procesuar 45,500 euro. Ndërsa shuma më e ulët është procesuar në muajin tetor, këtë muaj janë procesuar 42,800 euro. Gjatë vitit 2021, shuma mesatare e mjeteve të procesuara del të jetë 43,944.17 euro për çdo muaj.

Buxheti i shpenzuar për pagesën e strehimit familjar brenda familjes për vitin 2021 është: 610,460 euro. Nëse e minusojmë shumën e mjeteve shtesë prej 83,130 euro, buxheti i shpenzuar del të jetë 527,330 euro. Pra, në vitin 2021 kemi një rënie për 50,770 euro më pak, apo për minus 9% të buxhetit të shpenzuar në krahasim me vitin paraprak. Ndërsa mjete shtesë për këtë kategori gjatë vitit 2021 janë ndarë 39,150 euro më shumë apo plus 89% në krahasim me vitin paraprak.

Strehimi familjar jashtë familjes biologjike - nënkupton strehimin e fëmijës në familje alternative që nuk kanë asnjë lidhje farefisnore.⁸ Kjo formë e mbrojtjes sociale iu ofrohet fëmijëve të braktisur e pa kujdes prindëror (fëmijëve të lënë pas dore, të keqtrajtuar, të prindërve të penguar në ushtrimin e detyrës prindërore, apo rasteve të tjera kur cenohet interesi dhe mirëqenia e fëmijës/ve). Familjet strehuese janë familje alternative që përzgjidhen, vlerësohen, trajnohen nga QPS-të komunale dhe aprovohen nga Paneli i cili vepron në kuadër të Departamentit, të cilat janë të gatshme për përkujdesje të fëmijëve pa përkujdesje prindërore për një periudhë të caktuar kohore.⁹ Pra, familja strehuese nuk ka lidhje familjare me fëmijën që vendoset në strehim familjar jashtë familjes.


⁸ Neni 3, pika 1.12, e Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr. 02/2016 për Rregullimin e Strehimit Familjar në Kosovë

⁹ Po aty, Neni 3, pika 1.10,

Pagesa për një fëmijë të vendosur në strehim familjar jashtë familjes është 250 euro në muaj, ndërsa për një fëmijë me nevoja të veçanta, të vendosur në strehim familjar jashtë farefisit është rritur në 350 euro në muaj. Në muajin e parë të vendosjes së fëmijës në strehim familjar jashtë farefisit, aplikohet edhe një pagesë fillestare në shumë prej 75 euro.

Gjatë vitit 2021 në strehim familjar jashtë familjes ishin të vendosur 74 fëmijë pa kujdes prindëror. Prej tyre 57 fëmijë janë raste të bartura nga vitet paraprake (18 fëmijë pa përkujdesje prindërore dhe 39 fëmijë të braktisur) dhe 27 fëmijë janë raste të reja (8 fëmijë pa përkujdesje prindërore dhe 9 fëmijë të braktisur). Bazuar në Rregulloren e Punës së Panelit, 25 fëmijë, raste të reja, janë vendosur në strehim paraprakisht me pëlqim, për shkak të nevojës urgjente për strehimin e tyre. Për më tepër, shih figurën 6:

Figura 6: Rastet e reja dhe rastet e bartura të fëmijëve në strehim familjar jashtë familjes, 2021




Në vitin 2021, numri i fëmijëve të vendosur në strehim familjar jashtë familjes, ka rënë për 3 fëmijë apo 4% më pak në krahasim me vitin paraprak.

Numri më i madh i fëmijëve në strehim familjar jashtë familjes biologjike, është shënuar në muajin janar 2021. Këtë muaj ishin të vendosur 58 fëmijë dhe numri më i vogël është shënuar në muajt gusht dhe shtator, në këta muaj ishin të vendosur nga 50 fëmijë. Ndërsa mesatarisht për çdo muaj kanë qenë të vendosur nga 54 fëmijë. Shih tabelën dhe figurën më poshtë:


Tabela 3: Fëmijët në strehim familjar jashtë familjes dhe familjet strehuese, 2021

Muaji	Numri i familjeve strehuese	Numri i fëmijëve	Shuma e mjeteve
Janar	31	58	15,625.00
Shkurt	31	55	14,800.00
Mars	31	56	14,975.00
Prill	31	55	15,200.00
Maj	31	55	14,950.00
Qershor	31	55	14,625.00
Korrik	32	55	14,775.00
Gusht	31	50	13,300.00
Shtator	30	50	13,375.00
Tetor	30	51	13,700.00
Nëntor	30	52	15,450.00
Dhjetor	30	51	13,550.00
Totali:			174,325.00

Figura 7: Fëmijët në strehim familjar jashtë familjes dhe familjet strehuese, 2021

Muaji dhjetor 2021 është mbyllur me 46 fëmijë (në fund të muajit dhjetor, 5 fëmijë kanë shkuar në paraadoptim), të cilët praktikisht do të barten në vitin 2022. Prej 46 fëmijëve, 8 fëmijë janë fëmijë me nevoja të veçanta.

Krahasuar me muajin e njëjtë të vitit paraprak, në muajin dhjetor 2021 kemi një rënie për 9 fëmijë më pak apo minus 15%.

Figura 8: Shuma e mjeteve të procesuar për pagesën e strehimit familjar jashtë familjes, 2021

Bazuar në Figurën 8, konstatohet se në muajin janar është procesuar shuma më e lartë e mjeteve për pagesën e strehimit familjar jashtë familjes. Në këtë muaj janë procesuar 15,625 euro, ndërsa shuma më e ulët është procesuar në muajin gusht. Këtë muaj janë procesuar 13,300 euro. Gjatë vitit 2021, shuma mesatare e mjeteve të procesuara del të jetë 14,527.08 euro për çdo muaj.

Buxheti i shpenzuar për vitin 2021 është 174,325 euro. Pra, në vitin 2021 kemi një rënie të shumës së mjeteve të procesuara për 10,850 euro më pak, apo minus 6% në krahasim me vitin paraprak.

3.3.5. Adoptimi


Adoptimi është formë e përhershme e mbrojtjes sociale për fëmijët e braktisur dhe pa përkujdesje prindërore, e cila iu ofrohet fëmijëve potencial për adoptim vendor dhe adoptim ndërkombëtar, gjithmonë duke vlerësuar interesin më të lartë të fëmijëve.

Kërkesat për adoptim të parashtruara nga QPS-të, Gjykata Themelore si dhe nga autoritetet e huaja ndërkombëtare, shqyrtohen dhe vlerësohen nga Paneli, Trup Profesionale që vepron në kuadër të DPSF-së, anëtarët e të cilët janë përfaqësues nga QPS-të dhe OJQ-të.

Gjatë vitit 2021, Paneli ka mbajtur tetë (8) takime, me ç'rast është bërë shqyrtimi dhe aprovimi i njëzetë e dy (22) kërkesave për adoptim, nga të cilat njëzetë (20) kërkesa janë aprovuar për adoptim vendor dhe dy (2) kërkesa për adoptim ndërkombëtar. Shih tabelën dhe figurën më poshtë:

Tabela 4: Kërkesat për adoptim sipas QPS-ve, të ndara sipas gjinisë, nacionalitetit 2021

Nr.	QPS	Nr. i fëmijëve	Gjinia		Nacionaliteti		Adoptim Vendor	Adoptim Ndërkombëtar
			Djem	Vajza	Shqiptar	Rom, Ashkali, Egjiptian		
1	Fushë Kosovë	2	2	0	1	1	2	0
2	Hani i Elezit	1	1	0	1	0	1	0
3	Ferizaj	2	1	1	1	1	2	0
4	Mitrovicë	2	2	0	2	0	2	0
5	Gjakovë	1	1	0	0	1	0	1
6	Drenas	1	1	0	1	0	1	0
7	Shtime	1	0	1	1	0	1	0
8	Viti	1	0	1	1	0	1	0
9	Prizren	4	4	0	3	1	3	1
10	Pejë	1	1	0	1	0	1	0
11	Vushtrri	2	1	1	2	0	2	0
12	Gjilan	1	1	0	1	0	1	0
13	Lipjan	1	0	1	1	0	1	0
14	Obiliq	1	0	1	1	0	1	0
15	Istog	1	1	0	0	1	1	0
Totali		22	16	6	17	5	20	2

Figura 9: Kërkesat e aprovuara për adoptim vendor dhe ndërkombëtar, 2021


Në vitin 2021 janë aprovuar katër (4) kërkesa për adoptim më shumë, apo plus 22% në krahasim me vitin paraprak.

Përveç shqyrtimit të kërkesave për adoptim, Paneli ka bërë shqyrtimin edhe të kërkesave për vendosjen e fëmijëve pa përkujdesje prindërore e të braktisur në strehim familjar, si dhe ka bërë vlerësimin dhe rivlerësimin për familje strehuese bazuar në legjislacionin në fuqi.

Gjatë vitit 2021, Paneli ka shqyrtuar dhe aprovuar njëzetë e një (21) kërkesa për vendosje në strehim familjar, të gjithë fëmijë pa përkujdesje të përkohshme prindërore.

Paneli, gjithashtu ka bërë vlerësimin e katërbëdhjetë (14) familjeve strehuese, nga të cilat dy (2) janë vlerësuar për herë të parë (1 është aprovuar dhe 1 është refuzuar), ndërsa dymbëdhjetë (12) familje janë rivlerësuar. Për më tepër shih Figurën 10:

Figura 10: Kërkesat e vlerësuara për strehim familjar dhe familje strehuese, 2021



Gjatë vitit 2021 numri i kërkesave të shqyrtuara dhe të aprovuara për strehim familjar ka rënë për nëntë (9) kërkesa më pak, apo minus 30%. Gjithashtu edhe numri i kërkesave për vlerësim/rivlerësim të familjeve strehuese ka rënë për katër (4) familje më pak, apo minus 22% në krahasim me vitin paraprak.

3.3.6. Fëmijët e prindërve të penguar në kryerjen e të drejtës prindërore dhe të keqtrajtuar

Te fëmijët e prindërve të penguar në kryerjen e të drejtës prindërore, hyjnë fëmijët, prindërit e të cilëve iu është marrë e drejta prindërore pasi që për arsye shëndetësore apo për arsye juridike, nuk janë në gjendje që t'i kryejnë detyrat e tyre prindërore. Ndërsa tek fëmijët e braktisur dhe të keqtrajtuar, hyjnë fëmijët që kanë prindër por që në fakt prindërit nuk kujdesen për ta, duke mos i respektuar obligimet ligjore që kanë si prindër. Në të shumtën e rasteve këta fëmijë janë të lënë pas dore, iu mungon kujdesi prindëror ose janë të keqtrajtuar në forma të ndryshme.

Gjatë vitit 2021 janë trajtuar me shërbime të nevojshme njëzetë e tre (23) fëmijë të prindërve të penguar në kryerjen e të drejtës prindërore dhe shtatëdhjetë (70) fëmijë të keqtrajtuar.¹⁰

¹⁰ Të dhënat janë marrë nga Baza e të Dhënave për Shërbime Sociale dhe Familjare/DPSF.


3.3.7. Fëmijët në nevojë për mbrojtje sociale të vendosur në strehim rezidencial

Me qëllim të ofrimit të formave alternative të mbrojtjes për fëmijët pa përkujdesje prindërore/familjare dhe për fëmijët e keqtrajtuar, DPSF-ja ka Marrëveshje Bashkëpunimi me OJQ-të, si: SOS Fshatrat e Fëmijëve-Kosovë, “Shpresa dhe Shtëpitë e Fëmijëve-Kosovë” dhe “CARITAS UMBRIA-Kosovë”, të cilat përveç trajtimit të këtyre fëmijëve bëjnë edhe strehimin e tyre.

SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë, ofrojnë përkujdesje afatgjate dhe shtëpi familjare për fëmijët pa përkujdesje prindërore dhe ndihmojnë secilin fëmijë të zhvillohet deri në potencialin e tij/saj maksimal duke i përgatitur ata për jetë të pavarur. Në Familjet SOS, fëmijëve iu jepet mundësia të ndërtojnë lidhje afatgjate familjare, të jetojnë sipas kulturës dhe fesë së tyre dhe të shprehin aftësitë, interesat dhe talentet individuale.

Gjatë vitit 2021, në Programet e SOS Fshatrave të Fëmijëve në Kosovë, ishin të strehuar pesëdhjetë e pesë (55) fëmijë, 42 fëmijë (25 vajza dhe 17 djem) në SOS Familje, dhe 13 të rinj (8 vajza dhe 5 djem) në SILP-Programin e Gjysmë-Pavarësisë. Shih figurën më poshtë:

Figura 11: Fëmijët dhe të rinjtë e vendosur në SOS Fshatrat në Kosovë, gjatë vitit 2021



Të rinjtë mbi 18 vjeç, përfitues të SILP-it, vitin e parë mbështeten me 75%, vitin e dytë me 50% dhe vitin e tretë me 25%. Shërbimet psiko-sociale iu ofrohen gratis ndërsa shpenzimet mjekësore mbulohen konform përqindjes (%) së mbështetjes. Nga 13 të rinjë, përfitues të SIPL, katër (4) prej tyre studiojnë dhe shpenzimet ua mbulon SOS, ndërsa nga 13 të rinjë, aktualisht janë duke punuar shtatë (7) prej tyre.

Të rinjtë e bartur në Programin e Gjysmë Pavarësimit vazhdojnë të jenë pjesë e Programit të SOS Fshatit në Projektet: “Jeta Gjysmë e Pavarur” dhe “Shtëpia e Rinisë”.

Gjatë vitit 2021 numri fëmijëve të strehuar në SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë, është i njëjtë me atë të vitit paraprak.

“Shpresa dhe Shtëpitë e Fëmijëve-Kosovë” (SDSF), është OJQ lokale e cila operon në Kosovë që nga viti 2008, kurse nga viti 2001 ka operuar si organizatë ndërkombëtare e quajtur “Hope and Homes for Children”, duke ofruar shërbime gjithëpërfshirëse sociale për fëmijët në nevojë për mbrojtje sociale dhe rezidenciale të përkohshme, për djem dhe vajza të moshave 3-18 vjeç nga gjithë territori i Republikës së Kosovës.

Aktualisht OJQ-ja “Shpresa dhe Shtëpitë e Fëmijëve-Kosovë” (SDSF), strehimorja në Prishtinë, bën strehimin e përkohshëm të fëmijëve të rrezikuar deri sa të krijohen kushtet e favorshme për bashkim familjar ose kthim në komunitet për kategoritë:


- ✓ Fëmijë pa përkujdesje prindërore,
- ✓ Fëmijë i abuzuar dhe i keqtrajtuar,
- ✓ Fëmijë viktimë e dhunës në familje,
- ✓ Fëmijë i neglizhuar,
- ✓ Fëmijë viktimë e trafikimit (me nivel të ulët të rrezikut).

Gjatë vitit 2021 në Strehimoren “Shpresa dhe Shtëpitë e Fëmijëve-Kosovë” (SDSF), janë vendosur dhe trajtuar me shërbime të nevojshme 35 fëmijë (19 djem dhe 16 vajza). Nga 35 fëmijët, 13 fëmijë (8 djem dhe 5 vajza) apo 37%, janë raste të bartur nga viti 2020, ndërsa 22 fëmijë (11 djem dhe 11 vajza) apo 67%, janë raste të reja të referuara gjatë vitit 2021. Të gjitha rastet janë referuar dhe akomoduar nga zyrtarët e QPS-ve përkatëse. Shih Tabelën më poshtë:

Tabela 5: Fëmijët e vendosur në OJQ “Shpresa dhe Shtëpitë e Fëmijëve-Kosovë”, vitit 2021

Kategoria:				Shqiptar/ Kosovë		Maqedon		Rom		Shqiptar/ Shqipëri		Totali	
Fëmijë pa kujdes prindërore	Viktimë e dhunës në familje	Viktimë e krimeve seksuale	Bashkjetesë nën moshën 16 vjeç	Djem	Vajza	Djem	Vajza	Djem	Vajza	Djem	Vajza	Djem	Vajza
24	8	2	1	17	14	2	0	0	1	0	1	19	16
35												35	35


Nga 35 fëmijët e keqtrajtuar/abuzuar të strehuar në strehimore, 22 janë raste të reja ndërsa 13 janë raste të bartura nga viti paraprak. Shih figurën më poshtë>

Figura 12: Fëmijët e vendosur në OJQ “Shpresa dhe Shtëpitë e Fëmijëve-Kosovë”, 2021/2020

Në Strehimore gjatë vitit 2021, janë strehuar 11 fëmijëve apo 46% më shumë në krahasim me vitin 2021.

“CARITAS-UMBRIA KOSOVË”, aktivitetin e saj e ka filluar në fund të muajit qershor të vitit 1999, si kamp rajonal në fshatin Radulloc (komuna e Klinës). Në fillim, në këtë kamp, iu është ofruar ndihmë dhe strehim fëmijëve jetimë, të mbetur si pasojë e luftës, familjeve të varfra për rindërtimin e shtëpive të dëmtuara nga lufta, si dhe janë ndihmuar fëmijët dhe të rriturit e sëmurë rëndë që të dërgohen për shërim në Itali (veçanërisht në fushën e onkologjisë dhe kardiologjisë), pasi që nuk mund të trajtoheshin nga institucionet shëndetësore kosovare. Aktualisht, “CARITAS-UMBRIA” strehon dhe trajton me shërbime të nevojshme fëmijët pa përkujdesje prindërore.

Në këtë strehimore, gjatë vitit 2021 ishin të strehuar 15 fëmijë pa përkujdesje prindërore, të keqtrajtuar dhe të braktisur, nga të cilët 13 janë fëmijë të bartur nga viti 2020 dhe 4 fëmijë janë raste të reja të vendosur gjatë vitit 2021. Shih figurën më poshtë:

Figura 13: Fëmijët e vendosur në strehimoren “Caritas Umbria Kosovë”-Klinë, 2021/2020

Në Strehimore, gjatë vitit 2021, janë strehuar 5 fëmijë apo 5% më pak, në krahasim me vitin paraprak.

3.4. Fëmijët në konflikt me ligjin

Për mbrojtjen e kësaj kategorie të fëmijëve janë realizuar format e duhura të mbrojtjes në harmoni me legjislacionin në fuqi. Sipas raporteve të QPS-ve vazhdon puna profesionale në partneritet me subjektet e tjera relevante, si: Gjykata, Policia e Kosovës, Shërbimi Sprovues, shkolla dhe OJQ-të.

Nga të dhënat e raportuara nga QPS-të dhe Baza e të Dhënave të Shërbimeve Sociale dhe Familjare, gjatë vitit 2021 janë evidentuar dhe iu janë ofruar shërbimet e nevojshme 427 fëmijëve në konflikt me ligjin. Prej tyre 416 apo 97% të etnitetit shqiptar, 7 apo 2% ashkali dhe 0.47% të etnitetit rom dhe serb. Shih tabelën më poshtë:

Tabela 6: Fëmijët në konflikt me ligjin, 2021

Etniteti	Nr. i fëmijëve
Shqiptar	416
Ashkali	7
Rom	2
Serb	2
Totali	427

Në vitin 2021, numri i fëmijëve në konflikt me ligjin është rritur për 176 fëmijëve apo 70% më shumë në krahasim me vitin paraprak.

3.5. Riatdhesimi i fëmijëve të pashoqëruar

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve sipas mandatit që ka, bazuar në Strategjinë dhe Planin e Veprimit për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar për kategorinë e fëmijëve të pashoqëruar, përmes Qendrave për Punë Sociale, realizon ofrimin e shërbimeve sociale për fëmijët e pashoqëruar, duke iu ofruar mbrojtje direkte dhe riintegrimin afatgjatë të tyre.

MFPT-ja pas koordinimit të punës dhe realizimit të kushteve për kthim të fëmijës/fëmijëve të pashoqëruar, koordinon punën në organizimin e pritjes së fëmijëve në Aeroportin e Prishtinës apo në pikat e tjera kufitare, ku zyrtarë të QPS-së kompetente dhe zyrtarë të MPB-së, e bëjnë pritjen e fëmijës në fjalë. Pas realizimit të riadhesimit të fëmijëve të pashoqëruar, Qendra për Punë Sociale që vepron në territorin ku është riadhesuar fëmija, është e obliguar që në fillim të bëjë një vlerësim profesional të fëmijës dhe pastaj të vazhdohet me ofrimin e shërbimeve të nevojshme sociale dhe familjare.

Gjatë vitit 2021, është bërë riadhesimi i vetëm katër (4) fëmijëve të pashoqëruar. Vendet që kanë iniciuar kërkesat për riadhesim kanë bërë anulimin e tyre për shkak të gjendjes së krijuar nga COVID-19.

Gjatë vitit 2021 kemi tre (3) fëmijë të riadhesuar më shumë, apo 300% në krahasim me vitin paraprak.

3.6. Fëmijët në punë të rënda

Bazuar në situatën aktuale të fëmijëve të përfshirë në punë të rënda dhe duke u bazuar në rekomandimet e dala nga disa aktorë, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, konkretisht Departamenti për Politika Sociale dhe Familjare në bashkëpunim me aktorët e tjerë që merren me fëmijët në punë të rënda, ka ndërmarrë disa veprime konkrete për vitin 2021.

Gjatë këtij viti është përgatitur Plani i Veprimit për Komitetin Kosovar për Parandalimin dhe Eliminimin e Punëve të Rënda të Fëmijëve; janë lidhë Marrëveshje Bashkëpunimi me OJQ-të partnere, si: “Terre des Hommes”, “World Vision”, si dhe jemi në bashkëpunim me ILO-n, të cilat do të mbështesin MFPT-në në realizimin e objektivave të Plani të Veprimit.

Komiteti i Kosovës për Parandalimin dhe Eliminimin e Punëve të Rënda të Fëmijëve (KKPEPRF), i cili me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës është formuar në fillim të vitit 2016, e që drejtohet nga Ministri i MFPT-së. Gjatë pjesës së parë të vitit 2021 Komiteti ka mbajtur 3 takime, me qëllim të hartimit të Planit të Veprimit (PV) për KKPEPRF-në. Ndërsa takimin e rregullt e ka mbajtur më 12 qershor 2021, ku është miratuar ky Plan i Veprimit dhe është prezantuar situata aktuale e fëmijëve të përfshirë në punë të rënda dhe masat që duhen ndërmarrë në realizimin e objektivave të PV-së.

Aktivitetet e realizuara gjatë vitit 2021 janë:

- Në kuadër të aktivitetit për përditësimin e Sistemit të Monitorimit për Punën e Fëmijëve, janë hartuar:
 - Procedurat Standarde të Veprimit për Fëmijët në Forma të Rrezikshme të Punës;

- Udhëzuesi për zbatimin e Procedurave Standarde të Veprimit për Fëmijët në Forma të Rrezikshme të Punës;
 - Procedurat Standarde të Veprimit për Fëmijët në Forma të Rrezikshme të Punës;
 - Udhëzuesi për zbatimin e Procedurave standarde të Veprimit për Fëmijët në Forma të Rrezikshme të Punës;
 - Korniza raportuese për monitorimin e zbatimit të PSV-ve;
 - Moduli Elektronik për menaxhimin dhe regjistrimin e rasteve për Fëmijët në Forma të Rrezikshme të Punës.
- Në kuadër të aktivitetit për zhvillimin e kapacitetit institucional të institucioneve relevante për adresimin e punës së fëmijëve, janë hartuar:
- Moduli i Trajnimeve për Trajnerë për Fëmijët në Punë,
 - Programi i Trajnimit për Menaxhimin e Rasteve për Fëmijët në Punë.
- Është projektuar dhe lansuar Moduli Elektronik për Menaxhimin dhe Regjistrimin e Rasteve për Fëmijët në Forma të Rrezikshme të Punës, në kuadër të platformës elektronike për shërbimet sociale, në të cilin janë digjitalizuar format e punës për menaxhim të rastit për fëmijët në punë të rënda dhe të rrezikshme;
- Janë hartuar dhe validuar Procedurat Standarde të Veprimit për Fëmijët në Forma të Rrezikshme të Punës;
- Është hartuar dhe validuar Udhëzuesi për Zbatimin e Procedurave Standarde të Veprimit për Fëmijët në Format e Rrezikshme të Punës;

Bazuar në të dhënat e Bazës së Shërbimeve Sociale të DPSF-së dhe të Policisë së Kosovës, gjatë vitit 2021 janë identifikuar 306 fëmijë në punë të rënda, të cilët janë trajtuar nga QPS-të me: shërbime shëndetësore, këshilla psiko-sociale, ndihmë sociale/kyçje familjes në Skemën e Ndhmës Sociale, akomodim dhe shërbime këshillimi dhe vetëdijesimi.

3.7. Dhuna në familje

Pjesë e rëndësishme e punës së shërbimeve sociale dhe familjare, është puna për parandalimin dhe mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje.

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, është përgjegjëse për draftimin e legjislacionit në kuadër të mbrojtjes sociale dhe familjare për këtë kategori, zhvillimin e politikave, hartimin e standardeve minimale për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare për viktimat e dhunës në familje, monitorimin dhe inspektimin e kualitetit të shërbimeve, sigurimin e zbatimit të politikave, legjislacionit dhe minimumin e standardeve për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare. MFPT-ja në bashkëpunim me Agjencinë për Barazi Gjinore (ABGJ) dhe institucionet e tjera relevante, sipas Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, është e obliguar

që të bëjë monitorimin dhe implementimin e Programit të Kosovës kundër Dhunës në Familje, si dhe monitorimin e implementimit të Procedurave Standarde të Veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje.

3.7.1. Mbështetja financiare për OJQ-të që trajtojnë/strehojnë viktimat e dhunës në familje

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve gjegjësisht Departamenti i Politikave Sociale dhe Familjes edhe gjatë këtij viti ka vazhduar me mbështetjen e organizatave joqeveritare që në kuadër të tyre ofrojnë shërbime për viktimat e dhunës në familje dhe dhunës mbi baza gjinore, në proces të mbrojtjes sociale dhe riintegritit të tyre. Shuma monetare e mbështetjes për dymbëdhjetë (12) OJQ-të që trajtojnë rastet e dhunës në familje, trafikimit me qenie njerëzore, fëmijët e abuzuar, të keqtrajtuar, të lënë pas dore dhe pa përkujdesje familjare është 545 mijë euro. Krahasuar me vitin paraprak ku kjo shumë ishte 495 mijë euro, del që në vitin 2021, shuma që ka ndarë MFPT-ja për të mbështetur këto OJQ është rritur për 50 mijë euro më shumë apo plus 10%.

Me qëllim të rritjes së kualitetit të shërbimeve për mbrojtje të viktimave të dhunës në familje, përveç shërbimeve sociale që ofrohen nga Qendrat për Punë Sociale që kanë shtrirje në tërë territorin e Republikës së Kosovës, MPMS/DPSF-ja ka krijuar dhe vazhdon ta forcojë partneritetin me OJQ-të të cilat kanë në programet e tyre: *strehimin, trajtimin, përkrahjen dhe fuqizimin e viktimave të dhunës në familje.*

MFPT/DPSF-ja ka realizuar marrëveshje dhe kontrata për blerjen e shërbimeve për mbrojtjen dhe strehimin e viktimave të dhunës në familje me 8 (tetë) strehimore në nivel nacional, të cilat janë:

1. OJQ “Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve” - Strehimorja në Prishtinë;
2. OJQ “Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve Raba Voca” - Strehimorja në Mitrovicë;
3. OJQ “Qendra për Strehimin e Grave dhe Fëmijëve” – Strehimorja në Prizren;
4. OJQ “Qendra për Mirëqenien e Gruas”- Strehimorja në Pejë;
5. OJQ “Shtëpia e Sigurtë” - Strehimorja në Gjakovë;
6. OJQ “Qendra për Mbrojtjen dhe Rehabilitimin e Grave dhe Fëmijëve” - Strehimorja në Gjiilan;
7. OJQ “Shtëpia ime” - Strehimorja në Ferizaj;
8. OJQ “Zenski Inkluzivni Center” në Novobërdë.

Të gjitha këto strehimore gjatë vitit 2021 kanë strehuar dhe kanë trajtuar me shërbime të nevojshme viktimat e dhunës në familje të të gjitha moshave dhe etniteteve. Partneriteti i krijuar me OJQ-të në ofrimin e shërbimeve, është shumë i rëndësishëm për procesin e mbrojtjes dhe ndihmës në procesin e përbashkët për riintegrimin e viktimave të dhunës në familje.

3.7.2. Viktimat e dhunës në familje të evidentuara dhe trajtuara nga QPS-të

Në bazë të monitorimit të bërë në dosjet e rasteve të dërguara nga ana e Qendrave për Punë Sociale, dhe monitorimin e Bazës së të Dhënave për shërbime sociale dhe familjare, si dhe raporteve statistikore të dërguara nga QPS-të dhe nga Policia e Kosovës, lidhur me rastet e identifikuara dhe të trajtuara, rezulton

se gjatë periudhës kohore janar-dhjetor 2021 janë identifikuar 2.486 raste të viktimave të dhunës në familje. Prej tyre 1.986 apo 80% gra/vajza dhe 500 apo 20% burra/djem. Shih figurat më poshtë:

Figura 14: Viktimat e dhunës në total, 2021





Figura 15: Viktimat e dhunës sipas gjinisë, 2021



3.7.3. Viktimat e dhunës në familje të strehuara në strehimore


Nga 2.486 rastet/viktimat e dhunës në familje të trajtuara nga QPS-të, 481 apo 68% e tyre janë strehuar në strehimore dhe janë trajtuar me shërbimet e nevojshme konform legjislacionit në fuqi. Për të dhëna më të detajuara shih tabelën më poshtë:

Tabela 7: Viktimat e dhunës në familje sipas strehimore ku janë strehuar, 2021

OJQ	Totali	Moshë						Statusi i prejardhjes		Viktimat vendore sipas etnitetit		
		Nën 18 vjeç			Mbi 18 vjeç			Vendor/e	I/e huaj	Shqiptar/e	Serb/e	RAE
		Vajza	Djem	Totali	Gra	Burra	Totali					
"QMGF"-Prishtinë	132	24	39	63	69	0	69	120	12	107	0	13
"LIRIA"-Gjilan	71	14	11	25	46	0	46	68	3	68	0	0
"SHTËPIA IME"-Ferizaj	58	26	12	38	20	0	20	58	0	3	0	5
"QSGF-P"Prizren	53	16	12	28	25	0	25	45	8	45	1	0
"SHTËPIA E SIGURT"-Gjakovë	114	30	28	58	56	0	56	110	4	76	0	34
"QMG"-Pejë	76	12	15	27	49	0	49	76	0	60	0	16
"ZEC"-Novobërd	30	7	12	19	11	0	11	30	0	0	18	2
"QMGF"-Mitrovicë	61	20	14	34	27	0	27	61	0	61	0	0
Totali	595	149	143	292	303	0	303	568	27	470	19	70

Në vitin 2021, numri i viktimave të dhunës në familje të strehuara në strehimore, është rritur për 138 viktimë më shumë apo plus 30%, në krahasim me vitin paraprak. Shih figurën më poshtë:


Figura 16: Viktimat e dhunës në familje sipas moshës, gjinisë dhe vendit të prejardhjes 2021/2020



3.7.4. Viktimat e dhunës në familje sipas moshës, gjinisë dhe vendit të prejardhjes

Nga totali prej 595 viktimave të dhunës në familje të strehuara në strehimore gjatë vitit 2021, 292 viktimë apo 49% janë të moshës nën 18 vjeç (fëmijë) dhe 303 viktimë apo 51% janë mbi moshën 18 vjeç (të rritur/a). Shih tabelën 7 dhe figurat 17 dhe 18:


Figura 17: Viktimat e dhunës në familje sipas moshës, 2021



Në vitin 2021, numri i viktimave të dhunës në familje nën moshën 18 vjeç, ka shënuar rritje për 70 viktimë më shumë apo plus 32%, gjithashtu edhe numri i viktimave të dhunës në familje mbi moshën 18 vjeç është rritur për 68 viktimë më shumë apo plus 29% në krahasim me vitin paraprak. Shih figurën 17.

Ndërsa sa i përket gjinisë, 149 viktimë apo 25% janë vajza, 143 viktimë apo 24% janë djem dhe 303 viktimë apo 51% janë gra. *Shih figurën më poshtë:*


Figura 18: Viktimat e dhunës në familje sipas gjinisë, 2021



Në vitin 2021, numri i viktimave vajza/gra të strehuara në strehimore, është rritur për 83 viktimë më shumë apo plus 22%, gjithashtu edhe numri i viktimave djem/meshkuj është rritur për 28 viktimë më shumë apo plus 31% në krahasim me vitin paraprak.

Sa i përket vendit të prejardhjes, 568 viktimë apo 95% janë vendore, ndërsa 27 viktimë apo 5% janë të huaj/a. Shih figurën më poshtë:

Figura 19: Viktimat e dhunës në familje sipas vendit të prejardhjes, 2021



Në vitin 2021, numri i viktimave vendore, ka shënuar rritje për 131 viktimë apo 30% në krahasim me vitin paraprak, ndërsa numri i viktimave të huaja ka rënë për 17 viktimë më pak apo minus 39%.

3.8. Trafikimi me qenie njerëzore

Sa i përket viktimave të trafikimit me qenie njerëzore¹¹, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve së bashku me partnerët qeveritarë dhe joqeveritarë, punon në sistem të referimit¹² në kuadër të mbrojtjes sociale, në mbrojtjen direkte të tyre, duke përfshirë: *përmbyshjen e nevojave imediate të viktimave, strehimin, rehabilitimin, punën me familjen, bashkimin familjar, riatdhësimin dhe riintegrimin afatgjatë të tyre.*

Ish Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, tash Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve është anëtare e Autoritetit Kombëtar Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore, autoritet i cili kryesohet nga Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), gjegjësisht, nga Zyra e Koordinatorit Nacional Kundër-Trafikim. Gjithashtu, Ministria është hartuese dhe implementuese e shumë aktiviteteve në kuadër të Planit Nacional për luftimin e trafikimit me qenie njerëzorë në Kosovë, sa i përket fushës së mbrojtjes sociale.

Kur kemi të bëjmë me viktimat e trafikimit fëmijë, Qendra për Punë Sociale në nivel lokal është ndër partnerët e parë që ofron format e mbrojtjes për viktimat e trafikimit në partneritet me Policinë, konkretisht me Drejtoratin për Hetim të Trafikimit me Qenie Njerëzore, Mbrojtësit e Viktimave dhe OJQ-Strehimoret, të cilat ofrojnë strehim për këtë kategori si dhe me aktorë të tjerë të kësaj fushe.

Qendra për Punë Sociale në trajtimin e rasteve të viktimave të trafikimit fëmijë, është e obliguar të trajtojë rastin duke iu përmbyshur menaxhimit të rastit konform legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës. Ndërsa kur kemi të bëjmë me viktimat e trafikimit të rritur/a, Qendra për Punë Sociale, në kuadër të mbrojtjes dhe riintegrimin, ofron shërbime sociale dhe familjare, si: shërbime psiko-sociale, ndërmjetësim për kthim në familje, shërbime ndërlidhëse me agjencitë e tjera për mundësi riaftësimi profesional, mundësi punësimi, etj.

3.8.1. Strehimi dhe trajtimi i viktimave të trafikimit me qenie njerëzore

Në bazë të monitorimit të bërë në dosjet e rasteve të dërguara nga ana e Qendrave për Punë Sociale, viktimat e trafikimit të mitur/a dhe të rritur/a, vendor/e dhe të huaj/a, në bazë të barazimit të rasteve me Drejtoratin për Hetim të Trafikimit me Qenie Njerëzore në Policinë e Kosovës, Bazës së të Dhënave për shërbime sociale dhe familjare dhe në bazë të raporteve të OJQ-Strehimorja “Qendra për Mbrojtjen e Viktimave dhe Parandalim të Trafikimit me Qenie Njerëzore” në Prishtinë, rezultoi se gjatë vitit 2021 janë trajtuar dhe iu janë ofruar shërbime sociale tridhjetë e shtatë (37) viktimave, të cilave gjatë akomodimit/strehimit, iu janë ofruar me kohë shërbimet mjekësore, psiko-sociale, të ushqimit, veshmbathjes dhe ato farmaceutike. Vlen të theksohet se një numër i viktimave të trajtuara në strehimore ishin përdorues të substancave narkotike, të cilat gjatë qëndrimit të tyre janë trajtuar edhe me terapinë e metadonit.

¹¹ Ligji Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare dhe Ligji Nr. 04/L-81 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare.

¹² Strategjia Nationale Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore në Kosovë 2009-2014.

Nga tridhjetë e shtatë (37) viktimat, pesëmbëdhjetë (15) apo 41% ishin viktimat të trafikimit dhe janë strehuar/akomoduar në Strehimoren e Viktimave të Trafikimit në Lipjan, ndërsa njëzetë e dy (22) apo 59% ishin viktimat të supozuara të trafikimit, të cilat janë strehuar/akomoduar në OJQ "QMVPT" në Prishtinë.

Sa i përket moshës, njëzetë e katër (24) viktimat apo 65% ishin nën 18 vjeç dhe trembëdhjetë (13) viktimat apo 35% ishin mbi 18 vjeç.

Sa i përket gjinisë, tridhjetë e pesë (35) viktimat apo 95% ishin vajza/gra dhe dy (2) viktimat apo 5% ishin djem/burra.

Ndërsa sa i përket vendit të prejardhjes tridhjetë e gjashtë (36) viktimat apo 97% ishin vendore dhe një (1) viktimë apo 3% ishin të huaja. Shih tabelën dhe figurën më poshtë:

Tabela 8: Viktimat e trafikimit me qenie njerëzore të strehuara në strehimore, 2021

Strehimorja	Viktimë e trafikimit	Viktimë e supozuar e trafikimit	Moshë		Gjinia		Statusi i prejardhjes		Totali
			Nën 18 vjeç	Mbi 18 vjeç	Vajza/gra	Djem/burra	Vendor/e	I/e huaj	
Strehimorja e Viktimave të Trafikimit-Lipjan	15	0	11	4	14	1	14	1	15
QMVPT-Prishtinë	0	22	13	9	21	1	22	0	22
Totali	15	22	24	13	35	2	36	1	37

Figura 20: Viktimat e trafikimit me qenie njerëzore të strehuara në Strehimoren në Lipjan, 2021





Figura 21: Viktimat e supozuara të trafikimit, të strehuara në QMVPT-Prishtinë, 2021

3.8.2. Mbështetja financiare e OJQ-ve që trajtojnë viktimat e trafikimit

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, gjegjësisht Departamenti për Politika Sociale dhe Familjare edhe gjatë vitit 2021, ka vazhduar me mbështetjen e projekteve të organizatave joqeveritare, që në kuadër të tyre ofrojnë shërbime për viktimat e trafikimit me qenie njerëzore në proces të mbrojtjes dhe riintegritimit të tyre.

Sa i përket kësaj mbështetjeje financiare, gjatë vitit 2021 Organizata Joqeveritare vendore “Qendra për Mbrojtjen e Viktimave dhe Parandalim të Trafikimit me Qenie Njerëzore”, është mbështetur nga Ministra në realizimin e projekteve të saj në shumën prej 46,000.00 euro.

Po ashtu, edhe OJQ-ja “Shpresa dhe Shtëpitë e Fëmijëve” në Prishtinë, e cila strehon fëmijë të keqtrajtuar, të abuzuar dhe fëmijë viktime të trafikimit me nivel të ulët të rrezikshmërisë, gjatë vitit 2021 është mbështetur financiarisht nga Ministria në shumën prej 48,000.00 euro. Me këto mjete janë paguar shërbimet që janë ofruar për fëmijë të keqtrajtuar, të abuzuar dhe fëmijë viktime të trafikimit me nivel të ulët të rrezikshmërisë brenda kësaj organizate.

3.9. Mbrojtja e viktimave të krimeve seksuale-fëmijë

Në kuadër të monitorimit të bërë gjatë vitit 2020, Qendrat për Punë Sociale në gjithë Kosovën kanë trajtuar, menaxhuar dhe iu kanë ofruar shërbime sociale dhe familjare 19 viktimave të krimeve seksuale. Të gjitha viktimat kanë qenë nën moshën 18 vjeç, prej tyre 17 të etnitetit shqiptar dhe 2 të etnitetit serb dhe të gjitha viktimat ishin të vajza.

Mbrojtja për këtë kategori ka konsistuar në ofrimin e këtyre shërbimeve: *koordinim për ofrim të shërbimeve shëndetësore, strehim në strehimore për tejkalim të traumës, ofrim i shërbimeve psiko-sociale, punë me familjen, punë me komunitetin, etj.*

Në vitin 2021 kemi një rënie të numrit të viktimave seksuale (fëmijë) për 14 viktima më pak apo minus 74%, në krahasim me vitin paraprak.


3.10. Të miturit që hyjnë në martesë të parakohshme

Bazuar në legjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës, personi që akoma nuk i ka mbushur 18 vjeç nuk mund të lidhë martesë, me përjashtim të rasteve kur i mituri me kërkesë i drejtohet Gjykatës kompetente, e cila mund t'i lejojë martesën personit të mitur, më të vjetër se 16 vjet, nëse konstaton se ai/ajo ka arritur pjekurinë e nevojshme fizike dhe psikike, për të ushtruar të drejtat e veta martesore dhe për të përmbushur detyrimet martesore. Gjykata vendos me vendim, mirëpo paraprakisht kërkon mendimin edhe të:

- *Organit të Kujdestarisë, i cili funksionon në kuadër të Qendrave për Punë Sociale,*
- *prindërve/kujdestarit të tij/saj,*
- *personit me të cilin lidhet martesa, si dhe*
- *institucionit përkatës shëndetësor.*

Bazuar në të dhënat e regjistruara nga ana e Qendrave për Punë Sociale, në Bazën e të Dhënave të Shërbimeve Sociale, konstatohet se gjatë vitit 2021 nga Organi i Kujdestarisë janë trajtuar 11 raste për martesë para moshës madhore. Shih figurën më poshtë:

Figura 22: Rastet e martesave para moshës madhore, 2021



Në vitin 2021 numri i kërkesave për martesë para moshës madhore është rritur për 7 raste apo 57% më shumë në krahasim me vitin paraprak.

3.11. Ngecje e marrëdhënieve familjare

Qendra për Punë Sociale, si Organ i Kujdestarisë është e obliguar që të kryejë detyrën e mbrojtjes së fëmijëve në gjendje të nevojave sociale. Për fëmijët prindërit e të cilëve kanë probleme bashkëshortore, familjare, janë në procesin e shkurorëzimit ose janë të shkurorëzuar, Organi i Kujdestarisë merr rolin e mbrojtjes së këtyre fëmijëve. Gjatë periudhës janar-dhjetor 2021 nga QPS-të janë trajtuar 5 raste të kësaj kategorie.

Në vitin 2021, numri i rasteve të kësaj kategorie ka rënë për 5 raste më pak, apo minus 100% në krahasim me vitin paraprak.

3.12. Këshilla martesore

Bazuar në të dhënat e evidentuara në Bazën e të Dhënave të Shërbimeve Sociale dhe Familjare, gjatë vitit 2021, me këshilla martesore janë trajtuar 244 raste.

Në vitin 2021, numri i rasteve që janë trajtuar me këshilla martesore është rritur për 62 raste më shumë, apo plus 34% në krahasim me vitin paraprak.

3.13. Të moshuarit në nevojë për shërbime sociale

Qendra për Punë Sociale ofron shërbime sociale për të moshuarit në nevojë sociale që gjenden në territorin e Republikës së Kosovës. Gjatë vitit 2021, nga QPS-të janë trajtuar me shërbime të nevojshme 54 raste.

Në vitin 2021, numri i personave të moshuar që janë trajtuar nga QPS-të është rritur për 50 raste më shumë në krahasim me vitin paraprak.

3.14. Komisioni për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në Shkallën II

Komisioni ka vazhduar punën bazuar në legjislacionin në fuqi nga fusha e shërbimeve sociale dhe familjare. Gjatë vitit 2021, Komisioni ka shqyrtuar 94 lëndë/ankesa, ku numri i ankesave të shqyrtuara është rritur për 54 ankesa apo 135% më shumë, në krahasim me vitin paraprak.

3.15. Komisioni Ministror për Shqyrtimin e Ligjshmërisë dhe Përshtatshmërisë së Akteve të Komunave të Kosovës

Bazuar në Vendimin Nr. 361, të datës 21.11.2016 dhe 361/1, të datës 28.12.2017, Komisioni ka shqyrtuar ligjshmërinë dhe përshtatshmërinë e akteve nga fusha e shërbimeve sociale dhe familjare, të nxjerra nga komunat e Kosovës. Komisioni ka pranuar dhe shqyrtuar 13 akte komunale sipas nenit 83 të Ligjit Nr. 03/L-05 për Vetëqeverisje Lokale.

4. DIVIZIONI PËR AFTËSINË E KUFIZUAR DHE PERSONAT E MOSHUAR

4.1. Detyrat dhe përgjegjësitë

Divizioni për Aftësinë e Kufizuar dhe Personat e Moshuar (DAKPM), funksionon në kuadër të DPSF-së. Detyrat dhe përgjegjësitë e këtij Divizioni, janë:

- ✓ *Propozimi, hartimi dhe sigurimi i zbatimit të dokumenteve të politikave/strategjive për çështjet e ndërlidhura me personat me aftësi të kufizuara dhe personat e moshuar;*
- ✓ *Propozimi, hartimi dhe sigurimi i zbatimit të legjislacionit për zhvillimin e shërbimeve për persona me aftësi të kufizuara dhe persona të moshuar;*
- ✓ *Ofrimi i mbështetjes në menaxhimin e shërbimeve për persona me aftësi të kufizuara dhe persona të moshuar;*
- ✓ *Analizimi dhe raportimi mbi nevojat vjetore buxhetore për shërbimet e personave me aftësi të kufizuara dhe të moshuar;*
- ✓ *Koordinimi i aktiviteteve me institucionet relevante;*
- ✓ *Bashkëpunimi me organizata joqeveritare për zhvillimin e aktiviteteve.*

Udhëheqësi i Divizionit për Aftësinë e Kufizuar dhe Personat e Moshuar, raporton tek Udhëheqësi i Departamentit për Politika Sociale dhe të Familjes.

4.2. Institucionet e strehimit rezidencial

Aktualisht në Kosovë janë tri (3) institucione të nivelit qendror (*Shtëpia për Personat e Moshuar pa Përkujdesje Familjare në Prishtinë-SHPMPFP, Instituti Special në Shtime-ISSH dhe Shtëpia e Fëmijëve në Shtime-SHFSH*) dhe 12 Shtëpi me Bazë në Komunitet (SHBK), të cilat trajtojnë 24 orë të moshuarit pa përkujdesje familjare, fëmijët dhe të rriturit me aftësi të kufizuara. Shtëpitë me Bazë në Komunitet që trajtojnë personat me aftësi të kufizuara - ngecje në zhvillim mendor, janë të shtrira në këto komuna: Shtime, Ferizaj, Lipjan, Deçan, Dardanë, Vushtrri, Prizren dhe në Graçanicë. Kurse shtëpitë që trajtojnë personat e moshuar pa përkujdesje familjare janë në: Gurakoc-Istog, Skenderaj, Graçanicë dhe Novobërdë.

Gjithashtu, në Kosovë janë duke funksionuar edhe tri (3) Shtëpi me Bazë në Komunitet, të cilat trajtojnë 24 orë të moshuarit pa përkujdesje familjare. Këto shtëpi janë private dhe klientët/marrësit e shërbimeve i financojnë vet shërbimet dhe trajtimin. Prej tyre dy (2) janë të licencuara nga MFPT-ja, ndërsa shtëpia e tretë është në proces të licencimit. Po ashtu, trajtimin e personave të moshuar pa përkujdesje familjare dhe rastet sociale e bën edhe Shtëpia e Hapur në Komunën e Suharekës, e cila funksionon si OJQ. Në këtë shtëpi të moshuarit i marrin të gjitha shërbimet 24 orë pa kompensim-falas. Edhe kjo Shtëpi është në proces të licencimit të shërbimeve që ofron për të moshuarit.

Edhe gjatë vitit 2021 SHPMPPF-ja, ISSH-ja dhe Shtëpia e Fëmijëve në Shtime, janë menaxhuar nga niveli qendror, ndërsa të gjitha Shtëpitë me Bazë në Komunitet, që nga viti 2016, menaxhohen nga niveli komunal në komunën në të cilën funksionojnë, ndërsa buxheti këtyre shtëpive vazhdon t'iu sigurohet nga niveli qendror, gjegjësisht Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

4.3. Aktivitetet e realizuara

Divizioni i Aftësisë së Kufizuar dhe Personave të Moshuar, edhe gjatë vitit 2021, bazuar në legjislacionin në fuqi, ka zbatuar politikat të cilat kanë të bëjnë me mbrojtjen rezidenciale të personave të moshuar pa përkujdesje familjare si dhe të fëmijëve dhe të rriturve me aftësi të kufizuara mendore-ngecje në zhvillimin mendor. Gjatë këtij viti kemi bashkëpunuar ngushtë edhe me OJQ-të e licencuara të cilat ofrojnë dhe trajtojnë këto tri komunitete (fëmijët dhe të rriturit me aftësi të kufizuar dhe të moshuarit), kryesisht me shërbime në shtëpi të klientëve apo në Qendrat Ditore.

Edhe viti 2021 kryesisht është karakterizuar me veprime konkrete për mbrojtje të rezidentëve dhe stafit nga pandemia COVID – 19, me të cilën Kosova ka filluar të përballet që nga marsi i vitit 2020. Mbrojtja shëndetësore e rezidentëve është arritur duke mbajtur takime direkte në ISSH dhe në SHPMPPF në Prishtinë, si dhe duke mbajtur kontakte të vazhdueshme edhe me menaxherët e Shtëpive me Bazë në Komunitet. Pra, fokusi kryesor i punës ka qenë i drejtuar në mbrojtje të shëndetit të rezidentëve në vazhdimësi. Vlen të ceket se për mbrojtjen e shëndetit të rezidentëve, jemi ndihmuar gjithashtu edhe nga IKSHPK-ja, pasi sa herë që është kërkuar, stafi profesional i këtij institucioni ka bërë testimin e të gjithë rezidentëve dhe të stafit, si në SHPMPPF-në në Prishtinë po ashtu edhe në ISSH.

Në mars të këtij viti, falë bashkëpunimit të mirë me IKSHPK-në, është bërë vaksinimi me dozën e parë i të gjithë rezidentëve në institucione si dhe i tërë stafit. Pas këtij imunizimi, në institucione gjendja shëndetësore e rezidentëve ka qenë e mirë dhe stabile. Është e rëndësishme të theksohet se asnjë rezident nuk ka ndërruar jetë nga Covid-19. Pas periudhës 3 mujore nga vaksinimi i parë, ka filluar imunizimi i dytë dhe tani jemi në proces të vaksinimit të tretë.

Krahas përballjes me pandeminë, nuk ka munguar angazhimi edhe në kryerjen e shumë punëve tjera të planifikuara sipas planit të punës.

Falë buxhetit të planifikuar mirë kemi arritur që ta përfundojmë suksesshëm vitin, pasi me kohë dhe në mënyrë të rregullt janë realizuar të gjitha kërkesat e nevojshme të institucioneve për të mbajtur në nivelin e duhur mirëqenien e rezidentëve që janë nën përkujdesje 24 orëshe.

Janë realizuar edhe renovimet e planifikuara në Shtëpinë e Fëmijëve në Shtime, ndërsa në Shtëpinë e Personave të Moshuar pa Përkujdesje Familjare në Prishtinë, kanë filluar renovimet por nuk janë përfunduar e pritet të vazhdohen vitin e ardhshëm.

Nëse janë duke u respektuar standardet minimale të cilësisë, janë realizuar disa monitorime, inspektime si nga zyrtarët e DAKPM-së, nga zyrtarët e Njësisë për Inspektim dhe Monitorim (NJIM) që vepron në kuadër të DPSF-së, si dhe nga shumë organizata të tjera.


Vlen të ceket vizita e Komisionit Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin Çnjerëzor ose Degradues apo Ndëshkimit të Personave që janë nën përkujdesje 24 orëshe në Institutin Special në Shtime, e bërë në vitin 2020, ku raportin për këtë vizitë shumë përmbajtjesore e kemi marrë në vitin 2021, raport ky shumë pozitiv me pak rekomandime sa i përket angazhimit të stafit sa më profesional në punë me rezidentë, si dhe krijimi i mundësive për zvogëlim të numrit të rezidentëve.

Si MFPT, nga sektorët kompetentë është punuar për plotësim të objektivave dhe aktiviteteve të caktuara në Planin Nacional të Veprimit për Aftësinë e Kufizuar në Kosovë. Për këtë edhe është raportuar në Zyrën për Qeverisje të Mirë. Nga Qeveria aktuale viti 2022 është shpallur edhe vit për aftësinë e kufizuar. Ne me kohë i kemi dorëzuar objektivat tona, të cilat do të kryhen gjatë vitit që vjen, të cilat do të ndikojnë në përmirësimin e jetës së këtij komuniteti.

Gjatë vitit 2021 është arritur që t'i funksionalizojmë edhe dy Shtëpi me Bazë në Komunitet, Shtëpia më Bazë në Komunitet për Personat me Aftësi të Kufizuara në Prizren dhe Shtëpia për Personat e Moshuar pa Përkujdesje Familjare në Novobërdë. Në SHBK-në në Prizren janë vendosur tre (3) rezidentë që ishin të vendosur në strehim familjar, e të cilët e kanë mbushur moshën madhore dhe tre (3) rezidentë që ishin të vendosur në OJQ-në "HADËR" në Prizren. Ndërsa në SHBK-në në Novobërdë janë vendosur rezidentë të komunitetit serb, të cilët ishin të vendosur në SHPMPF-në në Prishtinë.


4.4. Numri i kërkesave të shqyrtuara për strehimin institucional/rezidencial

Edhe gjatë vitit 2021, pavarësisht situatës së krijuar nga pandemia, Divizioni i DAKPM-së në bashkëpunim edhe me aktorët e tjerë, është munduar që të kryejë edhe punë të tjera në interes të rezidentëve. Kështu, gjatë këtij viti janë pranuar njëzetë e shtatë (27) kërkesa të reja për strehim institucional-rezidencial të parashtruar nga Qendrat për Punë Sociale nga i gjithë territori i Republikës së Kosovës. Nga ky total, katërbëdhjetë (14) kërkesa apo 59% ishin për vendosje në SHPMPF, ndërsa njëmbëdhjetë (11) kërkesa apo 41% ishin për vendosje në ISSH. Shih figurën më poshtë:

Figura 23: Numri i kërkesave të reja për vendosje në SHPMPF dhe ISSH, 2021/2020

Në vitin 2021, numri i kërkesave për vendosje në SHPMPF dhe në ISSH është rritur për 12 kërkesa apo 80% më shumë, në krahasim me vitin paraprak.

Nga 16 kërkesat e parashtruara për vendosje në SHPMPF, 14 kërkesa apo 87.5% janë aprovuar, ndërsa 2 kërkesa apo 12.5% janë refuzuar. Ndërsa nga 11 kërkesat e parashtruara për vendosje në ISSH, 5 kërkesa apo 45% janë aprovuar dhe 6 kërkesa apo 55% janë refuzuar. Shih figurën më poshtë:

Figura 24: Numri i kërkesave për strehim institucional/rezidencial, 2021

Në pamundësi të kthimit në familje, iu është vazhduar qëndrimi në institucione 80 rezidentëve (59 rezidentë në ISSH dhe 21 rezidentë në SHPMPF-Prishtinë), numër ky më i madh për 30 rezidentë më shumë apo 60% në krahasim me vitin paraprak.

Gjatë vitit 2021, janë regjistruar 15 raste të vdekjes, të gjitha vdekje natyrore (13 vdekje janë regjistruar në SHPMPF në Prishtinë, ndërsa 2 janë regjistruar në ISSH).

Muaji dhjetor 2021, është mbyllur me 270 rezidentë (131 rezidentë në tri institucionet e nivelit qendror dhe 139 rezidentë në institucionet e nivelit lokal, në Shtëpitë me Bazë në Komunitet).

4.4.1. Rezidentët e vendosur në institucionet e nivelit qendror dhe lokal, sipas gjinisë dhe etnitetit

Institucionet e nivelit qendror janë: Shtëpia për Personat e Moshuar pa Përkujdesje Familjare (SHPMPF) në Prishtinë, Instituti Special në Shtime (ISSH) dhe Shtëpia e Fëmijëve në Shtime (SHFSH), të cilat vazhdojnë të jenë nën menaxhimin e MFPT/DPSF-së. Gjatë vitit 2021 në këto tri institucione kanë qenë të vendosur 134 rezidentë (61 rezidentë në SHPMPF, 63 rezidentë në ISSH dhe 10 rezidentë në SHFSH). Prej tyre 102 shqiptarë, 14 serbë, 10 romë, 1 goran, 2 hungarez, 1 turk dhe 4 mysliman. Ndërsa sa i përket gjinisë, 73 ishin burra dhe 61 gra. Shih tabelën e mëposhtme:

Tabela 9: Rezidentët e vendosur në tri institucionet e nivelit qendror, sipas gjinisë dhe etnitetit, dhjetor 2021

INSTITUCIONI	Totali	Etniteti																		Totali	
		Shqiptar		Serb		Boshnjak		Kroat		Rom		Goran		Hungarez		Turq		Mysliman		Burra	Gra
		Burra	Gra	Burra	Gra	Burra	Gra	Burra	Gra	Burra	Gra	Burra	Gra	Burra	Gra	Burra	Gra	Burra	Gra	Burra	Gra
SHPMPF	61	25	25	0	4	0	0	0	0	1	0	0	0	1	0	1	0	1	3	29	32
ISSH	63	23	20	8	2	0	0	0	0	7	1	1	0	1	0	0	0	0	0	40	23
SHFSH	10	3	6	0	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	4	6
Totali	134	51	51	8	6	0	0	0	0	9	1	1	0	2	0	1	0	1	3	73	61

Institucionet e nivelit lokal janë 12 Shtëpi me Bazë në Komunitet (SHBK). Prej tyre 4 janë Shtëpi me Bazë në Komunitet për Personat e Moshuar pa Përkujdesje Familjare dhe 8 janë Shtëpi me Bazë në Komunitet për Personat me Aftësi të Kufizuara të Përhershme, decentralizimi i të cilave është bërë në fillim të vitit 2016.

Gjatë vitit 2021 në Shtëpitë me Bazë në Komunitet për personat e Moshuar pa Përkujdesje Familjare, kanë qenë të vendosur 54 rezidentë (22 rezidentë në Shtëpinë në Skenderaj, 7 rezidentë në Shtëpinë në Graçanicë, 19 rezidentë në Shtëpinë në Gurrakoc dhe 6 në Novobërdë). Prej tyre 39 shqiptarë, 12 serbë, 2 myslimanë dhe 1 rom. Ndërsa sa i përket gjinisë, 24 ishin burra dhe 30 gra. Shih tabelën e mëposhtme:

Tabela 10: Personat e moshuar pa përkujdesje familjare në SHBK, sipas gjinisë dhe etnisë, dhjetor 2021

Shtëpia me bazë në Komunitet për Personat e Moshuar në:	Totali	Etniteti																Totali		
		Shqiptar		Serb		Boshnjak		Mysliman		Rom		Goran		Hungarez		Turq		Burra	Gra	
		Burra	Gra	Burra	Gra	Burra	Gra	Burra	Gra	Burra	Gra	Burra	Gra	Burra	Gra	Burra	Gra			
Skenderaj	22	10	12	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	10	12
Graçanicë	7	0	0	3	4	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	3	4
Gurrakoc	19	9	8	0	0	0	0	0	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	9	10
Novoberdë	6	0	0	2	3	0	0	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2	4
Totali	54	19	20	5	7	0	0	0	2	0	1	0	0	0	0	0	0	24	30	

Gjatë vitit 2021 në Shtëpitë me Bazë në Komunitet për Personat me Aftësi të Kufizuar të Përhershme, ishin të vendosur 85 rezidentë (12 rezidentë në Shtëpinë në Kamenicë, 11 në Ferizaj, 10 në Deçan, 13 në Shtime, 12 në Vushtrri, 11 në Lipjan, 10 në Graçanicë dhe 6 në Prizren). Prej tyre, 58 shqiptarë, 13 serbë, 5 boshnjakë, 8 romë dhe 1 goran. Ndërsa sa i përket gjinisë 40 ishin burra dhe 45 ishin gra. Shih tabelën e mëposhtme:

Tabela 11: Personat me aftësi të kufizuara në SHBK, sipas gjinisë dhe etnitetit, dhjetor 2021

Shtëpia me bazë në Komunitet për Personat me Aftësi të:	Totali	Etniteti																Totali		
		Shqiptar		Serb		Boshnjak		Kroat		Rom		Goran		Hungarez		Turq		Burra	Gra	
		Burra	Gra	Burra	Gra	Burra	Gra	Burra	Gra	Burra	Gra	Burra	Gra	Burra	Gra	Burra	Gra			
Kamenicë	12	3	5	0	2	0	0	0	0	1	1	0	0	0	0	0	0	0	4	8
Ferizaj	11	5	3	0	1	1	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0	0	0	7	4
Deçan	10	5	4	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	5	5
Shtime	13	7	5	0	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	8	5
Vushtrri	12	3	5	2	0	0	0	0	0	1	1	0	0	0	0	0	0	0	6	6
Lipjan	11	4	4	0	0	0	1	0	0	0	2	0	0	0	0	0	0	0	4	7
Graçanicë	10	1	0	2	5	0	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	3	7
Prizren	6	2	2	0	0	0	0	0	0	1	1	0	0	0	0	0	0	0	3	3
Totali	85	30	28	4	9	2	3	0	0	3	5	1	0	0	0	0	0	40	45	

4.5. Skema për Përkrahje Materiale të Familjeve me Fëmijë me Aftësi të Kufizuara të Përhershme

Skema për Përkrahje Materiale të Familjeve të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara të Përhershme nga moshën 1-18 vjeç (FFAKP) në Kosovë, për herë të parë ka filluar të funksionojë në muajin qershor të vitit 2009, ndërsa pagesa është bërë në mënyrë retroaktive nga 01.01.2009. Kjo Skemë është skemë publike, universale dhe e financuar nga fondet publike, e cila është ngritur më qëllim të mbështetjes materiale për familjet që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara të përhershme.

Skema e FFAKP-së rregullohet me Ligjin Nr. 03/L-22 për Përkrahje Materiale të Familjeve të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara të Përhershme. E drejta për të përfituar nga kjo Skemë u takon fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme të moshës 1-18 vjeçare, që janë qytetarë të Republikës së Kosovës, janë me aftësi të kufizuara të përhershme, që nuk mund të lëvizin në mënyrë të pavarur dhe t'i kryejnë aktivitetet e përditshme jetësore dhe për këta persona është i nevojshëm kujdesi 24 orësh. Shuma materiale për një fëmijë është 100 euro në muaj.


4.5.1. Numri i fëmijëve në Skemën e FFAKP-së

Nga kjo Skemë, për çdo muaj kanë përfituar rreth 2.454 fëmijë. Numri më i madh është shënuar në muajin gusht 2021. Këtë muaj kanë përfituar 2.546 fëmijë. Ndërsa numri më i vogël është shënuar në muajin shkurt. Këtë muaj kanë përfituar 2.405 fëmijë. Shih tabelën dhe figurën më poshtë:


Tabela 12: Numri i fëmijëve përfitues të Skemës së FFAKP-së, 2021

Muaji	Numri i fëmijëve	Shuma e pagesës për muaj	Shuma shtesë	Totali
Janar	2,426	245,200.00 €	72,780.00 €	317,980.00 €
Shkurt	2,422	251,090.00 €	72,660.00 €	323,750,00 €
Mars	2,405	231.600,00 €	72,150.00 €	316,300,00 €
Prill	2,529	303.600 .00 €		303.600 .00 €
Maj	2,217	252.100,00 €		252.100,00 €
Qershor	2,496	250.000,00 €		250.000,00 €
Korrik	2,466	249.600,00 €		249.600,00 €
Gusht	2,546	289.000,00 €		289.000,00 €
Shtator	2,521	253.100,00 €		253.100,00 €
Tetor	2,499	253.200,00 €		253.200,00 €
Nëntor	2,479	248,100.00 €	247,900.00 €	496,000,00 €
Dhjetor	2,460	247.000,00 €		247.000,00 €
Totali		3,086,140.00 €	465,490.00 €	3,551,630.00 €

Figura 25: Numri i fëmijëve përfitues të Skemës së FFAKP-së, sipas muajve



Sipas tabelës dhe figurës së mësipërme, muaji dhjetor 2021 është mbyllur me 2.460 fëmijë, 24 fëmijë apo 1% më shumë në krahasim me muajin e njëjtë të vitit paraprak. Të 2.460 fëmijët e muajit dhjetor 2021 barten në vitin 2022 dhe do të vazhdojnë të jenë aktiv dhe të paguhen sipas legjislacionit në fuqi derisa ta arrijnë moshën 18 vjeçare.

Figura 26: Shuma e mjeteve të procesuara për pagesën e Skemës së FFAKP-së, sipas muajve

Bazuar në figurën e mësipërme, konstatohet se shuma më e lartë e mjeteve (pa llogaritur shtesën prej 30 euro të muajve janar, shkurt dhe mars dhe shtesën prej 100 euro të muajit nëntor), është procesuar në muajin prill 2021, këtë muaj janë procesuar 303,600 euro. Ndërsa shuma më e ulët është procesuar në muajin mars 2021, këtë muaj janë procesuar 244,150 euro. Gjatë vitit 2021, shuma mesatare e mjeteve të procesuara del të jetë 257,178.33 euro për çdo muaj.

Buxheti i shpenzuar për pagesën e Skemës së FFAKP-së për vitin 2021 është: 3,551,630 euro.

Siç vërehet edhe nga figura më lartë, për muajt janar, shkurt dhe mars 2021, të gjithë përfituesit e Skemës së FFAKP-së kanë përfituar edhe nga tridhjetë (30.00) euro shtesë, si pjesë e Pakos së Rimëkëmbjes Ekonomike, ndërsa në muajin nëntor 2021 kanë përfituar njëqind (100.00) euro shtesë, si pjesë e Pakos së Ringjalljes Ekonomike. Këto mjete shtesë janë ndarë nga Qeveria e Republikës së Kosovës për të ndihmuar këtë komunitet për të tejkaluar gjendjen e krijuar nga COVID 19.

Në vitin 2021 kemi një rritje të buxhetit të shpenzuar për 443,070 euro më shumë apo plus 14%, në krahasim me vitin paraprak.

4.5.2. Përfshirja e fëmijëve të Skemës së FFAKP-së në procesin mësimor

Në vitin 2017, përmes Bazës së të Dhënave, ka filluar të bëhet evidentimi i përfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara, përfitues të Skemës së FFAKP-së, në procesin mësimor.


Bazuar në të dhënat e kësaj baze, konstatohet se nga 2.460 fëmijët përfitues në muajin dhjetor 2021, në procesin mësimor në vitin 2021, janë të përfshirë 784 fëmijë apo 32% e numrit të përgjithshëm të fëmijëve përfitues të Skemës së FFAKP-së (85 fëmijë apo 3% janë në kopshte, 269 fëmijë apo 11% janë

parashkollorë, 422 fëmijë apo 17% janë në shkollë fillore, 8 fëmijë apo 0% janë në shkollë të mesme dhe 1,676 fëmijë apo 68% nuk janë në shkollë). Shih tabelën dhe figurën më poshtë:

Tabela 13: Numri i fëmijëve të Skemës së FFAKP-së të përfshirë në procesin mësimor

	Kopsht	Parashkollor	Arsim fillor	Arsim i mesëm	Nuk janë në shkollë	Totali
Numri	85	269	422	8	1,676	2,460
%	3.46%	10.93%	17.15%	0.33%	68.13%	100%

Figura 27: Numri i fëmijëve të Skemës së FFAKP-së, të përfshirë në procesin mësimor, 2021/2020




Bazuar në të dhënat e prezantuara në figurën 26, vërehet se gjatë vitit 2021, tek totali kemi një rënie të numrit të fëmijëve të përfshirë në procesin arsimor për 111 fëmijë më pak, apo minus 7% në krahasim me vitin paraprak.


4.5.3 Puna e Komisioneve Mjekësore, shkalla I dhe shkalla II

Procedurat e punës së Komisionit Mjekësor (shkalla I dhe II) dhe metodologjia për vlerësimin dhe rivlerësimin e nivelit dhe të llojit të paaftësisë për përfituesit e Skemës së FFAKP-së, janë të parapara me aktet ligjore përkatëse të nxjerra nga Ministria.

Gjatë vitit 2021, Komisioni Mjekësor i shkallës I, ka mbajtur dy seanca ku janë vlerësuar 436 kërkesa të reja. Nga ky numër pozitivisht janë vlerësuar 197 kërkesa, janë refuzuar 119 kërkesa, në plotësim janë kthyer 95 kërkesa, ndërsa 25 kërkesa/raste nuk i janë përgjigjur ftesës së Komisionit Mjekësor, nuk janë paraqitur në seancë.

Figura 28: Numri i kërkesave të reja të vlerësuara nga Komisioni Mjekësor i shkallës I, 2021

Komisioni Mjekësor i shkallës II, ka mbajtur tri seanca, ku janë shqyrtuar 57 ankesa. Nga ky numër, 7 ankesa janë aprovuar, 49 janë refuzuar dhe 1 ankesë është në plotësim.

Figura 29: Numri i ankesave të vlerësuara nga Komisioni Mjekësori shkallës II, 2021

Nga Gjykata janë kthyer 3 lëndë/ankesa, të cilat janë shqyrtuar/vlerësuar nga një Komisioni i veçantë. Nga ky numër 1 lëndë/ankesë është aprovuar, ndërsa 2 lëndë/ankesa janë refuzuar.

5. DIVIZIONI I NDIHMËS SOCIALE

5.1. Detyrat dhe përgjegjësitë

Divizioni i Ndhmës Sociale (DNS) funksionon dhe vepron në kuadër të Departamentit për Politika Sociale dhe të Familjes (DPSF), gjegjësisht, në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), i cili ka për detyrë që në bashkëpunim të ngushtë me institucionet e tjera vendore dhe ndërkombëtare të grumbullojë dhe analizojë të dhëna mbi gjendjen shoqërore dhe ekonomike në Kosovë, veçmas, në vlerësimin e varfërisë dhe marrjen e hapave konkrete në zbutjen e saj. Tërë këtë punë, DNS-ja e zhvillon në bazë të politikave dhe strategjive të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Planit dhe Programit vjetor të punës së DPSF/DNS-së, dhe është përgjegjëse për planifikimin, organizimin dhe monitorimin e tërë Skemës së Ndhmës Sociale (ndihmat sociale, ndihmat emergjente dhe subvencionet e tjera për të ndihmuar familjet në nevojë sociale dhe ekonomike). DNS-ja bën monitorimin dhe mbikëqyrjen e punës profesionale të nëpunësve të Skemës së Ndhmës Sociale (SNS) dhe Qendrave për Punë Sociale (QPS), të cilët i ofrojnë këto shërbime-mbrojtje sociale për familjet e varfra në Kosovë.

Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit të Ndhmës Sociale, janë:

- ✓ *Propozon, harton dhe siguron zbatimin e dokumenteve të politikave/strategjive për ndihma sociale;*
- ✓ *Grumbullon, analizon dhe raporton për të dhënat mbi varfërinë në Kosovë, në bashkëpunim me institucionet e tjera relevante;*
- ✓ *Propozon, harton dhe siguron zbatimin e legjislacionit për ndihmë sociale;*
- ✓ *Koordinon aktivitetet me institucionet relevante;*
- ✓ *Monitoron procesin e pagesave nga Skema e Ndhmave Sociale dhe harton raporte të rregullta periodike;*
- ✓ *Bashkëpunon me organizata joqeveritare për zhvillimin e aktiviteteve;*
- ✓ *Mirëmban sistemin elektronik të të dhënave për aplikuesit-përfituesit e SNS-së.*

Udhëheqësi i Divizionit të Ndhmës Sociale, raporton tek Udhëheqësi i Departamentit për Politika Sociale dhe të Familjes.

Divizioni i Ndhmës Sociale (DNS), përbëhet nga:

- Njësia e Ndhmave Sociale,
- Njësia për Ankesa e Shkallës II, dhe
- Njësia e Kontrollit dhe Mbikëqyrjes.

5.2. Struktura Organizative e Skemës së Ndhmës Sociale

Skema e Ndhmës Sociale, është e organizuar në dy nivele:

1. Niveli qendror:

- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT),
- Departamenti për Politika Sociale dhe i Familjes (DPSF);

2. Niveli lokal:

- Drejtoritë Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale (DKSHMS);
- Qendrat për Punë Sociale (38 QPS-së).

5.3. Delegimi i Skemës së Ndhmës Sociale në nivelin komunal

Delegimi dhe përcaktimi i përgjegjësive të nivelit qendror (Ministri-DPSF) dhe nivelit lokal (komuna-DKSHMS-QPS) për Skemën e Ndhmës Sociale, gjegjësisht, dekoncentrimi i SNS-së ka ndodhur në janar të vitit 2009 dhe është bërë në bazë të: Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale; Marrëveshjen e Mirëkuptimit për bartjen e kompetencave të shërbimeve sociale dhe delegimin e përgjegjësive të ndihmave sociale në nivel komunal; Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2010 për procedurat lidhur me delegimin e përgjegjësive për Skemën e Ndhmës Sociale në nivel komunal. Realizimi i këtij procesi është marrë përsipër nga MPMS-ja, Ministria e Financave (MF), Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) dhe Komunitat.

5.4. Përgjegjësitë e nivelit qendror për Skemën e Ndhmës Sociale

Përgjegjësitë e nivelit qendror (Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, konkretisht Departamenti për Politika Sociale dhe të Familjes) për Skemën e Ndhmës Sociale janë:

- ✓ *Hartimi i politikave dhe planeve strategjike për zhvillimin dhe funksionimin e Skemës së Ndhmës Sociale;*
- ✓ *Hartimi i infrastrukturës ligjore dhe rregullave nacionale për Skemën e Ndhmës Sociale;*
- ✓ *Hartimi i standardeve minimale për ofrimin e shërbimeve për ndihma sociale;*
- ✓ *Monitorimi, kontrollimi dhe inspektimi i cilësisë së këtyre shërbimeve, zbatimi i Ligjit dhe rregullave nacionale për SNS-në;*
- ✓ *Në bashkëpunim me Ministrinë përkatëse planifikon dhe alokon mjetet e nevojshme buxhetore për pagesat e ndihmave sociale, sipas kërkesave të komunave-QPS-ve;*

- ✓ *Në rrethana të veçanta, kur niveli komunal (DKSHMS-QPS) nuk përmbush standardet minimale për ofrimin e ndihmave sociale, atëherë Ministria/DPSF mund ta kthejë përgjegjësinë e deleguar, për atë kohë sa e sheh të nevojshme (jo më tepër se një vit).*

5.5. Përgjegjësitë e nivelit lokal

Qendrat për Punë Sociale janë institucione të caktuara nga Ministria për të administruar Skemën e Ndhmës Sociale.¹³ Aktualisht në çdo komunë të Kosovës ka nga një QPS, gjithsej 38 QPS, mirëpo me qëllim që këto shërbime të jenë edhe më afër qytetarëve, funksionojnë edhe dy njësi: Kodra e Trimave dhe Kodra e Diellit në Prishtinë (QPS-të në Prishtinë); dhe pesë (5) nënzyra: Gorazhdec (Pejë); Prilluzhë (Vushtrri); Qabër (Zubin Potok); Lipa-Kelmend (Zveçan) dhe Cerajë (Leposaviq).

Përgjegjësitë e nivelit lokal, janë:

- ✓ *Të themelojnë dhe mirëmbajnë Qendrat për Punë Sociale, të cilat mund të kenë një apo më shumë degë;*
- ✓ *Të vlerësojnë dhe identifikojnë nevojat në nivel komunal;*
- ✓ *Të menaxhojnë me asetet dhe stafin e QPS-së;*
- ✓ *Të zbatojnë infrastrukturën ligjore, rregullat nacionale dhe standardet minimale për ofrimin e shërbimeve për ndihma sociale;*
- ✓ *Të ofrojnë kushte, të dhëna dhe dokumentacion për kontroll dhe inspektim të Shërbimit të SNS-së për Njësinë e Auditorit të Brendshëm (NJAB) dhe Njësinë e Kontrollit dhe Mbikëqyrjes (NJKM);*
- ✓ *Të pranojnë, shqyrtojnë dhe nxjerrin aktvendime për njohjen apo mosnjohjen e të drejtës së parashtruesve të kërkesës për ndihmë sociale;*
- ✓ *Të hartojnë plane dhe raporte mujore, periodike dhe vjetore për SNS-në, të cilat i shqyrtojnë dhe miratojnë DPSF/Ministri;*
- ✓ *Të ndajnë buxhet të mjaftueshëm për funksionimin normal të QPS-ve.*

5.5.1. Administrimi i SNS-së në nivelin lokal/komunë

Shërbimet e ndihmës sociale brenda Qendrave për Punë Sociale, të caktuara për të administruar Skemën e Ndhmës Sociale, menaxhohen nga udhëheqësi i shërbimit të ndihmës sociale, i cili zgjidhet nga komuna, në bashkëpunim me Ministrinë.¹⁴

Udhëheqësi i Skemës së Ndhmës Sociale për realizimin e detyrave dhe përgjegjësi, i përgjigjet drejtorit (drejtorisë përkatëse) në komunë dhe i raporton Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.¹⁵

Autoriteti përgjegjës për zhvillimin e proceduarve, përgatitjen e lëndës, verifikimin e gjendjes socio-ekonomike dhe përzgjedhjen apo refuzimin e familjes në Skemën e Ndhmës Sociale është nëpunësi i

¹³ Ligji Nr. 2003/15 për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë.

¹⁴ Ligji Nr. 04/L-096 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.2003/15 për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë, paragrafi 3.2

¹⁵ Po aty, neni 3, paragrafi 3.3

Skemës së Ndhmës Sociale (menaxheri i rastit), ndërsa përgjegjësinë për vendimmarrje e ka udhëheqësi i Shërbimit të Skemës së Ndhmës Sociale.¹⁶

Ministria në rast të konstatimit të shkeljeve të rënda të administrimit të Skemës së Ndhmës Sociale, mund ta marrë në administrim të drejtpërdrejtë Skemën e Ndhmës Sociale në atë komunë, për një periudhë jo më të gjatë se një (1) vit.¹⁷

5.6. Kriteret për të përfituar ndihmën sociale

Skema e Ndhmës Sociale në Kosovë, për herë të parë është prezantuar në vitin 2000 dhe është rishqyrtuar më vitin 2003 dhe 2012. Skema është publike, universale dhe e financuar nga fondet publike. Kjo skemë është ngritur më qëllim të mbështetjes dhe ofrimit të ndihmës së përkohshme financiare për familjet që janë në varfëri.¹⁸

Skema e Ndhmës Sociale në Kosovë rregullohet me Ligjin bazë Nr. 2003/15 për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë, me Ligjin Nr. 04/L-096 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 2003/15 për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë, dhe me një numër të caktuar të Udhëzimeve Administrative, të cilat janë përmendur te pjesa e infrastrukturës ligjore (aktet nënligjore) të Skemës së Ndhmës Sociale.

Bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore që e rregullojnë SNS-në, për të realizuar të drejtën në ndihmë sociale, të gjithë anëtarët e familjes duhet të jenë shtetas të Republikës së Kosovës, përjashtimisht, edhe shtetasit e huaj të cilët:

- a) kanë leje qëndrimi,
- b) personat në cilësinë e azilkërkuessit,
- c) personat në cilësinë e refugjatit, dhe
- d) personat të cilët gëzojnë mbrojtje të përkohshme dhe plotësuese, dhe i plotësojnë kushtet për kategorizim në njërin prej kategorive vijuese:

Kategoria e parë - Familja në të cilën të gjithë anëtarët e familjes janë të varur dhe asnjëri prej tyre nuk është i punësuar; dhe

Kategoria e dytë - Familja me një anëtar të aftë për punë, me të paktën një fëmijë nën moshën 5 vjeç apo që kanë në përkujdesje të përhershme një jetim nën moshën 15 vjeç.

Përveç këtyre kriterëve bazë, familjet (e të dy kategorive I dhe II) për të përfituar ndihmën sociale, nuk duhet të kenë në pronësi më shumë 0.5 hektarë tokë, të hyra financiare dhe të mira materiale të llogaritshme, ashtu siç është e përcaktuar me aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë Skemën e Ndhmës Sociale.

¹⁶ Po aty, neni 3, paragrafi 3.5.

¹⁷ Po aty, neni 3, paragrafi 3.4.

¹⁸ Po aty, neni 1.

Kutia 1: Nocioni “familje” dhe “bashkësi familjare” sipas Ligjit për Skemën e Ndhmës Sociale

Sipas Ligjit Nr. 2003/15 për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë, neni 2, paragrafi 2.1, thuhet:

“**Familja**” - përbëhet prej atyre personave, nevojat e të cilëve merren parasysh me rastin e vendosjes së përzgjedhshmërisë dhe shumës së ndihmës sociale, dhe përkufizohet si një bashkësi që përbëhet prej paraqitësit të kërkesës ose marrësit të ndihmës dhe të gjithë anëtarëve të tjerë të familjes, të cilët janë në bashkësi familjare: bashkëshorti/ja e tij /saj ose partnerët që jetojnë bashkë, prindërit dhe fëmijët, përfshirë fëmijët e birësuar (bijëzuar) fëmijët në strehim familjar, apo fëmijët e njërit partner. Prandaj, familja mund të përbëhet nga paraqitësi i kërkesës ose marrësit të ndihmës dhe një, dy, tre, a më shumë anëtarëve që jetojnë në një bashkësi familjare. Individit pa asnjë anëtar tjetër të familjes në bashkësinë familjare, sipas këtij Ligji, konsiderohet një familje.

Ndërsa në paragrafin 2.4 të po këtij neni thuhet:

“**Bashkësia familjare**” - përkufizohet si një grup individësh që jetojnë bashkë nën një kulm dhe që bashkërisht ndajnë shpenzimet e jetesës. Sipas këtij Ligji, bashkësia familjare mund të përfshijë personat që nuk janë anëtarë të familjes.

Personat që kanë mbushur moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç dhe që kanë mbaruar shkollimin e mesëm, konsiderohen si të aftë për punë dhe në gjendje për të punuar edhe nëse vazhdojnë shkollimin e rregullt në universitet ose në ndonjë program trajnues.¹⁹

Personat që: a) banojnë; ose b) janë në institucione të tipit të mbyllur, si: institucionet psikiatrike, shtëpitë e pleqve, institucionet religjioze, shkollat rezidenciale dhe burgjet, nuk mund të përfitojnë ndihmë sociale, sipas dispozitave ligjore dhe nënligjore të Skemës së Ndhmës Sociale.

Autoriteti përgjegjës për zhvillimin e procedurave, përgatitjen e lëndës, verifikimin e gjendjes socio-ekonomike dhe përzgjedhjen apo refuzimin e familjes në Skemën e Ndhmës Sociale, është nëpunësi i Skemës së Ndhmës Sociale (menaxheri i rastit), ndërsa përgjegjësinë për vendimmarrje e ka udhëheqësi i Shërbimit të Skemës së Ndhmës Sociale²⁰, do të thotë niveli lokal - Qendra për Punë Sociale në komunën përkatëse. Ndërsa, niveli qendror (Ministria) harton politikat dhe strategjitë, infrastrukturën ligjore, ushtron kontroll dhe mbikëqyrje dhe siguron buxhetin për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë.

Shuma mujore e ndihmës sociale për një familje përcaktohet sipas numrit të pikave, numrit të anëtarëve të familjes dhe kostos së çmimeve të konsumit të shportës së ushqimit, e cila rregullohet me akt nënligjor të cilin e nxjerr Ministria²¹. Kjo i bie që personi i vetëm – familja njëanëtarëshe merr 60 euro në muaj (minimalja), dhe familja me 15 anëtarë (maksimalja) për një muaj merr 180 euro në muaj.²² Përveç ndihmës bazë “familja e përzgjedhur për Skemën e Ndhmës Sociale për çdo fëmijë të moshës zero (0) e deri në

¹⁹ Ligji Nr.04/L-096 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 2003/15 për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë, Neni 4, paragrafi 4.10

²⁰ Po aty, Neni 3, paragrafi 3.5

²¹ Po aty, neni 8, paragrafi 9.1.

²² Vendimi nr. 15/24 i Qeverisë së Republikës së Kosovës, dt.12.01.2018.

tetëmbëdhjetë 18 vjeç”, realizon një përfitim financiar prej 5 eurosh si shtesë për fëmijë, me qëllim të nxitjes së arsimimit dhe përmirësimit të shëndetit.²³

Kohëzgjatja e shfrytëzimit të ndihmës sociale për familjet në Kategorinë I është 12 muaj²⁴, ndërsa për familjet në Kategorinë II është gjashtë muaj, me kusht që gjatë gjithë kësaj periudhe familjet në Kategorinë I dhe II, të jenë të përzgjedhshme, ashtu siç është paraparë me dispozita ligjore dhe nënligjore të SNS-së.

Kutia 2: Ku bëhet aplikimi për ndihmë sociale?

Në Qendrat për Punë Sociale bëhet aplikimi për Ndhmë Sociale, ku:

Çdo individ apo familje që konsideron se i plotëson kriteret për ndihmë sociale dhe ka nevojë për informacione shtesë për Skemën e Ndhmës Sociale, mund t'i drejtohet Qendrës për Punë Sociale në komunën ku banon.

5.7. Numri i familjeve dhe anëtarëve të familjes në SNS

Bazuar në legjisllacionin në fuqi që rregullon SNS-në, gjatë periudhës raportuese janar-dhjetor 2021, zyrtarët dhe udhëheqësit e SNS-së, kanë qenë të përkushtuar që të zbatojnë aktet ligjore dhe nënligjore, me të cilat rregullohet Skema e Ndhmës Sociale në Kosovë, përkatësisht, në zbatimin Ligjit Nr. 2003/15 për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë, Ligjin Nr. 04/L-096 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 2003/15 për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë, si dhe të Udhëzimeve Administrative për këtë Skemë, edhe përkundër vështirësive të paraqitura nga gjendja e krijuar nga COVID-19.

Gjatë vitit 2021, me qëllim të tejkalimit të gjendjes së krijuar nga pandemia COVID-19, me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të gjithë përfituesit e SNS-së, kanë përfituar dyfishin e shumës së ndihmës sociale për muajt janar, shkurt dhe mars 2021, dhe kanë përfituar rritje me 30% mbi nivelin e rregullt të pagesës për muajt prill, maj dhe qershor 2021 nga Pakoja e Rimëkëmbjes Ekonomike,²⁵ ndërsa rritje me 30% mbi nivelin e rregullt të pagesës për muajt korrik, gusht, shtator, tetor, nëntor dhe dhjetor 2021 dhe dyfishin e shumës së ndihmës sociale për muajt nëntor dhe dhjetor 2021 kanë përfituar nga Pakoja e Ringjalljes Ekonomike, Masa 3.

Edhe gjatë vitit 2021, si rezultat i gjendjes së krijuar nga COVID-19, Qeveria e Republikës së Kosovës ka marrë vendim që të vazhdohen masat lehtësuese për familjet përfituese të ndihmës sociale si: pezullimi i riaplikimit direkt të palëve, i verifikimit të gjendjes në terren, i mbajtjes së seancave mjekësore, ndërprerja e ndihmës sociale për shkak të kriterëve, etj. Masa të cilat kanë ndikuar në rritjen e numrit të familjeve në SNS, si dhe në rritjen e shumës së mjeteve financiare të procesuara për pagesën e SNS-së për vitin 2021 në krahasim me vitin 2020. (Shih tabelën 14 dhe figurat 29 dhe 30.)

²³ Ligji Nr. 04/L-096 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.2003/15 për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë, neni 9 A.

²⁴ Po aty, neni 7, paragrafi 1.

²⁵ Shih: https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/FEC082F0-53E1-46B9-BC9B-5F23C29920CE.pdf?fbclid=IëAR2c6uVrënmK8ËtMFkNO-eNLCi4Heol25BQoP_Ydmq-ëc131NTAfh2XVv6Q

Gjatë vitit 2021 numri i familjeve në Skemën e Ndhmës Sociale ka shënuar ngritje dhe rënie nga muaji në muaj. Numri më i madh i familjeve në SNS është shënuar në muajin Mars, me 26.298 familje, kurse numri më i vogël i familjeve është shënuar në muajin shkurt, me 25.514 familje.

Numri mesatar i familjeve që kanë përfituar ndihmë sociale çdo muaj gjatë vitit 2021 është 25.820 familje, 103.012 është numri mesatar i anëtarëve të familjes ndërsa 5,363.784 euro është shuma mesatare e mjeteve të procesuara. (Shih tabelën 14 dhe figurat 29 dhe 30.)

Nëse iu referohemi të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK)²⁶, numri i përgjithshëm i ekonomive familjare në Kosovë, sipas Anketës së Fuqisë Punëtore për vitin 2019, ishte 360.718 ekonomi familjare. Nëse krahasohet ky numër me numrin e familjeve në Skemën e Ndhmës Sociale (25,679 familje/dhjetor 2020), rezulton se 7% e familjeve/ekonomive familjare në Kosovë janë të përfshira në Skemën e Ndhmës Sociale. Ndërsa, nëse krahasohet numri i anëtarëve të familjes në SNS (103,189 anëtarë/dhjetor 2020) me numrin e banorëve në Kosovë (1,739,825 banorë/regjistrimi i vitit 2011)²⁷, rezulton se 6% e banorëve në Kosovë është e përfshirë në SNS.

Tabela 14: Numri i familjeve dhe anëtarëve të familjes në SNS, 2021


Muaji	Numri i familjeve	Anëtarët e familjes	Mjetet e procesuara
Janar	25,768	103,303	5,404,017.50 €
Shkurt	26,120	104,780	5,482,312.50 €
Mars	26,298	105,296	5,510,620.00 €
Prill	26,033	104,116	3,482,552.00 €
Maj	25,921	103,512	3,464,168.00 €
Qershor	25,805	102,958	3,449,918.00 €
Korrik	25,714	102,371	3,424,733.00 €
Gusht	25,538	101,681	3,399,920.75 €
Shtator	25,514	101,621	3,400,056.50 €
Tetor	25,549	101,588	3,402,027.00 €
Nëntor	25,681	102,019	6,578,840.25 €
Dhjetor	25,895	102,904	6,638,315.75 €
Totali:			53,637,481.25 €²⁸

Në muajin dhjetor 2020, numri i familjeve në SNS ka shënuar një rritje të vogël, 216 familje më shumë apo plus 1%, në krahasim me të dhënat muajit të njëjtë të vitit 2020. Shih tabelën 14 dhe figurën 29:


²⁶ Shih: <https://ask.rks-gov.net/media/5629/vjetari-final-2020-per-ëeb.pdf>, fq 13;

²⁷ Po aty fq. 35;

²⁸ **Sqarim:** të gjitha familjet në SNS, me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës, kanë përfituar: dyfishin e shumës së ndihmës sociale për muajt janar, shkurt dhe mars 2021, rritjen prej 30% mbi nivelin e rregullt të pagesës për muajt prill, maj dhe qershor 2021, nga Pakoja e Rimëkëmbjes Ekonomike, rritjen me 30% mbi nivelin e rregullt të pagesës për muajt korrik, gusht, shtator, tetor, nëntor dhe dhjetor 2021 dhe dyfishin e shumës së ndihmës sociale për muajt nëntor dhe dhjetor 2021, nga Pakoja e Ringjalljes Ekonomike, Masa 3. Shuma e mjeteve bazë për pagesën e familjeve përfituese të ndihmës sociale është mbi 32 milion euro (mbi 1 milion euro më shumë se në vitin 2020), ndërsa shuma e mjeteve shtesë është mbi 21 milion euro (mbi 6 milion euro më shumë se në vitin 2020).

Figura 30: Familjet në Skemën e Ndhmës Sociale sipas muajve, 2021/2020

Gjatë vitit 2021 numri më i madh i anëtarëve të familjes është evidentuar në muajin mars, 105.296 anëtarë, kurse numri më i vogël në muajin tetor 101.588 anëtarë. Në muajin dhjetor 2021, numri i anëtarëve të familjes në SNS ka shënuar një rënie të lehtë, 285 anëtarë më pak apo minus 0.28% në krahasim me muajin e njëjtë të vitit paraprak. Shih tabelën 14 dhe figurën 30:

Figura 31: Anëtarët e familjes në Skemën e Ndhmës Sociale sipas muajve, 2021/2020

Sipas tabelës 14 dhe figurës 31, shuma më e madhe e mjeteve të procesuara është në muajin dhjetor 2021, 6,638,315.75 euro (shuma bazë 3,929,423.92 euro), kurse shuma më e vogël është procesuar në muajin tetor 2021, 2,672,533.85 euro. Në muajin dhjetor 2021, shuma bazë e mjeteve të procesuara (3,929,423.92 pa shtesa) është rritur për 1,230,718.92 euro apo plus 0.46%, në krahasim me muajin e njëjtë të vitit 2020.

Figura 32: Pagesat e ndihmës sociale sipas muajve, 2021/2020






5.7.1. Familjet dhe anëtarët e familjes në SNS sipas komunave/QPS-ve

Në muajin dhjetor 2021, ndihmë sociale kanë përfituar 25.895 familje me 102.904 anëtarë. Edhe këtë muaj numrin më të madh të familjeve, anëtarëve të familjes dhe shumën e mjeteve e ka komuna apo QPS-ja e Mitrovicës. Në këtë komunë/QPS kanë përfituar ndihmë sociale 2.360 familje apo 9.11% e totalit të familjeve në SNS, 9.674 anëtarë apo 9.40% e totalit të anëtarëve të familjes në SNS, ndërsa shuma e mjeteve që është ndarë për pagesën e këtyre familjeve është 617,961 euro apo 9.26% e shumës totale. (Për më tepër shih tabelën 15 dhe figurat 32, 33 dhe 34)

Tabela 15: Numri i familjeve, anëtarëve të familjes dhe shuma e mjeteve sipas komunave (dhjetor 2021)

Regjioni	QPS	Numri i familjeve	Numri i anëtarëve të familjes	Shuma në €
Ferizaj	Ferizaj	1,033	4,211	268,297.25
	Hani i Elezit	128	536	33,733.00
	Kaçanik	798	3,371	209,914.00
	Lipjan	1,346	5,825	360,975.75
	Shtërpçë	283	975	68,274.50
	Shtime	368	1,674	99,244.00
	Nën Total / Sub Total:	3,956	16,592	1,040,438.50
Gjakovë	Gjakovë	1,044	4,227	272,238.00
	Junik	52	175	12,308.50
	Rahovec	667	2,790	175,531.50
	Nën Total / Sub Total:	1,763	7,192	460,078.00
Gjilan	Gjilan	763	2,864	188,902.00
	Kamenicë	565	2,173	142,784.00
	Klllokot	126	428	30,511.00
	Partesh	61	184	14,455.00
	Ranillug	204	551	46,549.00
	Viti	476	2,064	124,528.25
		Nën Total / Sub Total:	2,195	8,264
Mitrovicë	Leposaviç	361	839	77,188.75
	Mitrovica Veriut	698	1,778	151,714.50
	Mitrovicë	2,360	9,674	614,961.00
	Skënderaj	869	3,841	231,594.25
	Vushtrri	1,474	6,488	393,967.00
	Zubin Potok	610	1,417	128,341.50
	Zveçan	370	832	75,635.25
	Nën Total / Sub Total:	6,742	24,869	1,673,402.25
Pejë	Deçan	322	1,251	82,239.00
	Istog	363	1,548	96,385.00
	Klinë	908	3,786	239,189.75
	Pejë	1,069	4,089	268,338.50
	Nën Total / Sub Total:	2,662	10,674	686,152.25
Prishtinë	Artanë	514	1,675	120,951.75
	Fushë Kosovë	954	4,080	255,167.00
	Glllogoc	1,225	5,386	329,352.00
	Graçanicë	122	428	29,246.50
	Obiliç	774	3,221	203,861.25
	Podujevë	960	4,378	258,237.00
	Prishtinë KD	311	1,159	77,576.50
	Prishtinë KT	842	3,290	215,547.50
	Prishtinë Qendra	339	1,312	86,490.00
		Nën Total / Sub Total:	6,041	24,929
Prizren	Dragash	418	1,377	99,426.00
	Malishevë	816	3,850	224,981.50
	Mamushë	19	73	4,904.50
	Prizren	786	2,894	192,154.50
	Suharekë	497	2,190	132,619.50
	Nën Total / Sub Total:	2,536	10,384	654,086.00
Totali		25,895	102,904	6,638,315.75²⁹

²⁹ Në dhjetor 2021 të gjitha familje në ndihmës sociale kanë përfituar dyfishin e shumës së ndihmës sociale.

Figura 33: Numri i familjeve në SNS sipas komunave (dhjetor 2021)**Figura 34: Numri i anëtarëve të familjes në SNS sipas komunave (dhjetor 2021)****Figura 35: Shuma e mjeteve të procesuara për ndihmë sociale sipas komunave (dhjetor 2021)**

5.7.2. Bartësit e lëndës dhe anëtarët e familjes sipas gjinisë

Tabela 16: Numri i bartësve të lëndës dhe i anëtarëve të familjes sipas gjinisë (dhjetor 2021)

Regjioni	QPS	Numri i familjeve	Bartësit e lëndës sipas gjinisë		Numri i anëtarëve të familjes	Anëtarët e familjes sipas gjinisë	
			Burra	Gra		Burra	Gra
Prishtina	Artanë	514	305	209	1,675	809	866
	Fushë Kosovë	954	643	311	4,080	1,990	2,090
	Glllogoc	1,225	995	230	5,386	2,659	2,727
	Graçanicë	122	74	48	428	210	218
	Obiliç	774	604	170	3,221	1,573	1,648
	Podujevë	960	664	296	4,378	2,091	2,287
	Prishtinë K.D	311	162	149	1,159	503	656
	Prishtinë K.T	842	459	383	3,290	1,581	1,709
	Prishtinë Qendra	339	175	164	1,312	636	676
Nën Total:		6,041	4,081	1,960	24,929	12,052	12,877
Pejë	Deçan	322	171	150	1,251	607	644
	Istog	363	284	80	1,548	692	856
	Klinë	908	725	183	3,786	1,811	1,975
	Pejë	1,069	702	367	4,089	1,901	2,188
Nën Total:		2,662	1,882	780	10,674	5,011	5,663
Prizreni	Dragash	418	273	145	1,377	676	701
	Malishevë	816	630	186	3,850	1,868	1,982
	Mamushë	19	9	10	73	35	38
	Prizren	786	431	354	2,894	1,369	1,525
	Suharekë	497	278	220	2,190	1,082	1,108
Nën Total:		2,536	1,621	915	10,384	5,030	5,354
Ferizaj	Ferizaj	1,033	612	421	4,211	1,979	2,232
	Hani i Elezit	128	104	24	536	260	276
	Kaçanik	798	573	225	3,371	1,652	1,719
	Lipjan	1,346	1,006	340	5,825	2,868	2,957
	Shtërpcë	283	173	110	975	478	497
	Shtime	368	294	74	1,674	806	868
Nën Total:		3,956	2,762	1,194	16,592	8,043	8,549
Gjakova	Gjakovë	1,044	682	362	4,227	2,008	2,219
	Junik	52	25	27	175	83	92
	Rahovec	667	461	206	2,790	1,379	1,411
Nën Total:		1,763	1,168	595	7,192	3,470	3,722
Gjilani	Gjilan	763	366	397	2,864	1,388	1,476
	Kamenicë	565	378	187	2,173	1,065	1,108
	Klllokot	126	67	59	428	223	205
	Partesh	61	37	24	184	81	103
	Ranillug	204	95	109	551	299	252
	Viti	476	302	174	2,064	1,002	1,062
Nën Total:		2,195	1,245	950	8,264	4,058	4,206
Mitrovicë	Leposaviç	361	169	192	839	408	431
	Mitrovica Veriut	698	281	417	1,778	893	885
	Mitrovicë	2,360	1,720	640	9,674	4,812	4,862
	Skënderaj	869	675	194	3,841	1,908	1,933
	Vushtrri	1,474	917	557	6,488	3,187	3,301
	Zubin Potok	610	276	334	1,417	684	733
	Zveçan	370	165	205	832	405	427
Nën Total:		6,742	4,203	2,539	24,869	12,297	12,572
TOTAL:		25,895	16,962	8,933	102,904	49,961	52,943

Figura 36: Bartësit e lëndës sipas gjinisë, dhjetor 2021





Figura 37: Anëtarët e familjes sipas gjinisë, dhjetor 2021



Bazuar në tabelën më lartë dhe në figurën 35, konstatohet se nga 25.895 bartës të lëndës/familje, që ishin përfitues të Skemës së Ndihmës Sociale, në muajin dhjetor 2021, 16.962 bartës të lëndës apo 66% janë burra ndërsa 8.933 bartës të lëndës apo 34% janë gra. Pra, numri i bartësve burra është më i madh për 8.029 bartës apo 31% në krahasim me numrin e bartësve gra.

Sa i përket gjinisë së anëtarëve të familjes, konstatohet se nga 102.904³⁰ anëtarët e familjes, 49.961 apo 49% janë burra, ndërsa 52.943 apo 51% janë gra. Pra, tek anëtarët e familjes kemi një përfshirje më të madhe të femrave për 2.982 anëtarë apo 3% në krahasim me anëtarët burra. (Shih tabelën 16 dhe figurën 36.)


5.7.3. Familjet në SNS sipas numrit të anëtarëve të familjes

Nga gjithsej 25.895 familje në SNS, sa ishin në dhjetor 2021, numrin më të madh e përbëjnë familjet 4 anëtarëshe me 6.003 familje apo 23%, pastaj familjet 5 anëtarëshe me 5.208 familje apo 20%, familjet 3 anëtarëshe me 4.150 familje apo 16%, e kështu me radhë. Ndërsa, numrin më të vogël të familjeve e përbëjnë familjet 12 anëtarëshe me 4 familje apo 0.02%, familjet 13 anëtarëshe me 5 familje apo 0.02% e kështu me radhë. (Shih tabelën 17 dhe figurën 37)

³⁰ **Shënim:** tek ky numër janë përfshirë edhe bartësit e lëndës.

Tabela 17: Familjet sipas numrit të anëtarëve, dhjetor 2021

Familjet sipas numrit të anëtarëve	Numri i familjeve	%
Familjet me 1 anëtar	2,203	8.51
Familjet me 2 anëtarë	3,659	14.13
Familjet me 3 anëtarë	4,150	16.03
Familjet me 4 anëtarë	6,003	23.18
Familjet me 5 anëtarë	5,208	20.11
Familjet me 6 anëtarë	2,936	11.34
Familjet me 7 anëtarë	1,081	4.17
Familjet me 8 anëtarë	419	1.62
Familjet me 9 anëtarë	160	0.62
Familjet me 10 anëtarë	52	0.20
Familjet me 11 anëtarë	15	0.06
Familjet me 12 anëtarë	4	0.02
Familjet me 13 anëtarë	5	0.02
TOTALI:	25,895	100.00

Figura 38: Familjet në SNS sipas numrit të anëtarëve të familjes, dhjetor 2021/2020

Gjatë vitit 2021, numri i familjeve sipas anëtarëve të familjes nuk ka ndryshuar shumë nga viti 2020. Shih figurën më lartë.


5.7.4. Bartësit e ndihmës sociale sipas kategorive

Nga gjithsej 25.895 familje sa ishin në SNS (dhjetor 2021), 18.526 ose 72% e familjeve ishin në kategorinë I, ndërsa 7.369 familje ose 28% ishin në kategorinë II. Shih tabelën dhe figurën më poshtë:

Tabela 18: Bartësit e ndihmës sociale sipas kategorive dhe strukturës gjinore, dhjetor 2021

TOTAL			Kategoria I			Kategoria II		
Burra	Gra	Total	Burra	Gra	Total	Burra	Gra	Total
16.962	8.933	25,895	10.247	8.279	18.526	6.715	654	7.369
65.45%	34.55%	100.00%	55.21%	44.79%	100.00%	91.12%	8.88%	100.00%

Figura 39: Përqindja e familjeve në SNS sipas kategorive, dhjetor 2021



Në muajin dhjetor 2021, numri i familjeve në kategorinë I ka shënuar rritje për 1.631 familje më shumë apo plus 10% në krahasim me muajin e njëjtë të vitit paraprak, ndërsa numri i familjeve në kategorinë II ka shënuar rënie për 1.415 familje më pak apo minus 16%, në krahasim me muajin e njëjtë të vitit paraprak.

5.7.5. Statusi i bartësve të ndihmës sociale

Bazuar në kriterin-statusin bazë të bartësit të ndihmës sociale, numrin dhe përqindjen më të lartë e përbëjnë bartësit me kriterin 7- person mbi 18 vjeç, i paaftë për punë mbi 80%, me 7.400 apo mbi 28%, pastaj kriteri 8 - i papunësuar, me gjithsej 7.7.016 apo 28%; bartësit me kriterin 9-kujdestar, me 6.598 apo me 25%; bartësit me kriterin 6-prind vetushqyes, me 2.372 apo 9%, e kështu me radhë. Ndërsa numrin më të vogël e përbëjnë bartësit me kriterin 5-person i moshës 15-18 vjeç, në shkollim të rregullt dhe me kriterin 14-person me pension nga Skema për të Verbër, me nga 1 bartës apo me 0.01%. Shih tabelën më poshtë:

Tabela 19: Bartësit e ndihmës sociale sipas statusit, dhjetor 2021

Statusi	Burra	Gra	Totali	%
5-Person i moshës 15 - 18 vjeç, në shkollim të rregullt	1	1	2	0.01
6-Prind vetushqyes	451	1.921	2.372	9.16
7-Person mbi 18 vjeç, i pa aftë për punë mbi 80%	5.098	2.302	7.400	28.58
8-I papunësuar	6.696	320	7.016	27.09
9-Kujdestar	3.638	2.960	6.598	25.48
10 -Person me Pension të Aftësisë së Kufizuar (PPAK)	172	35	207	0.80
14 -Person me Pension nga Skema për të Verbër	1	1	2	0.01
15 -Person me Pension Bazë (PB)	91	20	111	0.43
18 -Kujdestar-Person me Pension të Aftësisë së Kufizuar (PPAK)	13	0	13	0.05
19 - Kujdestar - Person me Pension Bazë (PB)	7	3	10	0.04
21 - Person i vetëm - Person mbi 18 vjeç, i pa aftë për punë mbi 80%	794	1.370	2.164	8.36
Totali	16.962	8.933	25.895	100.00

5.7.6. Familjet në Skemën e Ndhmës Sociale sipas etnitetit

Kosova është e angazhuar për krijimin e një shteti të qytetarëve të barabartë, i cili garanton të drejtat, lirinë qytetare dhe barazinë para ligjit për të gjithë njerëzit që jetojnë në Kosovë. Kushtetuta e Republikës së Kosovës përcakton se *“të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe se askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.”*³¹

Përveç kësaj, për të siguruar barazi të plotë dhe efektive ndërmjet pjesëtarëve të komuniteteve, Kushtetuta inkurajon miratimin e masave adekuate (p.sh. diskriminimin pozitiv) në favor të grupeve të rrezikuara dhe të marxhinalizuara në shoqëri.

Të drejtën për shfrytëzimin e ndihmës sociale në Republikën e Kosovës e kanë të gjithë individët/familjet që jetojnë në varfëri dhe që i plotësojnë kriteret e parapara me legjislacionin në fuqi. Andaj, për të paraqitur etnitetin e familjeve në Skemën e Ndhmës Sociale, po japim të dhënat e muajit dhjetor 2021, të cilat me numër dhe përqindje janë të përafërta edhe me muajt e tjerë të këtij viti. Shih tabelën më poshtë:



³¹ <https://www.mkrs-ks.org/repository/docs/Kushtetuta.e.Republikes.se.Kosoves.pdf>, neni 24, pikat 1 dhe 2 e Kushtetutës së Republikës së Kosovës

Tabela 20: Familjet në SNS sipas etnitetit, dhjetor 2021

Etniteti	Numri i familjeve	%	Numri i anëtarëve	%	Shuma	%
Shqiptar	19.395	72.36%	79.817	77.60%	5,047,396.50	76.11%
Serb	2.858	13.60%	7.192	6.99%	616,314.25	9.29%
Rom	1.028	3.95%	4.606	4.48%	278,953.00	4.21%
Ashkali	1.530	6.01%	7.341	7.14%	429,644.50	6.48%
Egjiptian	435	1.73%	2.109	2.05%	122,621.75	1.85%
Turk	70	0.27%	210	0.20%	15,780.50	0.24%
Boshnjak	243	0.95%	703	0.68%	53,547.00	0.81%
Malazez	2	0.00%	7	0.01%	507.50	0.01%
Kroat	16	0.06%	41	0.04%	3,473.00	0.05%
Goran	212	0.85%	608	0.59%	47,550.50	0.72%
Të tjera-	106	0.22%	270	0.21%	22,527.25	0.24%
TOTAL:	25.895	100.00%	102.904	100.00%	6,638,315.75	100.00%

Sipas tabelës së mësipërme, numrin dhe përqindjen më të madhe të familjeve dhe anëtarëve të familjes, përfituese të ndihmës sociale, e përbëjnë familjet/banorët shqiptarë, me gjithsej 19.395 familje apo 72% dhe me 79.817 anëtarë të familjes apo 78%, pastaj vijnë familjet serbe me 2.858 familje apo 14%.

Pra, familjet joshqiptare në Skemën e Ndihmës Sociale marrin pjesë me 6.394 familje apo me 25% (2.858 apo 11% familje serbe dhe 3.536 apo 14% familje të komuniteteve tjera pakicë në Kosovë). (Shih tabelën 20 dhe figurën 39)


Figura 40: Familjet në SNS sipas etnitetit, dhjetor 2021**Figura 41: Anëtarët e familjes në SNS sipas etnitetit, dhjetor 2021**

Numri i familjeve shqiptare dhe i anëtarëve të familjes, përfituese të ndihmës sociale ka rënë për 144 familje më pak apo minus 1% dhe 1.426 anëtarë më pak apo minus 2% në krahasim me muajin e njëjtë të vitit paraprak. Ndërsa numri i familjeve joshqiptare dhe i anëtarëve të familjes, përfitues të ndihmës sociale,

është rritur për 396 familje më shumë apo plus 5% (188 familje të komunitetit serb dhe 141 të komuniteteve të tjera) dhe 998 anëtarë më shumë apo plus 5% (345 anëtarë të komunitetit serb dhe 653 të komuniteteve të tjera) në krahasim me muajin e njëjtë të vitit paraprak.

Sa i përket shumës së mjeteve të procesuara, shihet se 5,047,396 euro apo 76% e mjeteve të procesuara në muajin dhjetor 2021, kanë shkuar për pagesën e ndihmës sociale për familjet shqiptare dhe 1,568,391.47 euro apo 24% e mjeteve të procesuara, kanë shkuar për pagesën e familjeve joshqiptare (661,314.25 euro apo 9% për familjet e komunitetit serb dhe 952,077.22 euro apo 14.34% për familjet e komuniteteve të tjera). Shih tabelën 20 dhe figurën më poshtë:

Figura 42: Shuma e mjeteve të procesuara sipas komuniteteve, dhjetor 2021



5.7.7. Anëtarët e familjeve në SNS sipas kategorive dhe gjinisë


Në muajin dhjetor 2021, në Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë ishin gjithsej 102.904 anëtarë të familjes, nga të cilët 52.943 apo 51% ishin gra dhe 49.961 apo 49% ishin burra.

Në kategorinë I ishin 67.208 anëtarë të familjes (65% e numrit të përgjithshëm), nga të cilët 34.625 apo 52% ishin femra dhe 32.583 apo 48% ishin meshkuj.

Në kategorinë II ishin 37.291 anëtarë të familjes (35% e numrit të përgjithshëm), nga të cilët 18.318 apo 51% ishin femra dhe 17.378 apo 49% ishin meshkuj. Shih tabelën 21 dhe figurën 42:

Tabela 21: Anëtarët e familjeve në SNS, sipas kategorive dhe strukturës gjinore

Kategoria I dhe II			Kategoria I			Kategoria II		
Burra	Gra	Totali	Burra	Gra	Totali	Burra	Gra	Totali
49,961	52,943	102,904	32,583	34,625	67,208	17,378	18,318	35,696
49%	51%	100%	48%	52%	100%	49%	51%	100%


Figura 43: Numri i anëtarëve të familjes sipas kategorive dhe gjinisë, dhjetor 2021

5.7.8. Anëtarët e familjeve në SNS sipas grup-moshave

Numri më i madh i anëtarëve të familjes në ndihmë sociale i takojnë grup-moshës 19-65 vjeç me 52.019 anëtarë apo mbi 50% dhe numri më i vogël i takojnë grup-moshës mbi 65 vjeç me 1.108 anëtarë apo 1%, ndërsa të grup-moshës 0-18 vjeç janë 49.777 anëtarë apo 48% e totalit të anëtarëve të familjes.

Tabela 22: Numri i anëtarëve të familjes në SNS sipas grup-moshave, dhjetor 2021

Grup-mosha	0-5 vjeç	6-14 vjeç	15-18 vjeç	19-65 vjeç	+65 vjeç	TOTALI
Numri i anëtarëve	14,582	25,734	9,461	52,019	1,108	102,904
%	14.17%	25.01%	9.19%	50.55%	1.08%	100%

Figura 44: Anëtarët e familjes sipas grup-moshave, dhjetor 2021

5.8. Shuma mujore e ndihmës sociale

Shuma mujore e ndihmës sociale për familjet në SNS, përcaktohet sipas numrit të pikëve dhe numrit të anëtarëve të familjes dhe kostos së çmimeve të konsumit të shportës së ushqimit, e cila rregullohet me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministria. Lartësia e vlerës së përfitimeve për familje rregullohet me akt nënligjor, me ç'rast Ministria e Financave në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, nxjerrin vendim për lartësinë e pagesës së shumës mujore për familje. Shuma mujore e ndihmës sociale harmonizohet me indeksin e çmimeve të konsumit të shportës së ushqimit, të publikuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës.³²

Shuma mujore e ndihmës sociale për një familje përcaktohet sipas numrit të pikëve, numrit të anëtarëve të familjes dhe kostos së çmimeve të konsumit të shportës së ushqimit, e cila rregullohet me akt nënligjor të cilin e nxjerrë Ministria.³³ Përveç ndihmës bazë, "familja e përzgjedhur për Skemën e Ndhmës Sociale për çdo fëmijë të moshës zero (0) e deri në tetëmbëdhjetë (18) vjeç, realizon një përfitim financiar në formën e shtesës për fëmijë, me qëllim të nxitjes së arsimimit dhe përmirësimit të shëndetit³⁴. Kështu që, nga tetori i vitit 2012, përveç shumës bazë të ndihmës sociale, familjet në Skemën e Ndhmës Sociale që kanë fëmijë të moshës 0-18 vjeç, marrin edhe nga 5 euro shtesë në emër të arsimimit dhe mbrojtjes shëndetësore.³⁵ Për më tepër shih tabelën më poshtë:

Tabela 23: Familjet sipas numrit të anëtarëve, pikëve dhe shumës mujore

Familjet sipas numrit të anëtarëve	Numri i pikëve	Shuma në euro
Familjet me 1 anëtar	40	60.00
Familjet me 2 anëtarë	55	82.50
Familjet me 3 anëtarë	60	90.00
Familjet me 4 anëtarë	65	97.50
Familjet me 5 anëtarë	70	105.00
Familjet me 6 anëtarë	75	112.50
Familjet me 7 anëtarë	80	120.00
Familjet me 8 anëtarë	85	127.50
Familjet me 9 anëtarë	90	135.00
Familjet me 10 anëtarë	95	142.50
Familjet me 11 anëtarë	100	150.00
Familjet me 12 anëtarë	105	157.50
Familjet me 13 anëtarë	110	165.00
Familjet me 14 anëtarë	115	172.50
Familjet me 15 anëtarë	120	180.00

³² Ligji Nr.04/L-096 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 2003/15 për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë, Neni 8, paragrafi 9.1 dhe 9.2 dhe Udhëzimi Administrativ, nr.15/2012 për Përlogaritjen e Shumës Mujore të Ndhmës Sociale, neni 11, paragrafët 1-7.

³³ Ligji Nr.04/L-096 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.2003/15 për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë, neni 9, dhe Udhëzimi Administrativ, Nr.15/2012 për Përlogaritjen e Shumës Mujore të Ndhmës Sociale, neni 8, paragrafi 9.1.

³⁴ Po aty, neni 12, paragrafët 1-4.

³⁵ Vendimi i Ministrit të MPMS-së, nr.453, dt. 17.12.2012.

5.8.1. Mesatarja ditore dhe mujore e ndihmës sociale sipas anëtarëve të familjes

Bazuar në Anketën e Buxhetit të Ekonomive Familjare (ABEF), e vitit 2017, është vlerësuar se 18% e popullsisë së Kosovës jeton nën kufirin e varfërisë me më pak se 1.85 euro në ditë për një person të rritur dhe 5.1% e popullsisë jeton nën kufirin e varfërisë së skajshme me më pak se 1.35 euro në ditë.³⁶ Bazuar në tabelën më poshtë del që shuma mujore e ndihmës sociale, pa llogaritur mjetet shtesë që familjet kanë përfituar gjatë vitit 2021, për shumicën e familjeve/anëtarëve në SNS është më pak se 1.85 euro në ditë. Shih tabelën më poshtë:

Tabela 24: Rritja e ndihmës sociale nga viti 2003, shuma dhe mesatarja e NS-së për anëtarë të familjes

Familjet sipas numrit të anëtarëve të familjes	Rritja e ndihmës sociale					Mesatarja e ndihmës sociale		
	Shuma mujore e ndihmës sociale në € në vitin 2003	Shuma mujore ndihmës sociale në € pas rritjes nga 5 € për çdo familje 2009	Shuma e ndihmës sociale në €, pas ndryshimeve të Ligjit të SNS (qershor 2012)	Shuma mujore e ndihmës sociale, në €, pas rritjes prej 25% nga dt. 01.11.2015	Shuma mujore e ndihmës sociale, në €, pas rritjes prej 20% nga dt. 01.01.2018	Familjet në SNS sipas nr. të anëtarëve të familjes (dhjetor 2021)	Mesatarja mujore e ndihmës sociale për anëtarë të familjes (dhjetor 2021)	Mesatarja ditore e ndihmës sociale, për anëtarë të familjes (dhjetor 2021)
Familje 1 anëtar	35	40	40	50	60	2,203	60 €	2.00 €
Familje 2 anëtarë	50	55	55	68.75	82.5	3,659	41.25 €	1.38 €
Familje 3 anëtarë	55	60	60	75	90	4,150	30 €	1.00 €
Familje 4 anëtarë	60	65	65	81.25	97.5	6,003	24.38 €	0.81 €
Familje 5 anëtarë	65	70	70	87.5	105	5,208	21 €	0.70 €
Familje 6 anëtarë	70	75	75	93.75	112.5	2,936	18.75 €	0.63 €
Familje 7 anëtarë	75	80	80	100	120	1,081	17.14 €	0.57 €
Familje 8 anëtarë	75	80	85	106.25	127.5	419	15.94 €	0.53 €
Familje 9 anëtarë	75	80	90	112.5	135	160	15.00 €	0.50 €
Familje 10 anëtarë	75	80	95	118.75	142.5	52	14.25 €	0.48 €
Familje 11 anëtarë	75	80	100	125	150	15	13.64 €	0.45 €
Familje 12 anëtarë	75	80	105	131.25	157.5	4	13.13 €	0.44 €
Familje 13 anëtarë	75	80	110	137.5	165	5	12.69 €	0.42 €
Familje 14 anëtarë	75	80	115	143.75	172.5	0	12.32 €	0.41 €
Familje 15 anëtarë	75	80	120	150	180	0	12 €	0.40 €
Mesatarja	67.33 €	72.33 €	84.33 €	105.41 €	126.5 €	25.895	21.43 €	0.71

5.9. Komisioni Mjekësor i shkallës së I

Të drejtën në ndihmë sociale në kategorinë e parë e realizon familja, në të cilën të gjithë anëtarët e familjes janë të varur sipas përkufizimit të dhënë në nenin 2, pika 2.7 të Ligjit në fuqi, dhe asnjëri prej tyre nuk është i punësuar.³⁷

Një person do të konsiderohet se është me të meta të rënda dhe aftësi të kufizuara të përhershme, nëse është: mbi moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç dhe nën moshën 65 vjeç; me aftësi të kufizuara fizike apo mendore; dhe është i paaftë për punë shpërblyese. Aftësia përherë e kufizuar dhe e meta e rëndë fizike

³⁶ “Varfëria në konsum në Republikën e Kosovës”, Raport i përbashkët i BB-së dhe ASK-së, maj 2019, f. 5; shih: <https://ask.rks-gov.net/media/4882/statistikat-e-varf%C3%ABris%C3%AB-2012-2017.pdf>

³⁷ Ligji Nr. 2003/15 për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë, neni 2.7 dhe Ligji Nr. 04/L-096 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 2003/15 për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë, neni 4.4.

dhe mendore, përkufizohet si aftësia përherë e kufizuar fizike dhe mendore në shkallë jo më pak se 80%, siç është aftësia e kufizuar që e bën personin të paaftë për punë në kohën kur ai paraqet kërkesën dhe për një periudhë vijuese, prej jo më pak se një viti.³⁸

Familjet me një apo më shumë anëtarë të paaftë për punë, që paraqesin kërkesë për ndihmë sociale për kategorinë e parë, gjenden shëndetësore të këtyre anëtarëve e ekzaminon dhe vlerëson Komisioni Mjekësor i Ministrisë. Procedurat e punës, kriteret dhe metodologjia për vlerësim dhe rishikim të nivelit dhe llojit të paaftësisë nga ana e Komisionit Mjekësor, përcaktohet me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministria.³⁹

Komisioni Mjekësor - nënkupton një grup ekspertësh mjekësorë, i formuar dhe i miratuar nga Ministria përkatëse e Punës dhe Mirëqenies Sociale, me qëllim të ekzaminimit dhe përcaktimit të gjendjes shëndetësore, duke përcaktuar shkallën e paaftësisë të çdo personi apo anëtari të familjes, i cili është i përfshirë në realizimin e të drejtave të përcaktuara sipas Ligjit nr. 04/L-096.⁴⁰

Komisionet Mjekësore të Shkallës së Parë dhe të Dytë, janë themeluar dhe funksionojnë në kuadër të Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë Skemën e Ndhmës Sociale.

5.10. Procesi dhe procedurat e ankimimit për ndihmë sociale

Kërkuesi i ndihmës sociale që është i pakënaqur me aktvendimin zyrtar të organit përkatës, mund të parashtrijë kërkesë me shkrim tek Udhëheqësi i Skemës së Ndhmës Sociale për rishqyrtim të aktvendimit. Kërkesa për rishqyrtim bëhet jo më vonë se pesë (5) ditë nga data e marrjes së aktvendimit. Ajo nuk e humb të drejtën për ankesë në shkallën e dytë në Komisionin për Ankesa në Departamentin përkatës të Ministrisë, ndërsa Udhëheqësi i Skemës së Ndhmës Sociale në afatin prej dhjetë (10) ditësh e shqyrton kërkesën për rishqyrtim, apo atë e bartë tek organi më i lartë, i cili vendos në lidhje me ankimimin.⁴¹

5.10.1. Komisioni i Ankesave i shkallës së II

Kërkuesi i ndihmës sociale që është i pakënaqur me aktvendimin zyrtar të organit përkatës, mund të parashtrijë kërkesë me shkrim tek Udhëheqësi i Skemës së Ndhmës Sociale për rishqyrtim të aktvendimit. Kërkesa për rishqyrtim bëhet jo më vonë se pesë (5) ditë nga data e marrjes së aktvendimit. Ajo nuk e humb të drejtën për ankesë në shkallën e dytë në Komisionin për Ankesa në Departamentin përkatës të Ministrisë, ndërsa Udhëheqësi i Skemës së Ndhmës Sociale në afatin prej dhjetë (10) ditësh e shqyrton kërkesën për rishqyrtim, apo atë e bartë tek organi më i lartë, i cili vendos në lidhje me ankimimin.⁴²

³⁸ Ligji Nr. 2003/15 për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë, neni 2.9.

³⁹ Ligji Nr.04/L-096 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 2003/15 për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë, neni 6, paragrafi 6.2.

⁴⁰ Po aty, neni 2, paragrafi 4.

⁴¹ Ligji Nr.04/L-096 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.2003/15 për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë, neni 10, paragrafi 11.1.

⁴² Po aty, neni 10, paragrafi 11.1.

Ankesat dorëzohen jo më vonë së pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e marrjes së aktvendimit nga organi përkatës i QPS-së. Komisioni i Ankesave duhet ta shqyrtojë ankesën dhe ta njoftojë me shkrim parashtruesin e ankesës për aktvendimin e pranuar jo më vonë se njëzetënjë (21) ditë, pas marrjes së ankesës.⁴³


Komisioni i Ankesave i shkallës së II, që vepron në kuadër të DNS/DPSF-së, bën interpretime, sqarime dhe komente profesionale të akteve ligjore dhe nënligjore që rregullojnë lëmin e ndihmës sociale, shqyrton ankesat e palëve të pakënaqura me vendimet e shkallës së parë, pra QPS-ve. Komisioni i Ankesave, si organ i shkallës së dytë, nxjerr vendime bazuar në nenin 11, paragrafët 11.1, 11.2 dhe 11.3 të Ligjit bazë të Skemës së Ndhmës Sociale dhe nenit 10 të Ligjit Nr.04/L-096 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.2003/15 për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë dhe akteve të tjera nënligjore. Komisioni i përgjigjet direkt Drejtorit të DPSF-së.

Komisioni i Ankesave për Ndhma Sociale i shkallës së II, gjatë periudhës raportuese ka shqyrtuar 241 ankesa të paraqitura nga palët e pakënaqura me vendimin e shkallës së parë. Nga ky total, 86 ankesa apo 11% janë aprovuar, 200 ankesa apo 83% janë refuzuar dhe 15 ankesa apo 6% janë kthyer në riprocedurë. Shih tabelën 21 dhe figurën 39:

Tabela 25: Numri i ankesave, vlerësimeve në shkallën II dhe kontestet administrative, 2021

Muaji	Ankesat e Shk. II				Komisioni Mjekësor II			Konteste administr.-Gjykata Themelore				
Janar	17	4	13	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Shkurt	18	2	16	0	27	21	6	4	2	0	0	2
Mars	23	4	19	0	39	12	27	0	0	0	0	0
Prill	22	5	17	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Maj	24	5	19	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Qershor	5	1	4	0	0	0	0	4	2	0	0	2
Korrik	10	4	6	0	79	5	74	0	0	0	0	0
Gusht	29	0	27	2	25	1	24	0	0	0	0	0
Shtator	27	1	24	2	26	4	22	10	5	2	2	1
Tetor	34	0	25	9	19	3	16	12	6	0	2	4
Nëntor	10	0	9	1	17	3	14	4	2	0	1	1
Dhjetor	22	0	21	1	32	4	28	2	1	0	1	0
Totali	241	26	200	15	264	53	211	36	18	2	6	10

⁴³ Po aty, neni 10, paragrafi 11.2.


Figura 45: Numri i ankesave të shqyrtuara nga Komisioni i Ankesave i Shkallës II, 2021

Në vitin 2021, numri i ankesave ka rënë për 57 ankesa apo 19% më pak në krahasim me vitin 2020.

5.10.2. Komisioni Mjekësor i shkallës së II

Komisioni i shkallës së II, vepron në kuadër të Minsitrisë dhe bën rivlerësimin e paaftësisë për punë (jo më pak se 80% i paaftë për punë) të anëtarit/anëtarëve të familjes, të cilët kanë aplikuar për ndihmë sociale.

Gjatë vitit 2021, ky Komision ka rivlerësuar 264 ankesa, 53 ankesa apo 20% janë aprovuar dhe 211 ankesa apo 80% janë refuzuar. Shih tabelën 25 dhe figurën 45:

Figura 46: Numri i ankesave të shqyrtuara nga Komisioni Mjekësor i Shkallës II, 2021


Në vitin 2021, janë rivlerësuar 85 ankesa apo 47% më shumë në krahasim me vitin 2020.

5.10.3. Kontestet administrative

Pala e pakënaqur me aktvendimin e Komisionit për Ankesa të Shkallës II, ka të drejtë të parashtrijë padi në afatin prej tridhjetë (30) ditësh për iniciimin e kontestit administrativ në Gjykatën kompetente, nga dita e marrjes së aktvendimit.⁴⁴

Komisioni Ankesave i Shkallës së II, ka proceduar për në Gjykatën Themelore 10 konteste administrative, të cilat janë në fazën e shqyrtimit. Shih tabelën 25 dhe figurën 46:

Figura 47: Kontestet administrative të proceduara në Gjykatën Themelore, 2021



Gjatë vitit 2021, numri i kontesteve administrative është i njëjtë më numrin e kontesteve administrative të vitit paraprak.

5.11. Ndhimat e njehershme-emergjente

Bazuar në nenin 12, paragrafët 12.1 dhe 12.2 të Ligjit nr. 04/L -096 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 2003/15 për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë, dhe nenit 4 të Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr. 12/2013 për Përcaktimin e Procedurave për Pagesat e Ndhimave të Njehershme Sociale, thuhet: Ndhmë e njehershme sociale konsiderohet ndihma që ofrohet për individë apo familje për një nevojë momentale, të jashtëzakonshme, por jo edhe të vazhdueshme, siç janë: shpenzimet e varrimit të anëtarëve të familjes, dëmet dhe shkatërrimet e ekonomisë familjare të shkaktuar nga fatkeqësitë elementare (zjarri, tërmeti dhe vërshimi) për humbje të dokumentacionit bashkë me paratë e fundit, dhe nevoja të tjera të jashtëzakonshme.⁴⁵

⁴⁴ Ligji Nr.04/L-096 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.2003/15 për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë, Neni 10, paragrafi 11.3.

⁴⁵ Udhëzimi Administrativ (MPMS) Nr. 12/2013 për Përcaktimin e Procedurave për Pagesat e Ndhimave të Njehershme Sociale;

Të drejtë aplikimi për përfitim të ndihmës së njëhershme kanë të gjitha familjet apo individët, pavarësisht se a janë apo nuk janë shfrytëzues të Skemës së Ndhmës Sociale, që i plotësojnë kriteret e parapara me nenin 12 të Ligjit nr. 04/L -096 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 2003/15 për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë.⁴⁶

Kushtet, kriteret dhe procedurat e tjera për realizimin e kësaj mbështetjeje financiare janë të rregulluara me Udhëzimin Administrativ (MPMS) Nr. 12/2013 për Përcaktimin e Procedurave për Pagesat e Ndhmave të Njëhershme Sociale, nga neni 4-15.


Gjatë periudhës janar-dhjetor 2021, Komisioni Vlerësues për ndihma të njëhershme sociale ka shqyrtuar 104 kërkesa për ndihmë të njëhershme sociale. Mbështetje financiare me nga 100 euro kanë përfiturar 67 individë/familje apo 64% nga totali i kërkesave të shqyrtuara, me gjithsej 6,700 euro, me nga 150 euro deri në 300 euro kanë përfiturar 19 familje/individë apo 18%, me gjithsej 4,100 euro, ndërsa janë refuzuar 18 kërkesa apo 17% pasi që nuk i kanë plotësuar kriteret e parapara me legjislacionin e cekur më lartë. Buxheti i shpenzuar për ndihma të njëhershme sociale gjatë periudhës janar-dhjetor 2021 është 10,800 euro. Shih tabelën 26:

Tabela 26: Ndhimat e njëhershme/emergjente dhe buxheti i shpenzuar, 2021

Muaji	Numri i kërkesave	Aprovim 100 euro	Aprovim 150-300 euro	Refuzim	Shuma 100 euro	Shuma 150-300 euro	Totali
Janar	1	1	0	0	100.00 €	0.00 €	100.00 €
Shkurt	12	5	7	0	500.00 €	1,400.00 €	1,900.00 €
Mars	15	9	2	4	900.00 €	600.00 €	1,500.00 €
Prill	10	8	0	2	800.00 €	0.00 €	800.00 €
Maj	8	8	0	0	800.00 €	0.00 €	800.00 €
Qershor	7	5	0	2	500.00 €	0.00 €	500.00 €
Korrik	19	10	8	1	1,000.00 €	1,700.00 €	2,700.00 €
Gusht	8	4	0	4	400.00 €	0.00 €	400.00 €
Shtator	12	7	1	4	700.00 €	200.00 €	900.00 €
Tetor	0	0	0	0	0.00	0.00	0.00
Nëntor	12	10	1	1	1,000.00 €	200.00 €	1,200.00 €
Dhjetor	0	0	0	0	0.00	0.00	0.00
TOTALI:	104	67	19	18	6,700.00 €	4,100.00 €	10,800.00 €

Në vitin 2021 numri i kërkesave për ndihmë të njëhershme, ka rënë për 35 kërkesa apo 25% më pak në krahasim me vitin 2020. Shih figurën 49:

⁴⁶ Po aty, neni 5.


Figura 48: Numri i kërkesave për ndihmë të njehershme, 2021/2020

Në vitin 2021, buxheti i shpenzuar për ndihma të njehershme ka rënë për 3,100 euro apo 22% më pak në krahasim me vitin 2020.

5.12. Pëlqimet për autorizim për tërheqjen e ndihmës sociale

Gjatë vitit 2021, janë shqyrtuar dhe aprovuar 112 kërkesa për lëshimin e pëlqimeve për autorizime për tërheqjen e ndihmës sociale për bartësit e ndihmës sociale që për shkaqe të ndryshme, si: sëmundje, vuajtje të dënimeve, zhvendosjes-emigrimit dhe vdekjes, nuk kanë qenë në gjendje që të tërheqin ndihmën sociale⁴⁷. Shih figurën më poshtë:

Figura 49: Kërkesat për pëlqim/autorizim sipas QPS-ve, 2021



Në vitin 2021, janë shqyrtuar 21 kërkesa apo 23% më shumë, në krahasim me vitin 2020.

⁴⁷ Shih nenin 9, paragrafit 1, të Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2012 për Përlllogaritjen e Shumës Mujore të Ndihmës Sociale


5.13. Procedimi, shpërndarja, kthimi i mjeteve dhe provizioni bankar

Gjatë vitit 2021, për pagesën e SNS-së janë procesuar 53,637.481.25 euro, nga ky total janë shpërndarë 53,488,863 euro, apo 99.77% e mjeteve të procesuara, ndërsa janë kthyer/nuk janë shpërndarë 148,618.25 euro, apo 0.28% e mjeteve të procesuara. Ndërsa në emër të provizionit bankar janë paguar 463,278.60 euro. Shih tabelën 27 dhe figurën 44:

Tabela 27: Procedimi, kthimi i mjeteve dhe provizioni bankar, sipas muajve

MUAJ	SHUMA E PROCESUAR	MJETET E KTHYERA	PROVIZIONI BANKAR
JANAR	5,404,017.50 €	12,965.00 €	38,541.00 €
SHKURT	5,482,312.50 €	12,615.00 €	39,079.50 €
MARS	5,510,620.00 €	15,912.50 €	39,315.00 €
PRILL	3,482,552.00 €	10,537.00 €	38,920.50 €
MAJ	3,464,168.00 €	11,478.00 €	38,737.50 €
QERSHOR	3,449,918.00 €	11,480.00 €	38,560.50 €
KORRIK	3,424,733.00 €	10,100.75 €	38,445.00 €
GUSHT	3,399,920.75 €	9,548.25 €	38,185.50 €
SHTATOR	3,400,056.50 €	9,218.00 €	38,155.50 €
TETOR	3,402,027.00 €	6,952.25 €	38,239.50 €
NENTOR	6,578,840.25 €	21,227.00 €	38,373.00 €
DHJETOR	6,638,315.75 €	16,584.50 €	38,726.10 €
TOTALI:	53,637,481.25 €	148,618.25 €	463,278.60 €

Figura 50: Shuma e mjeteve të procesuara, të shpërndara dhe të kthyerja janar-dhjetor 2021



Gjatë vitit 2021, shuma totale e mjeteve të procesuara është 53,648,281.25 euro (në këtë total janë përfshirë edhe mjetet e procesuara për pagesën e ndihmave të njëhershme në shumë prej 10,800 euro).

Në vitin 2021, buxheti i shpenzuar për pagësen e ndihmës sociale është rritur për 6,626,339.25 euro apo 14% më shumë, në krahasim me vitin paraprak.

5.14. Subvencionimi i energjisë elektrike

Që nga viti 2005, Qeveria e Republikës së Kosovës për çdo vit ndan nga 4.5 milion euro për subvencionimin e një sasive të energjisë së shpenzuar elektrike për individët/familjet përfituese të Skemës së Ndhmës Sociale dhe të Skemës së Familjeve të Dëshmorëve, Invalidëve të Luftës dhe Viktimave Civile të Luftës (FDILVC). Ndërsa nga viti 2017 këtë subvencionim e përfitojnë edhe individët/familjet përfituese të Skemës për Personat e Verbër (PV) dhe të Skemës për Personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik (PPT).


Subvencionimi i energjisë elektrike bëhet me Marrëveshje Bashkëpunimi të lidhur në mes Ministrisë, KEDS-it dhe KESCO-s, bazuar në legjislacionin në fuqi që rregullon skemat e cekura më lartë.⁴⁸

Gjatë vitit 2021 janë subvencionuar 38,307 individë/familje në shumë prej 4,491,738.05 euro.⁴⁹ Mesatarja e subvencionimit për individët/familjet është 174 KËh apo 117 euro në vit. Ndërsa mesatare e subvencionimit për individ/familje është 10 euro në muaj.

Tabela 28: Subvencionimi i energjisë elektrike për vitin 2021

Skema	Numri i familjeve	Shuma e mjeteve
SNS	24.892	2,851,156.54
FDIL	10.360	1,284,723.59
PV	1.081	125,567.61
PPT	1.974	230,290.31
Totali	38.307	4,491,738.05

Figura 51: Përqindja e familjeve të subvencionuara sipas Skemave, 2021



⁴⁸ Ligjin Nr. 2003/15 për Skemën e Ndhmës Sociale dhe Ligjin Nr. 04/L-096 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 2003/15 për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë; Ligjin Nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të Tyre; Ligjin Nr.04-L-092 për Personat e Verbër; Ligjin Nr. 05/L—67 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik, dhe Ligjin Nr.05/L-085 për Energjinë Elektrike.

⁴⁹ Shih: Vendimin Nr. 20/50, të dt. 23.12.2021, i Qeverisë së Republikës së Kosovës, Vendimin Nr. 93/2021 të Ministrisë të MFPT dhe Marrëveshjen e Bashkëpunimit Nr.2302/2021, të dt. 28.12.2021 të lidhur në mes MFPT-KESCO për subvencionimin e energjisë elektrike për kategoritë sociale.

Nga totali i familjeve të subvenciuara, 24.892 familje apo 65% janë përfituese të Skemës së Ndhmës Sociale, 10,360 familje apo 27% janë përfituese të Skemës së FDIL-së, 1.974 familje apo 5% janë përfituese të Skemës për PPT-në dhe 1.081 familje apo 3% janë përfituese të Skemës për PV. Shih Talenë dhe figurën lartë.

5.15. Baza e të Dhënave (TI) për Skemën e Ndhmës Sociale

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) përveç që i përcakton rregullat dhe procedurat për Skemën e Ndhmës Sociale (SNS), gjithashtu zhvillon dhe mirëmban sistemin e Teknologjisë Informative (TI) e SNS-së.

Sistemi i TI-së i SNS-së ka objektivin e dyfishtë të informimit, të hartimit të politikave dhe mbështetjes së zbatimit të metodës së shenjestrimit të SNS-së. Sistemi i menaxhimit dhe i informimit të SNS-së (*baza e të dhënave ose regjistri*), është i dizajnuar në qendër dhe mirëmbahet nga MFPT-ja. Funkcionet e tij themelore përfshijnë *mbështetjen e zbatimit të mekanizmit të shenjestrimit të TMT-së të SNS-së, gjenerimin e të dhënave për zhvillimin e politikave, monitorimin dhe vlerësimin*. Sistemi i TI-së i SNS-së është dizajnuar në mënyrë të tillë që të shkëmbejë të dhëna me çdo lloj sistemi, me çdo lloj ndërfaqeje, nëse kanë një identifikues të përbashkët personal.

Sistemi i TI-së i SNS-së është i lidhur dhe shkëmben të dhëna me ATK-në dhe ARC-në, dhe me shumicën e skemave të cilat menaxhohen nga MFPT-ja. Përmes sistemit të TI-së, kontrollohen/krahasohen në mënyrë elektronike (përmes sistemit të bazuar në ueb), të dhënat e përfituesve të SNS-së me të dhënat e përfituesve të Skemave Pensionale që menaxhohen nga MFPT-ja,⁵⁰ me të dhënat e ATK-së dhe ARC-së, me qëllim të parandalimit të përfitimit të ndihmës sociale nga ana e individëve apo familjeve në mënyrë të paligjshme.

Shkëmbimi apo krahasimi i të dhënave bëhet çdo muaj dhe realizohet bazuar në Marrëveshjet e Bashkëpunimit të lidhura në mes të MFPT-së dhe institucioneve të cekura më lartë.

5.16. Krahasimi i të dhënave me Administratën Tatimore të Kosovës


Edhe gjatë vitit 2021, ka vazhduar të bëhet krahasimi i të dhënave të Bazës së SNS-së me të dhënat e Administratës Tatimore të Kosovës. Krahasimi është kryer për çdo muaj, pas grumbullimit të të dhënave në Bazë nga të gjitha QPS-të. Nga ky krahasim, gjatë periudhës janar-dhjetor 2021 janë identifikuar gjithsej 1.633 raste/familje, që kanë të hyra mujore dhe nuk i plotësojnë kriteret për përfitimin e ndihmës sociale.

⁵⁰ Këto skema janë: 1. Pensioni bazik i moshës, 2. Pensioni kontributpagues i moshës, 3. Pensioni për personat me aftësi të kufizuar (mosha 18-64 vjeç), 4. Pensioni familjar, 5. Pensioni invalidor i punës, 6. Pensionet e TMK-së, 7. Pensionet e FSK-së, 8. Pensionet e Minorëve të Trepçës; 9. Pensioni për personat e Verbër, 10. Pensioni për Personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik, 11. Pensionet për kategoritë e luftës (Familjet e Dëshmorëve, Invalidëve të Luftës, Viktimave Civile dhe Veteranët), 12. Skema për Përkrahje Materiale të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara të Përhershme (0-18 vjeç), 13) Strehimi Familjar (brenda familjes dhe jashtë familjes),

Ndaj këtyre familjeve QPS-të përkatëse kanë inicuar procedurë për kthimin e mjeteve të përfituar pa bazë ligjore, bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore që e rregullojnë fushën e SNS-së. Deri në fund të vitit 2021, 662 familje në llogarinë e Thesarit kanë kthyer mjetet e përfitura pa bazë ligjore në vlerë prej 100,440.71 euro. Ndërsa, për 144 familje që nuk i kanë kthyer mjetet e shfrytëzuara pa bazë ligjore, QPS-të përkatëse përmes DPSF/DNS kanë iniciuar padi gjyqësore.

Numri i familjeve të evidentuara si të pa përzgjedhshme për të përfituar ndihmën sociale pas krahasimit me të dhënat e ATK-së, sipas muajve, është paraqitur në tabelën më poshtë:

Figura 52: Familjet e papërzgjedhshme për ndihmë sociale pas krahasimit me ATK-në, 2021



5.17. Njësia e Kontrollit dhe Mbikëqyrjes për Skemën e Ndhmës Sociale

Njësia e Kontrollit dhe Mbikëqyrjes (NJKM), vepron në kuadër të DNS/DPSF-së dhe është përgjegjëse për të kontrolluar dhe mbikëqyrur në mënyrë sistematike funksionimin dhe zbatimin e legjislacionit në fuqi të SNS-së, punën e QPS-ve, si institucione të cilave iu është deleguar e drejta për të administruar me SNS-në, si zbatohet Ligji Nr. 2003/15 për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë, Ligji Nr. 04/L-096 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.2003/15 për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë dhe aktet e tjera nënligjore që rregullojnë Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë.

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2021, zyrtarët e kësaj Njësie janë angazhuar në kryerjen e aktiviteteve/punëve të ndryshme, si në mbajtjen e evidencës për çdo muaj për familjet përfituese të ndihmës sociale të evidentuara si të papërzgjedhshme për ndihmë sociale (me të hyra mujore më shumë se sa shuma që parashihet për përfitimin e ndihmës sociale), pas krahasimit të Bazës së SNS-s; me të dhënat e ATK-së dhe të skemave të tjera pensionale, siç parashihet me legjislacionin në fuqi.

5.18. MASA 3 e Pakos së Ringjalljes Ekonomike

Gjendja e krijuar nga COVID-19 ndikoi negativisht në shëndetin dhe në mirëqenien e të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës, e veçmas të individëve/familjeve me kushte të vështira ekonomike, të moshuarve, personave me aftësi të kufizuara, të rinjve, etj. Me qëllim që grupeve të tilla t’iu kushtohet vëmendje dhe mbështetje maksimale për përballimin dhe tejkalimin e kësaj gjendjeje, Qeveria e Republikës së Kosovës, në qershor të 2021-ës, publikoi Pakon e Ringjalljes Ekonomike, në të cilin bën pjesë edhe Masa e 3-të, e quajtur “Mbështetje për Familjen”, me qëllim që të krijohet një shoqëri e barabartë dhe të ngritët mirëqenia e qytetarëve, sidomos të shtresave të cenueshme të shoqërisë. Pra, me këtë Masë synohet që sadopak t’iu lehtësohet barra që kanë pasur këto shtresa si pasojë e pandemisë. Për implementimin e Masës 3 janë paraparë 6 Nënmasa, ku për 3 prej tyre është mandatuar DPSF-ja që të menaxhojë realizimin e tyre.

5.18.1. Mbështetja për familjet që kanë humbur kryefamiljarin, (Nënmasa 3.1)

Me këtë Nënmasë janë mbështetur me një shumë monetare të gjitha familjet që kanë humbur kryefamiljarin e tyre nga COVID-19. Masa ka filluar të zbatohet në tremujorin e fundit të vitit 2021, bazuar në Vendimin Nr. 58/2021 të datës 28.09.2021, të nxjerrë nga Ministri i MFPT-së.⁵¹

Sipas këtij vendimi të drejtën e përfitimit nga kjo masë e kanë personat që kanë humbur familjarin si pasojë e COVID-19, ndërsa personat që humbin familjarin nga infektimi më COVID-19 pas datës 1 tetor 2021, mund të aplikojnë vetëm nëse familjari që ka humbur jetën ka qenë i vaksinuar me dy dozat e vaksinës kundër COVID-19.

Përfitues të kësaj mbështetjeje janë anëtarët e familjes së ngushtë si: bashkëshortja, fëmija dhe prindi.

Vlera e mbështetjes financiare për ata që e kanë humbur familjarin si pasojë e infektimit me COVID-19 është 1,500.00 euro, ndërsa për rastet kur familjari që ka humbur jetën ka qenë i punësuar si personel shëndetësor në sektorin publik dhe përgjatë ushtrimit të detyrës zyrtare në luftimin e pandemisë është infektuar me COVID-19, vlera e mbështetjes është 10,000.00 euro.

Bazuar në statistikat e Divizionit të Ndhimave Sociale, deri në fund të vitit 2021, nga kjo masë kanë përfituruar 2.170 familje dhe shuma e mjeteve të shpenzuara është 3,401.000.00 euro.

5.18.2. Mbështetja për pensionistët dhe familjet me asistencë sociale (Nënmasa 3.2)

Janë paguar shtesat për pensionistë, që asnjë pension të mos jetë nën 100 euro⁵², si dhe janë mbështetur familjet që pranojnë asistencë sociale me 30% mbi nivelin e rregullt. Shtesat do të aplikohen deri në fund të vitit fiskal.⁵³

⁵¹ <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/3999D0EE-EE9A-4026-9271-980BF32E5B8C.pdf>

⁵² Pjesa e kësaj mase është zbatuar nga Departamenti i Pensioneve, që gjithashtu funksionon në kuadër të MFPT-së.

⁵³ <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/D3A6FA8F-6A6A-42AA-A090-52062568DC47.pdf>, faqe 6

Sipas statistikave që posedon DPSF/DNS, familjet me asistencë sociale në tremujorin e parë të vitit 2021 kanë përfituar pagesë të dyfishtë mbi vlerën bazë të ndihmës sociale, ndërsa nga muaji prill 2021 këto familje kanë përfituar rritje me 30% mbi nivelin e rregullt të pagesës dhe kanë vazhduar deri në fund të vitit 2021. Gjithashtu, për familjet në asistencë sociale për muajt nëntor dhe dhjetor 2021, është zbatuar dyfishimi i pagesës mbi vlerën bazë të ndihmës sociale.

Pra, nga Nënmasa 3.2 kanë përfituar mesatarisht çdo muaj rreth 25.280 familje në asistencë sociale, me rreth 103,012 anëtarë dhe shuma e buxhetit të shpenzuar për realizimin e kësaj mase, për familjet në asistencë sociale, është mbi 12 milion e 900 mijë euro. Shih tabelën më poshtë:

Tabela 29: Pagesa e familjeve në asistencë sociale sipas Nënmasës 3.2

Muaji	Numri i familjeve	Numri i anëtarëve të familjes	Shuma e mjeteve			Totali
			Pagesë e rregullt	Pagesë e dyfishtë	Rritja 30%	
Janar	25,768	103,303	2,702,008.75	2,702,008.75		5,404,017.50
Shkurt	26,120	104,780	2,741,156.25	2,741,156.25		5,482,312.50
Mars	26,298	105,296	2,755,310.00	2,755,310.00		5,510,620.00
Prill	26,033	104,116	2,737,801.00		744,751.00	3,482,552.00
Maj	25,921	103,512	2,721,706.85		743,737.50	3,465,444.35
Qershor	25,805	102,958	2,710,589.00		739,329.00	3,449,918.00
Korrik	25,714	102,371	2,690,360.00		734,373.00	3,424,733.00
Gusht	25,538	101,681	2,670,947.00		728,973.75	3,399,920.75
Shtator	25,514	101,621	2,671,043.46		729,013.04	3,400,056.50
Tetor	25,549	101,588	2,672,533.85		729,493.15	3,402,027.00
Nëntor	25,681	102,019	2,683,723.85	3,162,656.25	732,460.15	6,578,840.25
Dhjetor	25,895	102,904	2,708,891.83	3,200,000.00	750,000.00	6,658,891.83
Totali			32,466,071.84	14,561,131.25	6,632,130.59	53,659,333.68

5.18.3. Pagesat për lehonat e papunësuar dhe të punësuar (Nënmasa 3.5)

Në kuadër të kësaj mase/skeme, përfitojnë të gjitha lehonat të cilat figurojnë si të papuna në Administratën Tatimore të Kosovës, në dymbëdhjetë (12) muajt e fundit para ditës së lindjes së foshnjës. Vlera e mbështetjes financiare është 170 euro dhe zgjat për 6 muaj, ndërsa lehonat e punësuar do të përfitojnë mbështetje financiare në shumë prej 170 euro për 3 muaj, krahas kompensimit të rregullt të pushimit të lehonisë.

Gjatë vitit 2021 nga kjo Nënmasë kanë përfituar 20.376 lehona. Buxheti i shpenzuar 3,333,700.00 euro.⁵⁴

5.18.4. Shtesat për fëmijë (Nënmasa 3.5)

Me Nënmasën 3.5 është paraparë edhe mbështetja financiare e fëmijëve nën moshën 16 vjeç-Shtesat për Fëmijë. Skema e Shtesave për Fëmijë kanë filluar të zbatohen në muajin shtator 2021 bazuar në Vendimin

⁵⁴ Pagesat për lehonat e papuna, gjatë vitit 2021 janë zbatuar nga Agjensioni i Punësimit të Republikës së Kosovës.

Nr. 55, datë 09.09.2021 mbi caktimin e kushteve dhe kriterëve për zbatimin e pjesëshëm të Masës 3.5 - Shtesat për Fëmijë të Pakos së Ringjalljes Ekonomike.⁵⁵

Sipas këtij vendimi, fëmijët e moshës 0-24 muaj do të mbështeten me nga 20 euro në muaj ndërsa fëmijët nën moshën 16 vjeç do të mbështeten me nga 10 euro në muaj. Zbatimi i kësaj Skemë është paraparë të jetë gradual, sipas grupmoshave të cilat janë të përcaktuara me vendimin e cekur më lartë.

Sipas të dhënave të DNS/DPSF, në muajin dhjetor 2021, nga kjo Skemë kanë përfituar 37.708 fëmijë të moshës 0-24 muaj dhe 89.724 fëmijë të moshës nën 16 vjeç. Buxheti i shpenzuar për këtë skemë, për periudhën shtator-dhjetor 2021, është 4,688,820 euro (2,437,180 euro për fëmijët 0-24 muaj dhe 2,251,640 euro për fëmijët nën moshën 16 vjeç). Shih tabelën më poshtë:

Tabela 30: Shtesat për fëmijë sipas muajve, 2021

Muaji	Numri i fëmijëve 0-24 muaj	Shuma	Numri i fëmijëve nën 16 vjeç ⁵⁶	Shuma	Totali
Shtator	16,810	336,200	-	-	336,200.00
Tetor	31,510	630,200	55,768	557,680.00	1,187,880.00
Nëntor	35,831	716,620	79,672	796,720.00	1,513,340.00
Dhjetor	37,708	754,160	89,724	897,240.00	1,651,400.00
Totali		2,437,180.00		2,251,640.00	4,688,820.00

5.19. Mbështetja nga donatorët

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, në bashkëpunim me Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) financuar nga Bashkimi Evropian (BE) - Zyra në Kosovë, si dhe me Organizatën Ndërkombëtare për Migrim (IOM), financuar nga Programi i BE-së për Stabilizimin e Komuniteteve (EU-CSP IV), kanë implementuar programin: Projekti i Ndhmës Humanitare (Humanitarian Assistance Project) dhe Programin e Stabilizimit të Komunitetit (Community Stabilization Program). Familjet përfituese të këtyre dy programeve, janë përkrahur krahas shumëve të rregull të ndihmës sociale. Projekti është realizuar në bashkëpunim të ngushtë në mes të QPS-DPSF-UNDP dhe QPS-DPSF-IOM.

Nga bashkëpunimi me UNDP-në, kuponë për ushqim dhe higjienë, për 6 muaj kanë përfituar rreth 8.000 familje. Vlera e kuponëve ka qenë 60 euro për familjet me 1 deri 4 anëtarë dhe 70 euro për familjet me mbi 4 anëtarë, ndërsa nga bashkëpunimi me IOM-in, kuponë për ushqim dhe higjienë për 6 muaj kanë përfituar 3.000 familje. Vlera e kuponëve ka qenë 70 euro për familje, pa marrë parasysh madhësinë e saj. Nga IOM-i janë përkrahur familjet e komuniteteve jo shumicë në komuna, të cilët janë familje përfituese të ndihmës sociale.

⁵⁵ Shih: <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/173A6369-973C-4189-B158-5E4F9BC13650.pdf>

⁵⁶ Janë të përfshirë fëmijët e lindur deri në janar 2015. Parashihet që të shtohen edhe grupmoshat e tjera deri në moshën 16 vjeç.

Pas finalizimit të shpërndarjes së kuponëve për ushqim dhe higjienë, UNDP-ja ka vazhduar përkrahjen e familjeve përfituese të SNS-së edhe me dy projekte të tjera:

1. Mbulimi i shpenzimeve të ujit për 1 mijë familje për periudhën 6 mujore, në vlerë totale prej 80 euro për një familje, të cilat kanë qenë përfituese të ndihmës sociale gjatë periudhës mars-gusht 2021. Projekti është realizuar në bashkëpunim të ngushtë edhe me Kompanitë Rajonale të Ujësjellësit në Kosovë (KRU), si dhe;
2. Mbulimi i shpenzimeve të ngrohjes përmes lëndës djegëse – dru për 1,000 familje (2.3 metër kub për familje) për të lehtësuar përballjen e tyre me dimrin e ftohtë.

6. DIVIZIONI PËR PLANIFIKIM DHE PËRFSHIRJE SOCIALE

6.1. Detyrat dhe përgjegjësitë

Divizioni për Planifikim dhe Përfshirje Sociale (DPPS), vepron në kuadër të DPSF/MPMS-së.

Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Planifikim dhe Përfshirje Sociale, janë:

- ✓ Koordinon aktivitetet në procesin e planifikimit buxhetor për shërbime dhe përfshirje sociale;
- ✓ Siguron që politikat për mirëqenien sociale të prezantohen në bazë të të dhënave mbi varfërinë në Kosovë dhe që politikat buxhetore për rritjen e mirëqenies sociale të jenë kompatible me mundësitë buxhetore;
- ✓ Propozon, harton dhe siguron zbatimin e dokumenteve të politikave/strategjive për avancimin e shërbimeve të përfshirjes sociale;
- ✓ Raporton mbi efektin e pagesave sociale;
- ✓ Koordinon aktivitetet me Agjencinë e Statistikave të Kosovës (ASK) dhe Ministrinë e Financave (MF), për analizimin e lëvizjes së çmimeve të shportës së ushqimeve për caktimin e nivelit të vlerës së përfitimeve;
- ✓ Ofron mbështetje në procesin e planifikimeve buxhetore për përfshirje sociale në komuna;
- ✓ Identifikon nevojat për financim nga fondet e BE-së dhe donatorët e tjerë të cilët ofrojnë mbështetje për zhvillimin e sektorit të politikave sociale dhe të përfshirjes sociale;
- ✓ Menaxhon procesin e regjistrimit të ofruesve të shërbimeve sociale dhe familjare.

Udhëheqësi i Divizionit për Planifikim dhe Përfshirje Sociale, raporton tek Udhëheqësi i Departamentit për Politika Sociale dhe Familjare.

6.2. Planifikimi dhe shpenzimi i buxhetit për vitin 2021

Procesi i planifikimit të buxhetit dhe bashkëpunimi me donatorë në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare, gjatë vitit 2021, është realizuar në përputhje me objektivat e dala nga Strategjia Sektoriale për Punësim dhe Mirëqenie Sociale 2018-2022.

Gjatë vitit 2021, shërbimet sociale dhe familjare, janë financuar nga dy burime të Buxhetit të Republikës së Kosovës:

1. *Financimet e shërbimeve nga niveli lokal (komunat), si pjesë e përgjegjësive vetanake të komunave, të cilët financohen nga Granti i Përgjithshëm dhe të Hyrat Vetanake të Komunave; dhe*
2. *Financimi i shërbimeve nga niveli qendror, MFPT-ja, si pjesë e financimit të skemave të pagesave sociale dhe kontraktimit apo bashkëfinancimit të projekteve të OJQ-ve me donatorë.*

Financimi i shërbimeve sociale dhe familjare nga niveli qendror edhe për vitin 2021, ka qenë mjaft i rëndësishëm, për ruajtjen e kualitetit të ofrimit të shërbimeve sociale dhe mbështetjen e OJQ-ve të cilat ofrojnë shërbime të ndryshme sociale dhe familjare. Programet të cilat janë mbuluar dhe bashkëfinancuar gjatë vitit 2021 janë:

- Programi i mbështetjes së familjeve të varfra, që është zbatuar përmes Skemës së Ndhmës Sociale;
- Programi i mbështetje së familjeve që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara, që është zbatuar përmes Skemës së Përkrahjes Materiale për Familjet me Fëmijë me Aftësi të Kufizuara 1-18 vjeç;
- Programi i mbrojtjes së fëmijëve pa përkujdesje prindërore dhe të braktisur, që është zbatuar përmes dy formave të strehimit familjar (*strehimi familjar brenda familjes dhe strehimit familjar alternativ/jashtë familjes*);
- Programi i mbështetjes së viktimave të dhunës në familje dhe viktimave të trafikimit me qenie njerëzore, që është zbatuar përmes kontraktimit dhe blerjes së shërbimeve nga OJQ-të, që merren me ofrimin e shërbimeve sociale për këto kategori;
- Programi i ofrimit të shërbimeve rezidenciale për personat e moshuar dhe me aftësi të kufizuara, që është zbatuar përmes ofrimit të shërbimeve 24 orëshe në institucionet rezidenciale;
- Programi i ofrimit të shërbimeve ditore dhe në familje për fëmijë dhe të rritur, që është zbatuar në bashkëfinancim të projekteve të OJQ-ve nga MFPT-ja, donatorët apo komunat.

Buxheti i shpenzuar për mbulimin e kostos së këtyre programeve për vitin 2021, është kryer sipas kodeve buxhetore organizative dhe kategorive të shpenzimeve ekonomike.

6.3. Aktivitetet e kryera gjatë vitit 2021

Gjatë vitit 2021, Divizioni për Planifikim dhe Përfshirje Sociale ka kryer aktivitetet bazuar në Planin e Punës për vitin 2021, aktivitetet kryesore të kryera nga DPPS-ja, janë si më poshtë:

- Raporti Vjetor për vitin 2020, me titull “Mirëqenia Sociale 2020”, i publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë;
- Raport Statistikor, janar 2021 (Numri i përfituesve të Skemës së Ndhmës Sociale sipas komunave, moshës, gjinisë dhe nacionalitetit), i publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë dhe të ASK-së;
- Skemat dhe Programet e Mbrojtjes Sociale (korrik-shtator 2021), i publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë;
- Raport mbi zbatimin e Planit të Brendshëm të DPSF/MFPT (4);

- Raport mbi Zbatimin e Planit Vjetor të Punës së Qeverisë (PVPQ) dhe Planit të Brendshëm të DPSF/MFPT (2);
- Raport për implementimin e Planit të Veprimit të Strategjisë Sektoriale të MPMS-së (2);
- Raport për Qeveri;
- Raport për Zbatimin e Planit të Veprimit të Strategjisë së Komuniteteve RAE (2);
- Raport për Zbatimin e Planit të Veprimit të Strategjisë për të Drejtat e Njeriut;
- Raport për zbatimin e Planit të Veprimit të Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal 2019-2023, për vitin 2021 (2);
- Raport për zbatimin e Masave të Reformës Strukturore të PRE 2021/2024 (2);
- Raport 9-të mujor të PSO-së;
- Raport për gjendjen e krijuar nga Covid-19 dhe masat e MFPT-së (2);
- Raport për Komisionin Parlamentar;
- Raport për “Employment Dimension”;
- Raporte për PKZMSA (2);
- Raport për Takimin e Nën-Komitetit të MSA për Inovacion (2);
- Raport për të arriturat e DPSF/MFPT për vitin 2021;
- Raport për KE-në;
- Raporte Javore (58);
- Raport për lëvizjen FOL, etj.

Gjithashtu në kuadër të DPPS-së janë kryer edhe aktivitete të tjera që bien në domenin e këtij Divizioni.

6.4. Përfshirja sociale

Me përfshirje sociale nënkuptojmë përkrahjen e atyre që ndodhen në vështirësi, si dhe fuqizimin e njerëzve, të cilët vuajnë si pasojë e ndonjë kufizimi natyror apo shoqëror.

Përfshirja sociale është një koncept që synon të krijojë, të ruajë dhe të forcojë proceset ku individët dhe grupet, pavarësisht dallimeve mes tyre, mund të bëjnë një jetë më të mirë, të jenë qytetarë aktiv dhe pjesëmarrës në vendimmarrje, të jenë një shoqëri më e informuar. Pra, përfshirja sociale d.m.th refuzim i prirjeve diskriminuese, të cilësdo formë dhe në cilindo nivel brenda shoqërisë.

Sistemi i mbrojtjes sociale në Republikën e Kosovës bazohet në: *skemat dhe përfitimet (transferet monetare) dhe në shërbimet profesionale*. Sistemi i mbrojtjes sociale, në nivelin qendror dhe lokal, në përgjithësi financohet nga *Buxheti i Republikës së Kosovës*. Politikat e nivelit qendror, MFPT-së, që kanë të bëjnë me fushën e mbrojtjes sociale, janë të orientuara në zhvillimin e programeve të cilat ndihmojnë familjet dhe individët, të cilët janë të rrezikuar nga varfëria dhe përjashtimi social.

Përfitimet nga të gjitha skemat dhe programet sociale gjatë vitit 2021 kanë mbuluar rreth 437.235 familje/individë apo mbi 25% të popullsisë⁵⁷ së Republikës së Kosovës, ndërsa shpenzimet e mbrojtjes sociale kanë qenë mbi 569 milion euro (569,478,259.52 euro), shpenzime këto që kanë ndikuar në ngritjen e mirëqenies së familjeve/individëve në nevojë sociale dhe në reduktimin e varfërisë apo plotësimin e nevojave ditore për ushqim dhe disa shërbime tjera elementare për jetesë.

Programet kryesore që zbatohen, janë të fokusuara në realizimin e përfitimeve dhe shërbimeve të paraqitura në skemat ekzistuese, siç janë:

6.4.1. Skema e Ndhmës Sociale

Është një mbështetje dhe ofrim i ndihmës së përkohshme financiare për familjet që jetojnë në varfëri dhe i plotësojnë kriteret dhe kushtet e përcaktuar me Ligjin Nr. 2003/15 për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë, Ligjin Nr. 04/L-096 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 2003/15 për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë. Kjo skemë ka filluar të funksionojë prej vitit 2000. Pagesa mujore për këtë skemë bëhet sipas numrit të anëtarëve të familjes. Shuma minimale gjatë vitit 2020 ishte 60.00 euro (për një anëtar) dhe maksimalja 180.00 euro (për pesëmbëdhjetë anëtarë). Në muajin dhjetor 2021 nga kjo skemë kanë përfituar 25.895 familje. Buxheti i shpenzuar për vitin 2021 është 53,637,481.25 euro.

6.4.2. Pensionet Bazike të Moshës

Është skemë e përgjithshme, jokontributive, e financuar nga Buxheti i Kosovës. Është konceptuar si tarifë e fiksuar mujore, për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës që janë mbi moshën 65 vjeçare, pavarësisht nëse kanë punuar më parë apo jo. Kjo skemë ka filluar të aplikohet që nga mesi i vitit 2002. Shuma e përfitimë për një person, përfitues i kësaj skeme në fillim ka qenë 28 euro në muaj ndërsa tani është 100 euro në muaj. Në muajin dhjetor 2021 këtë pension e kanë shfrytëzuar 148.162 qytetarë të Republikës së Kosovës. Buxheti i shpenzuar për vitin 2021 është 197,732,843.00 euro.⁵⁸

6.4.3. Pensionet Kontributpaguese të Moshës

Kjo skemë iu dedikohet personave që kanë mbushur 65 vjeç dhe të cilët dëshmojnë se kanë qenë në marrëdhënie pune mbi 15 vjet, para dt. 01.01.1999. Kjo skemë ka filluar të aplikohet që nga viti 2008. Në fillim shuma e pensionit kontributpagues të moshës ka qenë 140.00 euro në muaj. Shuma e pensionit kontributpagues të moshës nga muaji janar 2016 ka pësuar ndryshime, ku pensionet paguhen sipas kategorizimeve në bazë të shkollimit. Pagesa mujore bëhet duke filluar nga 158.00 euro e deri në 230.00

⁵⁷ Për të nxjerr këtë përqindje është marrë numri i popullsisë nga regjistrimi i vitit 2011 i realizuar nga ASK.

⁵⁸ Të dhënat për shfrytëzuesit e Skemave, të cilat nuk menaxhohen nga DPSF-ja janë marrë nga Agjencia e Statistikave të Kosovës. Shih: <https://ask.rks-gov.net/media/6692/statistikat-e-mir%C3%ABqenies-sociale-tm4-2021.pdf>

euro në muaj. Në muajin dhjetor 2021 këtë pension e kanë shfrytëzuar 49.872 qytetarë të Republikës së Kosovës. Buxheti i shpenzuar është 125,299,063.00 euro.⁵⁹

6.4.4. Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuara

Ky pension apo kjo mbështetje financiare, iu ofrohet personave të rritur mbi moshën 18 vjeçare apo më pak se 65 vjeç, të cilët janë plotësisht dhe përherë me aftësi të kufizuara dhe të paaftë për çfardo pune të shpërblyeshme. Kjo skemë ka filluar të aplikohet që nga viti 2004. Diagnozën mjekësore, gjendjen fizike, ndijore, mendore apo aftësinë e kufizuar të aplikuesit për këtë pension e vlerëson Komisioni Mjekësor, i caktuar nga Ministria, ndërsa Aktvendimin për njohje apo refuzim të kësaj të drejteje, e nxjerr Ministria, gjegjësisht, Administrata Pensionale e Kosovës. Shuma mujore e këtij pensioni është 100 euro. Në muajin dhjetor 2021 këtë pension e kanë shfrytëzuar 18,903 qytetarë të Republikës së Kosovës, buxheti i shpenzuar është 27,056,760.00 euro.⁶⁰

6.4.5. Pensionet Familjare

Pensionin i rregullt mujor i paguar për anëtarët e familjes në rast të vdekjes së të punësuarit, që ka qenë në marrëdhënie pune, të cilët i plotësojnë kriteret e parapara me ligjin në fuqi. Të drejtën për pension familjar e realizojnë të gjithë ish shfrytëzuesit e pensionit familjar të cilët janë nën moshën gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeçare dhe të cilët realizimin e kësaj të drejte e dëshmojnë me vendim apo fletëpagesë të pensionit që tregojnë se kanë qenë shfrytëzues të pensionit familjar, para datës 01.01.1999, sipas dispozitave të Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nr. 011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK nr.26/83). Shuma mujore për këtë pension është 100 euro në muaj. Në muajin dhjetor 2021 këtë pension e kanë shfrytëzuar 3.545 shfrytëzues, buxheti i shpenzuar 4,881,214.00 euro.⁶¹

6.4.6. Pensionet Invalidore të Punës

Pensionin i rregullt mujor, i paguar për personat që pësojnë lëndime në punë apo fitojnë sëmundje profesionale gjatë marrëdhënies së punës, të cilët i plotësojnë kriteret e parapara me këtë Ligj, si dhe invalidët e punës sipas Ligjit Pensional dhe Invalidor, të aplikuar para datës 01.01.1999. Të drejtën në pension invalidor të punës e realizojnë të gjithë ish shfrytëzuesit e pensionit invalidor, nën moshën gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeçare, të cilët e dëshmojnë realizimin e kësaj të drejte me vendim apo (fletëpagesë) të pensionit që tregojnë se kanë qenë shfrytëzues të pensionit invalidor të punës, sipas dispozitave të Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor. E drejta në pension invalidor të punës iu njihet edhe të gjithë të punësuarve aktual, të cilët është shfaqur paaftësia e plotë për punë, si pasojë e lëndimit në punë apo e sëmundjes profesionale. Lartësia e pensionit invalidor të punës është në shumën e njëjtë me pensionin bazik të moshës. Shuma mujore e këtij

⁵⁹ Të dhënat për shfrytëzuesit e Skemave, të cilat nuk menaxhohen nga DPSF-ja janë marrë nga Agjencia e Statistikave të Kosovës. Shih: <https://ask.rks-gov.net/media/6692/statistikat-e-mir%C3%ABqenies-sociale-tm4-2021.pdf>

⁶⁰ Po aty.

⁶¹ Po aty.

pensionin është 100 euro. Në muajin dhjetor 2021 këtë pension e kanë shfrytëzuar 68 shfrytëzues, buxheti i shpenzuar 104,060.00 euro.⁶²

6.4.7. Pensionet Paraplegjike dhe Tetraplegjike

Pensionin për personat paraplegjikë e përfitojnë personat të cilët si shkak i sëmundjes apo dëmtimit të sistemit nervor qendror apo periferik, kanë humbur në formë të përhershme mundësinë e zhvendosjes dhe lëvizjes së ekstremiteteve të poshtme, ndërsa pensioni për personat tetraplegjikë përfitojnë personat të cilët si shkak i sëmundjes apo dëmtimit të sistemit nervor qendror apo periferik, kanë humbur në formë të përhershme mundësinë e zhvendosjes dhe lëvizjes të ekstremiteteve të sipërme dhe të poshtme. Përfituesit e këtij Ligji janë personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë, ndërsa kompensimi - nënkupton shumën e pagesës mujore për mbulimin e shpenzimeve të domosdoshme ditore. Për kompensimin e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë, shuma mujore me shoqërues është 375 euro (Grupi I), kurse pa shoqërues është 150 euro (Grupi II). Nga kjo skemë në muajin dhjetor 2021 kanë përfituar 2.662 përfitues, buxheti i shpenzuar 11,062,120.00 euro⁶³

6.4.8 Pensionet e Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK)

Është pagesë e rregullt mujore që i bëhet ish pjesëtarit të TMK-së gjatë tërë jetës, ose trashëgimtarit pas vdekjes së ish pjesëtarit të TMK-së. Ky pension ka filluar të aplikohet që nga viti 2009. Shuma mujore e pagesës së pensioneve të TMK-së përcaktohet nga 50%, 60% dhe 70% të pagesës mesatare për tri vitet e fundit, pra, nga 100 euro deri në 347 euro në muaj. Në muajin dhjetor 2021 këtë pension e kanë përfituar 1.223 persona, buxheti i shpenzuar është 3,246,387.00 euro.⁶⁴

6.4.9. Pensionet e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK)

Është pension i rregullt mujor që i paguhet pjesëtarit të FSK-së, i cili i plotëson kriteret e parapara në Ligjin për Pensionet e Pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës (Ligji Nr. 04/L-084) dhe trashëgimtarit pas vdekjes së pjesëtarit të FSK-së. Kjo skemë ka filluar së zbatuari që nga viti 2012. Shuma e pagesës së pensioneve të FSK-së përcaktohet me 50%, 60% dhe 70% të pagesës mesatare për tri vitet e fundit. Në muajin dhjetor 2021 këtë pension e kanë përfituar 625 pjesëtarë, buxheti i shpenzuar ishte 3,075,573.00 euro.⁶⁵

⁶² Të dhënat për shfrytëzuesit e Skemave, të cilat nuk menaxhohen nga DPSF-ja janë marrë nga Agjencia e Statistikave të Kosovës. Shih: <https://ask.rks-gov.net/media/6692/statistikat-e-mir%C3%ABqenies-sociale-tm4-2021.pdf> ;

⁶³ Po aty;


⁶⁴ Po aty.

⁶⁵ Po aty.

6.4.10. Skema e Familjeve të Dëshmorëve, Invalidëve të Luftës dhe Viktimave Civile

Kjo skemë ka për qëllim ofrimin e përfitimeve për kategoritë e qytetarëve të cilët kanë pësuar nga maltretimet dhe lufta që ka ndodhur gjatë viteve 1998/99 në Kosovë. Kjo skemë ka filluar të implementohet për disa kategori nga viti 2001, ndërsa me aprovimin e Ligjit nga vitit 2008 janë përfshirë edhe disa kategori, të cilat më parë nuk ishin përfituese. Në muajin dhjetor 2021 nga kjo skemë kanë përfituar 13.293 familje/individë, buxheti i shpenzuar 44,317,230.02 euro, shih figurën me poshtë:

Figura 53: Numri i përfituesve të skemës së FDIL-së sipas kategorive, dhjetor 2021 ⁶⁶



6.4.11 Pensionet për Veteranët e Luftës

Të drejtën e këtij pensioni e ka individ që është qytetar i Republikës së Kosovës dhe shtetas i huaj, i cili është rreshtuar në radhët e UÇK-së dhe është regjistruar si ushtar i armatosur dhe i uniformuar nga komandat, shtabet e zonave operative të UÇK-së, dhe i cili ka qenë aktiv deri në përfundimin e luftës. Në muajin dhjetor 2021 nga kjo skemë kanë përfituar 38.804 individë/familje. Nga ky total 34.562 ishin veteranë të UÇK-së, me shumë mujore prej 170 eurosh, dhe 2.242 ishin familje të veteranit pas vdekjes së tij, me shumë mujore prej 119 eurosh. Buxheti i shpenzuar ishte 79,026,654.25 euro.⁶⁷

6.4.12. Pensionet e Minatorëve të Trepçës

Të drejtën për të përfituar këtë pension e kanë të gjithë të punësuarit në kompleksin “Trepça”, të cilët e kanë humbur vendin e punës deri në fund të vitit 2004. Ky pension ka filluar të implementohet nga data 01.07.2003. Gjatë vitit 2003/2004 shuma mujore e këtij pensioni ishte 40 euro në muaj, ndërsa tani është 126 euro në

⁶⁶ Po aty.

⁶⁷ Të dhënat për shfrytëzuesit e Skemave, të cilat nuk menaxhohen nga DPSF-ja janë marrë nga Agjencia e Statistikave të Kosovës.

muaj. Bazuar në gjendjen e muajit dhjetor 2021, numri i përfituesve nga Skema e Pensioneve të Trepçës ishte 2.028 persona, buxheti i shpenzuar 3,484,563.00 euro.⁶⁸

6.4.13. Pensionet për Personat e Verbër

Të drejtën për realizimin e këtij pensioni e kanë personat me humbje të plotë të pamurit, të lindur ose të fituar sipas Ligjit Nr. 4/L-92 për Personat e Verbër. Shuma e pagesës për personat e verbër është 125 euro në muaj, si dhe 125 euro për shoqëruesit e personave të verbër. Në muajin dhjetor 2021 nga ky pension kanë përfituar 1.772 persona, buxheti i shpenzuar 5,277,436.00 euro.⁶⁹

6.4.14. Skema për Përkrahje Materiale për Familjet e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara të Përhershme 1-18 vjeç (FFAKP)

Kjo përkrahje materiale iu ofrohet familjeve, të cilat kanë në përkujdesje të plotë 24 orëshe fëmijë me aftësi të kufizuara të përhershme 1 deri në 18 vjeç, të cilët janë plotësisht të paaftë të kryejnë aktivitetet e tyre të përditshme jetësore, pa përkujdesin e personit tjetër. Kjo Skemë ka filluar të funksionojë në vitin 2009. Shuma mujore për një fëmijë është 100.00 euro në muaj. Në muajin dhjetor 2021 nga kjo skemë kanë përfituar 2.460 fëmijë me aftësi të kufizuara të përhershme, buxheti i shpenzuar 3,551,630.00 euro.

6.4.15. Pensionet për Kopensimin e Arsimit për vitet 90/91 deri në vitin shkollor 98/99

Kjo skemë ka filluar të implementohet nga muaji janar 2020. Personi i pensionuar, i cili ka punuar në arsimin shqip të Republikës së Kosovës nga viti shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99, gëzon një kompensim shtesë për kontributin e dhënë. Nga kjo skemë në muajin dhjetor 2021 kanë përfituar 12.215 persona, buxheti i shpenzuar 8,822,030.00 euro.⁷⁰

6.4.16. Strehimi familjar

Strehimi familjar i fëmijëve të braktisur dhe pa përkujdesje prindërore, realizohet në dy forma të cilat janë:

- Strehimi familjar i fëmijëve brenda familjes/te farefisi, në muajin dhjetor 2021 në këtë formë të strehimit ishin 436 fëmijë, buxheti i shpenzuar 610,460.00 euro; dhe
- Strehimi familjar i fëmijëve jashtë familjes/alternativ, në muajin dhjetor 2021 ishin të vendosur 51 fëmijë, buxheti i shpenzuar 174,325.00 euro.

⁶⁸ Po aty.

⁶⁹ Të dhënat për shfrytëzuesit e Skemave, të cilat nuk menaxhohen nga DPSF-ja janë marrë nga Agjencia e Statistikave të Kosovës.

⁷⁰ Të dhënat për shfrytëzuesit e Skemave, të cilat nuk menaxhohen nga DPSF-ja janë marrë nga Agjencia e Statistikave të Kosovës.

6.4.17. Pagesat për Lehonat e Papunësuara dhe të Punësuara (Masa 3.5)

Në kuadër të kësaj skeme, përfitojnë lehonat të cilat figurojnë si të papuna në Administratën Tatimore të Kosovës për dymbëdhjetë (12) muajt e fundit para ditës së lindjes së foshnjës. Lehonat e papunësuara do të përfitojnë mbështetje financiare në shumën prej 170 eurosh për 6 muaj, ndërsa lehonat e punësuara do të përfitojnë mbështetje financiare në shumën prej 170 eurosh për 3 muaj, krahas kompensimit të rregullt të pushimit të lehonisë. Skema ka filluar të implemetohet në muajin shtator 2021, duke përfshirë lehonat nga 1 gushti 2021. Nga kjo skemë në muajin dhjetor 2021 kanë përfituar 20.376 lehona (14.688 lehona të papunësuara dhe 5.688 lehona të punësuara), buxheti i shpenzuar: 3,333,700.00 euro (2,384,760.00 euro për lehonat e papunësuara dhe 948,940.00 euro për lehonat e punësuara).

6.4.18. Shtesat për Fëmijë (Masa 3.5)

Kjo skemë ka filluar të zbatohet në muajin shtator 2021 bazuar në Vendimin Nr. 55, datë 09.09.2021 mbi caktimin e kushteve dhe kriterëve për zbatimin e pjesëshëm të Masës 3.5 - Shtesat për Fëmijë të Pakos së Ringjalljes Ekonomike. Nga kjo skemë është paraparë që të përfitojnë të gjithë fëmijët nën moshën 16 vjeç. Zbatimi i saj do të jetë gradual deri sa të bëhet përfshirja e të gjithë fëmijëve nën moshën 16 vjeç.

Shuma mujore është 20.00 euro në muaj për një fëmijë 0-24 muaj dhe 10.00 euro në muaj për një fëmijë nën 16 vjeç. Në muajin dhjetor 2021 nga kjo skemë kanë përfituar 127.432 fëmijë (37.708 fëmijë 0-24 muaj dhe 89.724 fëmijë nën 16 vjeç), buxheti i shpenzuar është 4,688,820 euro (2,437,180 euro për fëmijët 0-24 muaj dhe 2,251,640 euro për fëmijët nën moshën 16 vjeç).

6.4.19. Mbështetja për familjet që kanë humbur kryefamiljarin nga COVID-19

Janë mbështetur të gjitha familjet që kanë humbur kryefamiljarin e tyre nga COVID-19. Vlera e mbështetjes financiare është 1,500 euro (për familjet që e kanë humbur familjarin si pasojë e infektimit me COVID-19) dhe 10,000 euro (për familjet kur familjari që ka humbur jetën ka qenë i punësuar si personel shëndetësor në sektorin publik dhe përgjatë ushtrimit të detyrës zyrtare në luftimin e pandemisë është infektuar me COVID-19). Mbështetja ka filluar të realizohet në muajin tetor 2021. Deri në fund të muajit dhjetor 2021, nga kjo mbështetje kanë përfituar 12.215 persona/familje, buxheti i shpenzuar është 8,822,030.00 euro.

6.4.20. Shërbimet Profesionale dhe Këshilluese

Shërbimet Profesionale dhe Këshilluese, ofrohen nga Qendrat për Punë Sociale të cilat janë të shtrira në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Ekzistojnë rreth 50 forma të shërbimeve sociale dhe profesionale të cilat iu ofrohen individëve dhe familjeve në nevojë sociale (fëmijëve, të rriturve dhe të moshuarve).

Gjatë vitit 2021, Qendrat për Punë Sociale kanë trajtuar me shërbime të nevojshme sociale dhe familjare 9.177 individë/familje në nevojë sociale. Nga ky total 2.752 apo 30% janë raste të mbyllura, ndërsa 6.425

apo 70% janë raste aktive dhe do të vazhdojnë të trajtohen me shërbime të nevojshme dhe gjatë vitit 2022.⁷¹

6.5. Përrjashtimi social

Përrjashtimi social është një proces ku individë dhe grupe sociale, duke qenë të cenuar nga varfëria, mospërgatitja e duhur arsimore, mungesa e shkathtësive profesionale, fizike apo intelektuale, shtyhen që pjesërisht apo plotësisht të jetojnë në margjinat e shoqërisë. Kjo situatë ata i largon nga mundësia për punë, të ardhura dhe edukim, sikurse që i largon edhe nga përfitimet nga komunikimi dhe rrjetëzimi social. Për më keq, gjendja e disfavorshme sociale i kufizon ata që të ndikojnë në vendimmarrje, në politikat dhe përrmirësimin e jetës së tyre.

Varfëria është ndër faktorët kryesor të përrjashtimit social. Bazuar në Anketën e Buxhetit të Ekonomive Familjare (ABEF) të vitit 2017, është vlerësuar se 18% e popullsisë së Kosovës jeton nën kufirin e varfërisë, me 5.1% të popullsisë nën kufirin e varfërisë së skajshme.⁷²

Duke krahasuar të dhënat përrgjatë viteve, mund të vërehet se shkalla e varfërisë ka rënë për rreth 5.9 pikë të përrqindjes nga viti 2012 në vitin 2013; ka shënuar rritje nga viti 2013 në vitin 2014 për 3.7 pikë të përrqindjes dhe më pas ka rënë në shkallën 3.9 të vitit 2014 në 2015, pastaj shënoi rënie 0.8 pikë të përrqindjes midis 2015 dhe 2016 dhe përrsëri shënoi rritje me 1.2 pikë të përrqindjes midis 2016 dhe 2017. Shkallët e varfërisë dhe të varfërisë së skajshme janë më të larta në vendbanimet rurale.⁷³

Bazuar në të dhënat e kësaj ankete (ABEF 2017), varfëria është me e theksuar tek: familjet që banojnë në vendbanimet rurale (63%)⁷⁴, familjet me më shumë anëtarë, ku shkalla më e lartë e varfërisë është gjetur te familjet me shtatë e më shumë anëtarë (38%)⁷⁵, familjet që burim kryesor të të ardhurave e kanë ndihmën sociale (80.2%)⁷⁶, familjet me burim kryesor të të ardhurave nga puna me mëditje dhe që burim kryesor të të ardhurave kanë pensionet (29.3%)⁷⁷, të punësuarit në punë të rastësishme (23.6%)⁷⁸, personat me aftësi të kufizuara (30.7%)⁷⁹, nxënësit/studentët (16%)⁸⁰, të papunësuarit (25.5%)⁸¹, familjet që kryesohen nga meshkujt (18.3%)⁸², individët që e kanë përrfunduar shkollën fillore (21.6%)⁸³, individët që nuk e kanë

⁷¹ Të dhënat janë marrë nga Baza e të Dhënave të Shërbimeve Sociale dhe Familjare në DPSF/MFPT, dhjetor 2021.

⁷² <https://ask.rks-gov.net/media/4882/statistikat-e-varf%C3%ABris%C3%AB-2012-2017.pdf>; fq.6

⁷³ Po aty, f.6

⁷⁴ Po aty, f. 8.

⁷⁵ Po aty, f. 10.

⁷⁶ Po aty, f. 12.

⁷⁷ Po aty, f. 12.

⁷⁸ Po aty, f.17.

⁷⁹ Po aty, f.17.

⁸⁰ Po aty, f. 17.

⁸¹ Po aty, f.17.

⁸² Po aty, f. 13.

⁸³ Po aty, f. 14.

përfunduar shkollën fillore (21.5)⁸⁴, fëmijët (22.8%)⁸⁵, si dhe familjet me 3 e më shumë fëmijë (26.3% dhe 8.0%-shkalla e varfërisë së skajshme).⁸⁶

Qeveria e Republikës së Kosovës i ka identifikuar grupet që janë më të rrezikuara, dhe që e ndejnë përjashtimin më shumë se të tjerët dhe duhet të jenë prioritet i politikave sociale në Kosovë. Këto grupe janë: *të papunësuarit afatgjatë, fëmijët dhe të rinjtë e pa favorizuar, posaçërisht vajzat nga viset rurale dhe fëmijët e pakicave kombëtare, femrat nga viset rurale, nënat vetushqyese, komunitetet romë, ashkali dhe egjiptian, të cilët përveç shkallës më të lartë të papunësisë dhe varfërisë, kanë nivel të ulët të shkollimit dhe shkollën më të lartë të analfabetizmit dhe personat me aftësi të kufizuara, shumica e të cilëve nuk kanë qasje fizike në objektet shëndetësore dhe arsimore - dhe familjet e tyre, të cilat janë ofruesit kryesorë të përkujdesjes për këta persona.*

Institucionet kryesore që janë të përfshira në hartimin dhe zbatimin e këtyre politikave janë Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve në nivelin qendror, Drejtoritë Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale përmes Qendrave për Punë Sociale në nivelin lokal, të cilat kanë kaluar në kompetenca të komunave nga viti 2009 dhe ofrojnë shërbime sociale dhe familjare për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës pa dallim moshe, gjinie, etnie apo përkatësie fetare, por që i plotësojnë kriteret e parapara me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Përveç institucioneve publike të lartpërmendura, një rol të rëndësishëm kanë edhe OJQ-të, të cilat merren me ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare.

6.6. Licencimi i Organizatave Joqeveritare

Korniza ligjore e aprovuar për shërbimet sociale, ka mundësuar që të zhvillohet dhe zbatohet procesi i licencimit të subjekteve juridike, OJQ-ve dhe kompanive private, të cilat merren me ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare.

Gjatë vitit 2021, Komisioni përkatës për Licencimin e Subjekteve Juridike / Organizatave Joqeveritare, i cili funksionon në kuadër të DPSF/MFPT-së, bazuar në Udhëzimin Administrativ (MPMS) Nr. 02/2020 për Licencimin e Organizatave Joqeveritare dhe Subjekteve Juridike Private që Ofrojnë Shërbime Sociale dhe Familjare, ka shqyrtuar dyzetë e nëntë (49) kërkesa për licencim dhe rilicencim, nga të cilat dyzetë e tetë (48) kërkesa apo 98% janë aprovuar (licencuar/rilicencuar), ndërsa 1 kërkesë apo 2%, është refuzuar pasi që nuk i ka plotësuar kriteret e parapara me legjislacionin në fuqi.

OJQ-të e licencuara, fushëveprimtari të tyre e kanë mbrojtjen sociale të personave në nevojë për shërbime sociale dhe familjare. Organizatat Joqeveritare (OJQ) licencohen, sipas zonave dhe fushëveprimtarisë që e ushtrojnë, në nivelin nacional dhe lokal dhe duke bërë profilizimin e tyre varësisht nga shërbimet që i ofrojnë.

⁸⁴ Po aty, f. 14.

⁸⁵ Po aty, f. 18.

⁸⁶ Po aty, f. 19.

Vlefshmëria e licencës është e plotë dhe e kushtëzuar. E plotë për periudhën tri (3) vjeçare dhe e kushtëzuar për periudhën një (1) vjeçare.

Nga dyzetë e tetë (48) OJQ-të e licencuara/rilicencuara, tridhjetë e pse (35) apo 73% janë licencuar për të ofruar shërbime në nivel lokal dhe trembëdhjetë (13) OJQ apo 27% janë licencuar për të ofruar shërbime në nivel nacional. Shih figurat më poshtë:

Figura 54: Numri i kërkesave të OJQ-ve për licencim të shqyrtuara gjatë vitit 2021





Figura 55: OJQ-të e licencuara sipas nivelit ku i ofrojnë shërbime, 2021



Në vitin 2021, numri i kërkesave për licencim/rilicencim është rritur për 37 kërkesa më shumë apo mbi 300% krahasuar me vitin paraprak.

6.7. Njësia për Monitorim dhe Inspektim

Njësia për Monitorimin dhe Inspektimin (NJMI) e Shërbimeve Sociale dhe Familjare, që funksionon në kuadër të DPSF/MFPT, ka zhvilluar aktivitetin e punës bazuar në mandatin ligjor të përcaktuar me Ligjin Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare, Ligjin Nr.04/L-081 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare, Udhëzimin Administrativ Nr.14/2013 për Monitorimin dhe Inspektimin e Subjekteve Juridike/Organizatave që ofrojnë Shërbime Sociale dhe Familjare, Rregulloren e Punës Nr.999 dhe Planin Vjetor të Punës 2021.

Mandati ligjor i NJMI-së, është inspektimi i ofruesve të shërbimeve sociale dhe familjare (personave fizikë dhe juridikë) në sektorin publik, joqeveritar dhe privat, me qëllim të rritjes së cilësisë së ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare. Objektivat e inspektimit janë:

- *Vlerësimi i zbatimit të legjislacionit për ofrimin e shërbime sociale dhe familjare për persona (fëmijë dhe të rritur) dhe për familje në nevojë sociale;*

- *Vlerësimi i kualitetit të shërbimeve bazuar në Standardet Minimale të Cilësisë;*
- *Vlerësimi i zbatimit të Procedurave Standarde të Veprimit (PSV) për kategori të caktuara në nevojë për mbrojtje dhe shërbime; dhe*
- *Respektimi i Kodit Etik për ofruesit e shërbimeve sociale dhe familjare.*

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2021, ka kryer katër (4) monitorime/inspektime të planifikuara dhe 1 (një) inspektim të jashtëzakonshëm në institucionet, si më poshtë:

1. Qendrën për Punë Sociale në Mitrovicë- inspektim i planifikuar;
2. Shtëpinë me Bazë në Komunitet për Persona të Moshuar pa Përkujdesje Familjare në Istog (institucion publik komunal)-Inspektim i jashtëzakonshëm;
3. OJQ “Doën Syndrome Kosova (DSK)-Prishtinë”- Inspektim i planifikuar;
4. OJQ “Qendra Kosovare për Vetë-Përkrahje (QKVP)” në Prishtinë- Inspektim i planifikuar;
5. Shtëpia me Bazë në Komunitet për Persona me Aftësi të Kufizuar, me ngecje në zhvillim mendor, në Deçan – (institucion publik komunal)- Inspektim i planifikuar.

7. DIVIZIONI I POLITIKAVE SOCIALE

7.1. Detyrat dhe përgjegjësitë

Divizioni i Politikave Sociale funksionon në kuadër të DPSF/MFPT-së. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit të Politikave Sociale, janë:

- ✓ *Hulumtimi në fushën e shërbimeve sociale e familjare dhe efekti i skemave të pagesave sociale në reduktimin e varfërisë;*
- ✓ *Hulumtimi i dukurive të ndryshme sociale dhe përgatitja e rekomandimeve në fushën e politikave sociale;*
- ✓ *Koordinimi i aktiviteteve me Agjencinë e Statistikave të Kosovës, për sigurimin e të dhënave dhe përpunimin e tyre, të cilat përdoren për publikimin e raporteve hulumtuese;*
- ✓ *Publikimi i doracakëve për shërbimet që ofrohen nga MFPT-ja dhe i raporteve për politika sociale;*
- ✓ *Bashkëpunimi me strukturat profesionale vendore dhe ndërkombëtare, me qëllim të ngritjes së kualitetit të shërbimeve sociale dhe familjare;*
- ✓ *Përmbledhja e të arriturave në fushën e politikave sociale dhe publikimi i tyre në ueb-faqet e Departamentit apo Ministrisë.*

Udhëheqësi i Divizionit të Politikave Sociale, raporton tek Udhëheqësi i Departamentit për Politika Sociale dhe të Familjes. Numri i të punësuarve në këtë Divizion është shtatë (7).

7.2. Përgatitja e hulumtimeve për publikim

Edhe gjatë vitit 2021 puna e DPS-së është ndikuar nga gjendja e krijuar nga pandemia dhe për këtë arsye nuk ka qenë në volumnin e viteve të mëparshme, gjë e cila ka reflektuar edhe në realizimin e objektivave të parapara sipas detyrave dhe përgjegjësisë që ka Divizioni i Politikave Sociale, për përmbushjen e misionit dhe në zbatimin e objektivave të përcaktuar në Planin Vjetor të Punës së Ministrisë, si dhe në zbatimin e Planit Vjetor të Punës së DPS-së për vitin 2021, plan ky i miratuar nga menaxhmenti i Departamentit të Politikave Sociale dhe Familjare.

Divizioni i Politikave Sociale, gjatë vitit 2021 ka punuar në realizimin e hulumtimeve, si më poshtë:

- ❖ **“Fëmijët në Punë”**- është hulumtim i cili ka të bëjë me pasqyrimin real të gjendjes lidhur me përfshirjen e fëmijëve në punë dhe dhënien e rekomandimeve për institucionet që merren me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, se si duhet vepruar në largimin e këtyre fëmijëve nga puna dhe integrimin e tyre në shoqëri. Gjatë vitit 2021, nga Grupi Punues është përfunduar Drafti i Hulumtimit.
- ❖ **“Moshë e Tretë”**- hulumtimi është një analizë për gjendjen socio-ekonomike të personave të moshës së tretë, personave mbi 65 vjeç, legjislacionin me të cilin janë të mbrojtur të drejtat e këtyre personave, etj. Edhe gjatë vitit 2021 është punuar në këtë hulumtim, të cilit i është shtuar edhe kapitulli “Pandemia dhe të Moshuarit”. Hulumtimi pritet të finalizohet në vitin 2022.
- ❖ **Hartimi i formave standarde për menaxhimin e rastit për kategoritë e fëmijëve në punë, si dhe i treguesve për punën e fëmijëve** - gjatë vitit 2021 është realizuar Raporti Monitorues në lidhje me zbatimin e standardeve minimale që kanë të bëjnë me punën e fëmijëve, janë rishikuar, validuar dhe digjitalizuar forma të punës për fëmijët në punë, janë aprovuar, validuar dhe digjitalizuar indikatorët, janë hartuar modulet e trajnimit, është hartuar udhëzuesi për trajnimet si dhe është hartuar Tutori Elektronik për përdorimin e formave të punës.
- ❖ **Udhëzuesi për Pilotimin e Testit të Varfërisë, për kategoritë sociale të liruar nga pagesat e premieeve për sigurime shëndetësore** - është finalizuar Draftudhëzimi Administrativ si dhe Manuali/Udhëzuesi për lirim nga pagesa e premieeve dhe bashkëpagesat për sigurime sociale për kategoritë sociale.

Nga Divizioni i Politikave Sociale janë kryer edhe aktivitete të tjera, si: pjesëmarrja e zyrtarëve në komisione të ndryshme apo pjesëmarrja në grupe punuese duke dhënë kontributin profesional sipas mandatit që kanë. Gjithashtu, DPS-ja ka bashkëpunuar edhe me institucione dhe OJQ-ë të ndryshme që kanë të bëjnë me fushën sociale.

8. DIVIZIONI PËR MBËSHTETJE ADMINISTRATIVE TË KPSHSF-së

8.1. Detyrat dhe përgjegjësitë

Divizioni për Mbështetje Administrative i KPSHSF-së, funksionon në kuadër të DPSF/MFPT-së. Detyrat dhe përgjegjësitë e këtij Divizioni, janë:

- ✓ *Përgatitja e mbledhjeve në bashkëpunim me kryetarin apo zëvendëskryetarin, duke caktuar agjendën e takimeve të KPSHSF-së;*
- ✓ *Organizimi dhe caktimi i vendit të mbajtjes së takimeve, si dhe kujdesia për hartimin e ekstraktit të procesverbalit nga mbledhjet e KPSHSF-së;*
- ✓ *Udhëheqja dhe menaxhimi me të gjithë arkivin dhe dokumentacionin e hartuar dhe aprovuar nga KPSHSF-ja;*
- ✓ *Përgatitja e raporteve për punën dhe aktivitetet e zhvilluara të KPSHSF-së, si dhe të komiteteve punuese të cilat veprojnë në kuadër të Këshillit;*
- ✓ *Kujdesi për regjistrin e punëtorëve socialë të licencuar dhe mirëmbajtja e shënimeve në formë të shkruar dhe elektronike;*
- ✓ *Kujdesi për ekzekutimin e vendimeve të KPSHSF-së dhe komisioneve të themeluara nga Këshilli;*
- ✓ *Përgjegjësia për menaxhimin e ueb-faqes dhe kujdesi për publikimet e dokumenteve të ndryshme;*
- ✓ *Hartimi dhe planifikimi i kërkesave buxhetore për KPSHSF-në dhe prezantimi i tyre para organeve përgjegjëse brenda dhe jashtë MFPT-së;*
- ✓ *Hartimi dhe procedimi i të gjitha kërkesave dhe pagesave për zhvillimin e aktiviteteve të KPSHSF-së;*
- ✓ *Kujdesi dhe organizimi i punëtorëve dhe koordinimi i aktiviteteve me donatorë mbështetës të KPSHSF-së;*
- ✓ *Raportimi i Udhëheqësit të Divizionit, te Ministri i MFPT-së.*

9. KËSHILLI I PËRGJITHSHËM PËR SHËRBIME SOCIALE DHE FAMILJARE

9.1. Detyrat dhe përgjegjësitë

Këshilli i Përgjithshëm për Shërbime Sociale dhe Familjare (KPSHSF), funksion sipas Ligjit Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare dhe është përgjegjës për mirëmbajtjen e standardeve dhe disiplinës profesionale në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare, dhe në këtë vazhdë shërben si një organ regjistruar dhe licensues për profesionistët që punojnë në këtë lëmi.⁸⁷

Këshilli gjithashtu është përgjegjës edhe për:

- ✓ *Hartimin e rregulloreve që i konsideron të nevojshme për sigurimin e licencimit, regjistrimin e specialistëve dhe zhvillimin e vazhdueshëm profesional adekuat;*
- ✓ *Hartimin e kodit etik për profesionistët e shërbimeve sociale dhe familjare;*
- ✓ *Mbajtjen e regjistrit të profesionistëve të shërbimeve sociale dhe familjare, të cilët janë të licencuar për ta ushtruar veprimtarinë në Republikën e Kosovës;*
- ✓ *Këshilli ka kompetencë që të vendosë se kush mund të jetë i licencuar si profesionist apo specialist i shërbimeve sociale dhe familjare;*
- ✓ *Shqyrton ankesat kundër profesionistëve të shërbimeve sociale dhe familjare dhe vendos për sanksionet disiplinore që duhen zbatuar, duke përfshirë anulimin e licencës që njeh kompetencën e ofruesit të shërbimeve sociale dhe familjare, heqjen e profesionistit të shërbimeve sociale dhe familjare nga regjistri;*
- ✓ *Këshilli është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha pretendimeve për shkelje të obligimeve nga profesionistët e shërbimeve sociale dhe familjare;*
- ✓ *Licencon trajnerë në fushën e shërbimeve sociale dhe mund të autorizojë ekspertë vendorë nga radhët e veta dhe jashtë tij, në ofrimin e trajnimit për profesionistë të shërbimeve sociale dhe familjare;*

⁸⁷ Neni 5, paragrafi, 5.2 i Ligjit Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare; <https://gzk.rks-gov.net>.

- ✓ *Këshilli për licencimin apo certifikimin e trajnimeve mund të ketë rolin edukativo-arsimor për të gjithë profesionistët, OJQ-të dhe organizatat qeveritare të cilat merren me shërbime sociale dhe familjare.⁸⁸*

9.2. Përbërja e Këshillit

Këshilli i Përgjithshëm për Shërbime Sociale dhe Familjare (KPSHSF) është themeluar më 1 prill 2006. Në parim Këshilli është organ që monitoron dhe analizon ngritjen e kualitetit në ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare në Kosovë. Këshilli përbëhet nga njëzetë e një anëtarë (21):

- Njëmbëdhjetë (11) anëtarë zgjidhen nga radhët e profesionistëve të shërbimeve sociale dhe familjare, që gjenden në regjistrin e Këshillit;
- Dy (2) anëtarë emërohen nga Asociacioni i Komunave;
- Dy (2) anëtarë i emëron Universiteti i Prishtinës;
- Një (1) anëtar i emëruar nga Këshilli i Përgjithshëm Shëndetësor;
- Një (1) anëtar nga komuniteti dhe organizatat joqeveritare, dhe
- Katër (4) anëtarë të emëruar nga Ministria.

Pra, në përbërjen e vet Këshilli ka përfaqësues nga Asociacioni i Komunave, përfaqësues nga shoqëria civile, profesorë, profesionistë të shërbimeve sociale dhe familjare, si dhe partnerë të tjerë relevantë, të cilët me përvojat e tyre të fituara, mundësojnë që Këshilli të jetë ekuivalent me kërkesat që dalin nga rrjedhat e vazhdueshme të shoqërisë, dhe mbi të gjitha të ofrojë përgatitje profesionale në ngritjen e kualitetit dhe ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare në Kosovë.

Në fillim, kohëzgjatja e një mandati të Këshillit ka qenë 3 vjeçar, ndërsa që nga viti 2012, kur është bërë Plotësimi dhe Ndryshimi i Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare, kohëzgjatja e një mandati të Këshillit është 4 vjeçar.

9.3. Aktivitetet kryesore të realizuara

Gjatë vitit 2021, Këshilli i ka mbajtur katër (4) takime. Ndërsa Komisionet e Përhershme dhe Grupet Punuese kanë mbajtur takime sipas nevojës, bazuar në kërkesat e Sekretarisë. Përveç pjesëmarrjes në takimet e rregullta të Këshillit, të Komisioneve dhe të Grupeve Punuese, ka pasur edhe angazhime individuale të anëtarëve të Këshillit në aktivitete të tjera të lidhura me fushën që mbulon Këshilli.

Në fillim të vitit 2021 është hartuar dhe miratuar Plani Vjetor i Punës së KPSHSF-së për vitin 2021. Puna dhe aktivitetet e KPSHSF-së gjatë vitit 2021 janë bazuar në këtë plan. Aktivitetet e realizuara nga KPSHSF-ja, në periudhën janar-dhjetor 2021 janë si më poshtë:

- o Është hartuar dhe miratuar Raporti Vjetor i Punës së KPSHSF-së për vitin 2020;

⁸⁸ Neni 5, paragrafi, 5.2 i Ligjit Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare; <https://gzk.rks-gov.net>

- o Është krijuar dhe funksionalizuar Komiteti për Koordinim të Trajnimeve (KKT), si trupë e përhershme brenda KPSHSF-së;
- o Është hartuar dhe miratuar nga Këshilli Rregullorja e Punës së Komitetit për Koordinim të Trajnimeve;
- o Grupi Punues për Akreditimin e KPSHSF-së ka hartuar dhe finalizuar listën prej njëzetë e pesë (25) moduleve të trajnimit, të cilat janë të ndara bazuar në tri (3) standardet e profesionit që janë të aprovuara nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve:

I. Bashkëpunëtorë profesionalë të punës sociale (12 module):

1. Etika profesionale në ofrimin e shërbimeve sociale;
2. Format e mbrojtjes dhe llojet e shërbimeve sociale;
3. Standardet e shërbimeve sociale dhe familjare;
4. Standardet minimale të shërbimeve sociale për mbrojtjen e fëmijëve;
5. Standardet minimale të shërbimeve sociale për persona madhorë dhe të moshuar;
6. Puna me persona të moshuar;
7. Puna me viktime të dhunës në familje;
8. Puna me përdorues të substancave psiko-aktive;
9. Puna me familjen, grupet e cënueshme dhe komunitetin;
10. Puna me viktime të dhunës në familje, trajtimi dhe referimi;
11. Shërbime psiko-sociale dhe shkathtësi këshillimi;
12. Standardet minimale të shërbimeve sociale për mbrojtjen e personave me aftësi të kufizuara.

II. Profesionistët e punëve sociale dhe këshillimi (20 module):

1. Puna sociale dhe profesioni i punëtorit social;
2. Politikat sociale dhe programet e mbrojtjes sociale;
3. Legjislacioni i shërbimeve sociale;
4. Etika profesionale në ofrimin e shërbimeve sociale;
5. Format e mbrojtjes dhe llojet e shërbimeve sociale;
6. Menaxhimi i rastit, vlerësimi i nevojave dhe hartimi i planit individual për klientë;
7. Standardet e shërbimeve sociale dhe familjare;
8. Standardet minimale të shërbimeve sociale për mbrojtjen e fëmijëve (0-18);
9. Standardet minimale të shërbimeve sociale për persona madhorë dhe të moshuar;
10. Puna me persona me aftësi të kufizuara;
11. Puna me fëmijë në punë të rënda dhe të rrezikshme;
12. Puna me viktime të krimeve seksuale dhe trafikimit;
13. Puna me përdorues të substancave psiko-aktive;
14. Puna me migrantë, refugjatë, të rikthyer dhe të riatdhesuar;
15. Puna me familjen, grupet e cënueshme dhe komunitetin;

16. Puna me viktimat e dhunës në familje, trajtimi dhe referimi;
17. Shërbime psiko-sociale dhe shkathtësi këshillimi;
18. Shëndeti mendor, trajtimi dhe referimi;
19. Psikologjia e zhvillimit;
20. Standardet minimale të shërbimeve sociale për mbrojtjen e personave me aftësi të kufizuara.

III. Menaxher i mirëqenies sociale (9 module):

1. Politikat sociale dhe programet e mbrojtjes sociale;
 2. Legjislacioni i shërbimeve sociale;
 3. Planifikimi, administrimi dhe financimi i shërbimeve sociale;
 4. Monitorimi dhe inspektimi i shërbimeve sociale dhe familjare;
 5. Menaxhimi dhe lidhshëri në fushën e mirëqenies sociale;
 6. Etika profesionale në ofrimin e shërbimeve sociale;
 7. Format e mbrojtjes dhe llojet e shërbimeve sociale;
 8. Standardet e shërbimeve sociale dhe familjare;
 9. Parimet e mbikëqyrjes/ supervizionit
- o Bazuar në thirrjen publike për aplikim për trajnerë të KPSHSF-së, Komisioni përkatës, i formuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë, ka përzgjedhur dyzetë e tetë (48) kandidatë/trajnerë⁸⁹, prej tyre gjashtëmbëdhjetë (16) të certifikuar dhe tridhjetë e dy (32) kandidatë/trajnerë të pacertifikuar si trajnerë;
 - o Janë trajnuar tridhjetë e dy (32) kandidatë/trajnerë me shkathtësi për trajnim. Trajnimi është organizuar në bashkëpunim me “Save the Children”.
 - o Komiteti për Koordinim të Trajnimeve dhe Grupi Punues për Akreditim të KPSHSF-së, ka hartuar disa dokumente/politika të nevojshme për procesin e akreditimit, të cilat janë miratuar nga Këshilli;

9.4. Komisionet e përhershme të KPSHSF-së

Në kuadër të Këshillit, funksionojnë pesë (5) komisione të përhershme:

1. *Komisioni për licencimin e ofruesve të shërbimeve sociale dhe familjare, niveli profesional;*
2. *Komisioni për licencimin e ofruesve të shërbimeve sociale dhe familjare, niveli bazik, i mesëm dhe i lartë;*
3. *Komisioni i Ankesave;*
4. *Komisioni për legjislacion, dhe*
5. *Komisioni për çështje organizative dhe financa.*

⁸⁹ Lista është miratuar edhe nga Sekretari i Përgjithshëm i MFPT-së.

Edhe përkundër sfidave të krijuara nga Covid-19, Komisionet i kanë përmbushur objektivat e planifikuara me Planin Vjetor të Punës për vitin 2021. Komisionet kanë mbajtur gjithsej dyzetë e katër (44) takime. Gjatë këtyre takimeve, janë shqyrtuar në total gjashtëqind e shtatëdhjetë (670) kërkesa për licencim apo rilicencim në nivelin profesional dhe në nivelin bazik, të mesëm dhe të lartë, si dhe janë shqyrtuar trembëdhjetë (13) ankesa.

9.5. Komisioni për Licencimin e Ofruesve të Shërbimeve Sociale dhe Familjare niveli: profesional


Komisioni për Licencimin e ofruesve të shërbimeve sociale dhe familjare niveli profesional, është komision i rregullt/i përhershëm, i cili vepron në kuadër të Këshillit të Përgjithshëm për Shërbime Sociale dhe Familjare. Komisioni përbëhet nga pesë (5) anëtarë: kryetari/ja dhe katër (4) anëtarë të Komisionit.

Komisioni gjatë vitit 2021 ka mbajtur shtatëmbëdhjetë (17) takime. Gjatë këtyre takimeve, janë shqyrtuar treqind e tridhjetë e tri (333) kërkesa për licencim të ofruesve të shërbimeve sociale dhe familjare në nivelin profesional. Prej tyre treqind e njëmbëdhjetë (311) kërkesa apo 93% janë aprovuar dhe njëzetë e dy (22) kërkesa apo 7% janë refuzuar, pasi që nuk i kanë plotësuar kriteret e parapara me legjislacionin në fuqi. Shih tabelën më poshtë:


Tabela 31: Kërkesat e shqyrtuara në nivelin profesional, 2021

Niveli profesional	Aprovim	Refuzim	Totali
	311	22	333

Figura 56: Përqindja e kërkesave të aprovuara dhe refuzuara, 2021



Në vitin 2021, numri i kërkesave të shqyrtuara në nivelin profesional është më i madh për dyqind e tridhjetë e tetë (238) kërkesa më shumë, në krahasim me vitin paraprak. Shih figurën më poshtë:

Figura 57: Kërkesat e shqyrtura në nivelin profesional, 2021/2020

9.6. Komisioni për Licencimin e Ofruesve të Shërbimeve Sociale dhe Familjare niveli: bazik, i mesëm dhe i lartë

Komisioni për Licencimin e ofruesve të shërbimeve sociale dhe familjare niveli bazik, i mesëm dhe i lartë, është komision i rregullt që funksionon në kuadër të KPSHSF-së. Komisioni përbëhet prej pesë (5) anëtarëve (kryetarit/es dhe 4 anëtarëve të komisionit).


Gjatë periudhës janar-dhjetor 2021, ky komision ka mbajtur tetëmbëdhjetë (18) takime, ku janë shqyrtuar treqind e tridhjetë e shtatë (337) kërkesa të parashtruara nga ofruesit e shërbimeve sociale dhe familjare për licencim/rilicencim, në nivelin bazik (107 kërkesa), të mesëm (93 kërkesa) dhe të lartë (109 kërkesa).

Nga totali i kërkesave të shqyrtuara, treqind e katër (304) kërkesa apo 90% janë aprovuar dhe tridhjetë e tetë (38) kërkesa apo 10% janë refuzuar. Në nivelin bazik janë aprovuar njëqind e shtatë (107) kërkesa dhe janë refuzuar njëzetë e tetë (28) kërkesa, në nivelin e mesëm janë aprovuar tetëdhjetë e nëntë (89) kërkesa dhe janë refuzuar katër (4) kërkesa, ndërsa në nivelin e lartë janë aprovuar njëqind e tetë (108) kërkesa dhe është refuzuar një (1) kërkesë. Shih tabelën e mëposhtme:


Tabela 32: Kërkesat e shqyrtuara në nivelin bazik, të mesëm dhe të lartë, 2021

Niveli	Aprovim	Refuzim	Totali
Bazik	107	28	135
I mesëm	89	4	93
I lartë	108	1	109
Totali	304	33	337

Në vitin 2021, numri i kërkesave të shqyrtuara në nivelin bazik, të mesëm dhe të lartë është më i madh për treqind e pesëmbëdhjetë (315) kërkesa më shumë, në krahasim me vitin paraparak. Shih figurën më poshtë:

Figura 58: Përqindja e kërkesave të aprovuara dhe refuzuara, 2021

Në vitin 2021, numri i kërkesave të shqyrtuara në nivelin bazik, të mesëm dhe të lartë është më i madh për treqind e pesëmbëdhjetë (315) kërkesa më shumë në krahasim me vitin paraprak. Shih figurën e mëposhtme:

Figura 59: Kërkesat e shqyrtuara në nivelin bazik, të mesëm dhe të lartë, 2021/2020

Siç shihet nga figura më sipër, në vitin 2021 në nivelin bazik janë shqyrtuar njëqind e gjashtëmbëdhjetë (116) kërkesa më shumë, në nivelin e mesëm nëtëdhjetë e tri (93) kërkesa më shumë dhe në nivelin e lartë njëqind e gjashtë (106) kërkesa më shumë në krahasim me vitin paraprak.

9.7. Komisioni i Ankesave

Komisioni i Ankesave është komision i rregullt që funksionon në kuadër të KPSHSF-së dhe përbëhet nga 3 anëtarë (kryetarit dhe 2 anëtarëve të komisionit).


Gjatë vitit 2021, Komisioni i Ankesave i ka mbajtur nëntë (9) takime. Gjatë këtyre takimeve, komisioni ka shqyrtuar trembëdhjetë (13) ankesa të parashtruara nga ofruesit e shërbimeve sociale dhe familjare, të cilët kanë qenë të pakënaqur me vendimet e Komisionit për licencim në nivelin profesional dhe të Komisionit për licencim nivel bazik, të mesëm dhe të lartë.

Nga ky total, njëmbëdhjetë (11) ankesa janë aprovuar ndërsa dy (2) ankesa janë refuzuar, pasi që nuk i kanë plotësuar kriteret e parapara me legjislacionin në fuqi. Shih tabelën e mëposhtme:


Tabela 33: Ankesat e shqyrtuara gjatë vitit 2021

Numri i ankesave	Aprovim	Refuzim
13	11	2

Figura 60: Përqindja e ankesave të aprovuara dhe të refuzuara gjatë vitit 2021



Në vitin 2021 janë shqyrtuar dy (2) ankesa më pak në krahasim me vitin paraprak. Shih digurën e mëposhtme:

Figura 61: Ankesat e shqyrtuara gjatë viteve 2021/2020

9.8. Bashkëpunimi me partnerë vendorë dhe ndërkombëtarë

Edhe gjatë vitit 2021, Këshilli e ka vazhduar bashkëpunimin me partnerët vendorë dhe ndërkombëtarë. Ky bashkëpunim ka qenë i orientuar sidomos në procesin e licencimit dhe rilicencimit të ofruesve të shërbimeve sociale dhe familjare dhe në procesin e trajnimit të tyre. Vlen të ceket se Organizatat Joqeveritare (OJQ), të cilat kanë marrëveshje bashkëpunimi me Këshillin, kanë luajtur një rol të rëndësishëm në sensibilizimin e punës së Këshillit, duke i njoftuar edhe OJQ-të e tjera për procesin e licencimit/rilicencimit, ku si rezultat i këtij bashkëpunimi gjatë vitit 2021 është licencuar një numër i konsiderueshëm i ofruesve të shërbimeve sociale dhe familjare nga OJQ-të vendore.

Gjatë vitit 2021, Këshilli, është mbështetur nga partnerët ndërkombëtarë dhe vendorë, si: UNICEF-i, “Terres des Homes”, Save dhe Children, Instituti i Kosovës për Administratë Publike-IKAP, Universiteti i Prishtinës-UP, Agjensia e Punësimit e Republikës së Kosovës-APRK dhe “HANDIKOS-i”. Qëllimi kryesor i kësaj mbështetje ka qenë përmirësimi i cilësisë së ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare. Pra, këta partnerë vendorë dhe ndërkombëtarë kanë ofruar mbështetje, sidomos rreth procesit të trajnimit të ofruesve të shërbimeve sociale dhe familjare të sektorit qeveritar dhe joqeveritar, me qëllim të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të tyre. Ky bashkëpunim dhe kjo mbështetje nga këta partnerë do të vazhdojë edhe gjatë viteve në vijim.

TË DHËNA ME RËNDËSI

	VITI 2021	VITI 2020	VITI 2019
Fëmijët e vendosur në kujdestari (muaji dhjetor)	685	689	681
Rastet e reja të fëmijëve pa përkujdesje prindërore/të braktisur	15	28	28
Fëmijët në strehim familjar te farefisi (dhjetor)	436	461	496
Familjet strehuese	319	333	351
Shuma mujore e përfitimit për një fëmijë në strehim familjar te farefisi	100.00€	100.00€	100.00€
Shuma e mjeteve e procesuar për muajin dhjetor	43,600.00€	46,100.00€	49,600.00€
Buxheti i shpenzuar për strehim familjar te farefisi	610,460.00€	622,080.00€	617,600.00€
Numri i fëmijëve në strehim familjar jashtë farefisit (dhjetor)	51	60	53
Numri i familjeve strehuese (dhjetor)	30	30	26
Shuma mujore për një fëmijë në strehim familjar jashtë farefisit	250.00€	250.00€	250.00€
Shuma mujore e përfitimit për një fëmijë me aftësi të kufizuar	350.00€	350.00€	350.00€
Shuma e mjeteve e procesuar për muajin dhjetor 2019	13,550.00€	16,300.00	15,425.00€
Buxheti i shpenzuar për strehim familjar jashtë farefisit	174,325,00€	185,175.00€	155,450.00€
Numri i fëmijëve në adoptim vendor	20	17	14
Numri i fëmijëve në adoptim ndërkombëtar	2	1	2
Numri i fëmijëve të vendosur në strehim rezidencial - strehimore	105	99	73
Numri i fëmijëve të vendosur në strehimoren "SOS-Familje"	55	55	43
Numri i fëmijëve të vendosur në SDSF	35	24	13
Numri i fëmijëve të vendosur në "Caritas Umbria"	15	20	17
Numri i fëmijëve të keqtrajtuar	70	24	25
Numri i fëmijëve në konflikt me ligjin	427	251	485
Numri i fëmijëve pa përkujdesje prindërore të riatdhesuar	3	1	25
Fëmijët pa përkujdesje prindërore të kthyer nga zonat e konfliktit në Siri	0	0	17
Numri i fëmijëve në punë të rënda	306	44	129
Numri i viktimave të dhunës në familje të trajtuara nga QPS-të	2486	807	502
Viktimat e dhunës në familje-Gra/Vajza	1986	630	415
Viktimat e dhunës në familje-Burra/Djem	500	44	87
Viktimat e dhunës në familje të vendosura në Strehimore	595	481	586
Viktimat e dhunës në familje, mbi moshën 18 vjeç	303	235	259
Viktimat e dhunës në familje, nën moshën 18 vjeç	292	246	327
Viktimat e dhunës në familje-Gra	303	363	445
Viktimat e dhunës në familje-Burra	0	112	141
Viktimat e dhunës në familje-Vendore	568	437	567
Viktimat e dhunës në familje-Ndërkombëtare	27	44	19
Buxheti i ndarë për OJQ-të që trajtojnë viktimat e dhunës në familje	545,000.00€	495,000.00€	257,000.00€

Numri i viktimave të trafikimit me qenie njerëzore	37	21	51
Viktimat e trafikimit mbi 18 vjeç	13	3	12
Viktimat e trafikimit nën 18 vjeç	24	18	39
Viktimat e trafikimit-Gra	35	20	50
Viktimat e trafikimit-Burra	2	1	1
Viktimat e trafikimit-Vendore	36	21	46
Viktimat e trafikimit-Ndërkombëtare	1	0	5
Buxheti i ndarë për OJQ-të që trajtojnë viktimat e trafikimit	46,000.00€	105,000.00€	32,000.00€
Numri i viktimave të krimeve seksuale-fëmijë	19	33	11
Numri i kërkesave për martesë të parakohshme	11	4	16
Numri i rasteve të trajtuar me këshilla martesore	244	182	344
Numri i ankesave të shkallës së dytë për shërbime sociale	94	76	40
Numri rasteve të trajtuar nga QPS-të	9.177	8.979	12.320
Personat e vendosur në SHMPF-Prishtinë	61	65	63
Personat e vendosur në Shtëpinë e Komunitetit në Gurakoc	19	19	15
Personat e vendosur në Shtëpinë e Komunitetit në Skenderaj	22	17	20
Personat e vendosur në Shtëpinë e Komunitetit në Graçanicë	7	7	7
Personat e vendosur në Shtëpinë e Komunitetit në Novoberdë	6	0	0
Personat e vendosur në ISSH (dhjetor)	63	62	42
Personat e vendosur në Shtëpinë e Komunitetit në Kamenicë	12	12	11
Personat e vendosur në Shtëpinë e Komunitetit në Shtime	13	14	14
Personat e vendosur në Shtëpinë e Komunitetit në Vushtri	12	12	13
Personat e vendosur në Shtëpinë e Komunitetit në Deçan	10	9	9
Personat e vendosur në Shtëpinë e Komunitetit në Ferizaj	11	11	10
Personat e vendosur në Shtëpinë e Komunitetit në Graçanicë	10	10	10
Personat e vendosur në Shtëpinë e Komunitetit në Lipjan	11	11	10
Personat e vendosur në Shtëpinë e Komunitetit në Prizren	6	0	0
Fëmijët e vendosur në Shtëpinë e Fëmijëve-Shtime	10	10	10
Numri i kërkesave për strehim institucional/rezidencial	27	15	40
Numri i kërkesave të aprovuara	19	7	35
Numri i kërkesave të refuzuara	8	8	5
Numri i kërkesave të aprovuara, në pritje për vendosje	0	0	9
Numri i fëmijëve përfitues të Skemës së FFAKP-së	2.460	2436	2.276
Fëmijët përfitues të Skemës së FFAKP- në kopsht	85	66	39
Fëmijët përfitues të Skemës së FFAKP - parashkollor	269	256	234
Fëmijët përfitues të Skemës së FFAKP - në arsim fillor	422	404	376
Fëmijët përfitues të Skemës së FFAKP - në arsim të mesëm	8	115	7
Fëmijët përfitues të Skemës së FFAKP - që nuk janë në shkollë	1676	1565	1620
Buxheti i shpenzuar për Skemën e FFAKP-së	35,551,630.00	3,108,560.00	2,775,300.00
Numri i banorëve në Republikën e Kosovës	1.739.825	1.739.825	1.739.825⁹⁰
Numri i ekonomive familjare në Republikën e Kosovës	365.627 ⁹¹	365.627	360.718
Buxheti i shpenzuar për SNS	53,637,481.25€	47,008,042.00€	32,858,645.00€
Numri i familjeve në SNS (dhjetor)	25.895	25.679	24.352
Numri i familjeve në SNS, kategoria I	18,526	17.961	16.728
Numri i familjeve në Kategorinë II	7,369	7.718	7.624

⁹⁰ Sipas Regjistrimit të Popullsisë, viti 2011.

⁹¹ Të dhënat janë të vitit 2020.

Numri i familjeve shqiptare në SNS	19,395	19.503	18.648
Numri i familjeve joshqiptare në SNS	6,394	6.065	5.704
Bartësit e ndihmës sociale-Gra	8,933	8.784	8.252
Bartësit e ndihmës sociale-Burra	16,962	16.895	16.100
Prind vetushqyes-Gra	1,921	1.882	1.886
Prind vetushqyes-Burra	451	388	404
Numri i anëtarëve të familjes në SNS	102,904	103.189	103.399
Anëtarët e familjes në SNS-Gra	52,943	53.167	42.619
Anëtarët e familjes në SNS-Burra	49,961	50.022	31.800
Anëtarët e familjes në SNS 0-18 vjeç	48,777	50.611	49.457
Anëtarët e familjes në SNS 19-65 vjeç	62,019	52.578	48.295
Anëtarët e familjes në SNS + 65 vjeç (pasiv në pagesë)	1,108	1.134	1.043
Shuma minimale mujore e ndihmës sociale për një familje	60.00€	60.00€	60.00€
Shuma maksimale mujore e ndihmës sociale	180.00€	180.00€	180.00€
Mesatarja mujore e ndihmës sociale për një familje	126.50€	126.50€	126.50€
Mesatarja mujore e ndihmës sociale për një anëtar të familjes	21.43€	21.43€	21.43€
Mesatarja ditore e ndihmës sociale për një anëtar të familjes	0.71€	0.71€	0.71€
Shtesa mujore për çdo fëmijë në familje të moshës 0-18 vjeç	5.00€	5.00€	5.00€
Ankesat e shqyrtuara nga Komisioni i Ankesave, shkalla II	241	298	610
Numri i ankesave të aprovuara	26	84	124
Numri i ankesave të refuzuara	200	214	486
	15		
Personat e vlerësuar për paaftësi për punë nga Komisioni Mjekësor i shkallës së II-të	264	179	428
Personat e vlerësuar të paaftë për punë mbi 80% (aprovim)	53	67	90
Personat e vlerësuar të aftë për punë (refuzim)	211	112	338
Kontestet Administrative në procedurë	36	10	11
Kontestet Administrative, ta aprovuara nga Gjykata Themelore	18	0	0
Kontestet Administrative, ta refuzuara nga Gjykata Themelore	2	0	0
Numri i QPS-ve të kontrolluara nga NJKM	0	0	13
Individët/familjet përfitues të ndihmës emergjente 100 euro	67	66	109
Familjet/individët përfitues të ndihmës emergjente 150 deri 300 euro	19	31	78
Buxheti i shpenzuar për ndihma të njëhershme/emergjente	10,800.00€	13,900.00€	29,800.00€
Masa 3.1: Mbështetje për familjet që kanë humbur kryefamiljarin nga COVID-19	2,170	0	0
Shuma e përfitimit për familjarin e humbur nga COVID 19	1,500.00€	0	0
Shuma e përfitimit për familjarin e humbur nga COVID 19 i punësuar si personel shëndetësor në sektorin publik	10,000.00€	0	0
Totali i buxhetit të shpenzuar për Masën 3.1	3,401,000.00€	0	0
Masa 3.5: Pagesat për lehonat e papuna	20,376	0	0
Numri i lehonave të papunësuar	14,688	0	0
Numri i lehonave të punësuar	5,688	0	0
Shuma mujore	170.00€	0	0
Buxheti i shpenzuar për lehonat e papunësuar	2,384,760.00€	0	0
Buxheti i shpenzuar për lehonat e punësuar	948,940.00€	0	0
Totali i buxhetit të shpenzuar për Masën 3.5: Pagesat për Lehonat e papuna	3,333,700.00€	0	0
Buxheti i ndarë për subvencionimin e energjisë elektrike	4,500,000.00€	4,500,000.00€	4,500,000.00€
Numri i familjeve të subvencionuara në të gjitha skemat/pensionet	38,307	37.553	35.851
Numri i familjeve të subvencionuara për SNS	24,892	24.221	23.304
Numri i familjeve të subvencionuara për FDIL	10,360	10.248	10.442

Numri i familjeve të subvencionuara për Personat Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë	1,974	1.944	1.269
Numri i familjeve të subvencionuara për Personat e Verbër	1,081	876	836
Mesatarja mujore e energjisë elektrike të subvencionuar për një familje	174 KËh	174 KËh	270 KËh
Shuma vjetore e energjisë elektrike të subvencionuar për një familje	117.00€	119.89€	135.00€
Individët/familjet përfitues të Skemave të MFPT-së	449.146	347,588	288,374
Përfituesit e SNS-së (dhjetor)	25,895	25,679	24,352
Përfituesit e Pensionit Bazik të Moshës (dhjetor)	148,162	142,280	133,917
Përfituesit e Pensionit Kontributpagues të Moshës (dhjetor)	49,872	49,451	47,486
Përfituesit e Pensionit të Personave me Aftësi të Kufizuara (dhjetor)	18,903	19,266	17,791
Përfituesit e Pensionit Familjar (dhjetor)	3,545	3,712	3,940
Përfituesit e Pensionit Invalidor të Punës (dhjetor)	68	81	108
Përfituesit e Pensionit Paraplegjik dhe Tetraplegjik (dhjetor)	2,662	2,797	3,106
Përfituesit e Skemës së FDIL-së (dhjetor)	13,293	13,550	10,493
Përfituesit e Skemës së Veteranëve të Luftës (dhjetor)	34,562	38,216	38,101
Përfituesit e Pensionit të TMK-së (dhjetor)	1,223	1,166	1,098
Përfituesit e Pensionit të FSK-së (dhjetor)	625	583	546
Përfituesit e Pensioneve të Treççës (dhjetor)	2,028	2,341	2,635
Përfituesit e Skemës së Personave të Verbër (dhjetor)	1,772	1,848	1,976
Përfituesit e Skemës së FFAKP-së (dhjetor)	2,460	2,436	2,276
Përfituesit e Strehimit Familjar brenda familjes (dhjetor)	436	461	496
Përfituesit e Strehimit Familjar jashtë familjes (dhjetor)	51	60	53
Pensioni për Kompenzimin e Arsimit për vitet 98/99 deri në vitin 98/99	12,215	11,530	0
Masa 3.15 (Pakoja Fiskale Emergjente)	0	32,131	0
Masa 3.1: Mbështetje për familjet që kanë humbur kryefamiljarin nga COVID-19	2,170	0	0
Masa 3.5: Pagesat për lehonat e papuna (Masa 3.5) (dhjetor)	1,772	0	0
Masa 3.5: Shtesat për Fëmijë (Masa 3.5) (dhjetor)	127,432	0	0
OJQ-të e licencuara	48	11	18
Numri i inspektimeve të kryera nga NJMI-ja	4	5	10
Numri total i ofruesve të shërbimeve sociale dhe familjare të licencuar	1.721	1.306	1.190
Ofruesit e licencuar në nivelin profesional	311	692	598
Ofruesit e licencuar në nivelin bazik, të mesëm dhe të lartë	304	613	592
Numri i kërkesave të shqyrtuara, niveli profesional	333	95	184
Numri i kërkesave të aporovuara	311	83	142
Numri i kërkesave të refuzuara	22	12	25
Numri i kërkesave në plotësim	0	0	17
Numri i kërkesave të shqyrtuara, niveli bazik, i mesëm dhe i lartë	337	22	164
Numri i kërkesave të aporovuara	304	22	119
Numri i kërkesave të refuzuara	33	0	20
Numri i kërkesave në plotësim	0	0	25
Numri i ankesave të shqyrtuara	13	11	15
Numri i ankesave të aporovuara	11	11	14
Numri i ankesave të refuzuara	2	0	1